INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

LIBRI I ABSTRAKTEVE
BOOK OF ABSTRACTS

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare
18 - 19 shtator 2025

Arsimi gjatë gjithë jetës: Qasje gjithëpërfshirëse nga fëmijëria e hershme deri te arsimi profesional

International Scientific Conference
September 18 - 19, 2025

Lifelong Learning: A Comprehensive Approach from Early Childhood to Vocational Education



Prishtinë, shtator 2025
Prishtina, September 2025

INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

LIBRI I ABSTRAKTEVE
BOOK OF ABSTRACTS

Nga konferenca shkencore ndërkombëtare
18 - 19 shtator 2025

Arsimi gjatë gjithë jetës: Qasje gjithëpërfshirëse nga fëmijëria e hershme deri te arsimi profesional

International Scientific Conference
September 18 - 19, 2025

Lifelong Learning: A Comprehensive Approach from Early Childhood to Vocational Education

Prishtinë, shtator 2025
Prishtina, September 2025

Botues/Publisher:
Instituti Pedagogjik i Kosovës
Kosovo Pedagogical Institute

Për botuesin/On behalf of the publisher:
Osman Buleshkaj, drejtor/director

Korrektues gjuhësor/Language editor:
Bekim Morina

ISSN: 3006-9572 (Print)

ISSN: 3006-9580 (Online)

Përgatiti për botim/Prepared for publication:
Skender Mekolli

Shtypi/print

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Printing Haus “Blendi”, Prishtina

Koordinatorë të Konferencës/Conference Coordinators:

Murteza Osdautaj
Tringa Dedi

Këshilli Shkencor i Konferencës/Conference Scientific Committee:

1. Osman Buleshkaj, IPK;
2. Murteza Osdautaj, IPK;
3. Tringa Dedi;
4. Safete Shala, IPK;
5. Amantina Pervizaj Kelmendi, IPK;
6. Luljeta Shala, IPK;
7. Bekim Morina, IPK;
8. Mevlude Aliu-Gashi, IPK;
9. Lirije Bytyqi, IPK;
10. Agim Bujari, IPK;
11. Selim Mehmeti, IPK;
12. Bardhyl Musai, UT;
13. Erenestina Halili, UT;
14. Naser Zabeli, FE/UP;
15. Iliriana Tahiraj, FE/UP;
16. Demush Bajrami, UEJL;
17. Arafat Shabani, UEJL.

Këshilli Organizativ i Konferencës/Conference Organizing Committee:

1. Murteza Osdautaj;
2. Tringa Dedi;
3. Luljeta Shala;
4. Bashkim Azemi;
5. Skender Mekolli;
6. Mevlude Aliu-Gashi;
7. Amantina Pervizaj Kelmendi;
8. Fitore Maliqi;
9. Valon Gajraku;
10. Granit Duli.

Përmbajtja/Contents

Parathënie/Preface 12

Dr. **Xhavit Rexhaj**
Sfidat, mitet dhe të vërtetat e arsimit parauniversitar në Kosovë
Challenges, Myths and Realities of Pre-University Education in Kosovo 14

Dr. **Edmond Hajrizi**
Transformimi i arsimit përmes teknologjive të avancuara: Kalimi nga klasa tradicionale te Klasa 4.0
Transforming education through advanced technologies: From the traditional classroom to classroom 4.0 17

Kätlin Vanari
Shkolla e së ardhmes: Ndryshimi i qëndrueshëm përmes partneritetit shkollë–universitet
Future school: Lasting change through school–university partnerships ……. 20

Dr. **Aida Goga**
Praktika të suksesshme dhe risi në zhvillimin profesional të drejtuesve arsimorë
Successful practices and innovations in the professional development of educational leaders …. 22

Afrim Aliti & Demush Bajrami
Podkastet si mjete për komunikim dhe të mësuarit gjatë gjjithë jetës në arsimin parauniversitar
Podcasts as tools for communication and Lifelong Learning in Pre-University Education 25

Agon Ahmeti & Bleona Kurteshi
Raport analitik mbi provimin e maturës shtetërore
Analytical report on the state Matura exam …… 27

Albana Deda (Ndoja)
Fjalëformimi në tekstet e AMU-së dhe problematikat e trajtimit të tij (*Përmirësimi i kurrikulave dhe planeve mësimore*)
Word formation in AMU texts and challenges in its treatment *(Improving Curricula and Lesson Plans)* 29

Amantina Pervizaj Kelmendi
Sfidat dhe strategjitë për zhvillimin e shkencave ndërdisiplinore në Kosovë dhe mundësitë për integrimin e tyre në programet ndërkombëtare
Challenges and strategies for the development of interdisciplinary sciences in Kosovo and opportunities for heir integration into international programs 32

Anita Beiqi & Vesa Bardheci
Ndërlidhja ndërmjet zhvillimit emocional, kognitiv dhe social të fëmijëve në prag të klasës së parë
The interconnection between emotional, cognitive, and social development of children on the eve of first grade 34

Arben Berisha & Behxhet Dibrani
Edukimi dhe emancipimi i femrës në Kosovë (1945–1975): Politikat arsimore dhe sfidat shoqërore
Education and emancipation of women in Kosovo (1945–1975): Educational policies and social challenges 36

Arben Zabeli
Roli i mësimdhënësit mbështetës në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta (Studim rasti)
The role of the support teacher in the inclusion of students with special needs: A case study …. 38

Arbnesha Mexhuani & Skender Mekolli
Tekstet dhe materialet mësimore që përdoren në shkollat profesionale
Textbooks and learning materials used in vocational schools 40

Arbron Mexhuani
Metodat mësimore që i përdorin mësimdhënësit e lëndës së gjuhës gjermane në shkollat e Kosovës
Teaching methods used by German Language teachers in schools of Kosovo 42

Azra Thaqi Gashi
Praktikat gjithëpërfshirëse në orët e gjuhës angleze të arsimit fillor në Kosovë
Inclusive practices in english language classes in primary education in Kosovo 44

Bardha Gashi
Rishikimi i kurrikulës si mjet për përmirësim cilësor dhe gjithëpërfshirje në arsimin parauniversitar: Praktika ndërkombëtare dhe perspektiva nga Kosova
Curriculum review as a tool for quality improvement and inclusivity in pre-university education: International practices and perspectives from Kosovo 46

Bardhyl Musai
Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkolla mundëson zhvillimin e të lexuarit të kuptimshëm përmes strategjive ndërvepruese
Improving teaching quality in schools to enhance reading comprehension through interactive strategies 48

Bashkim Ali Azemi
Rëndësia e komunikimit efektiv në mësimdhënie
The importance of effective communication in teaching 50

Bekim Morina
Të mësuarit e gramatikës së gjuhës shqipe në shkollat e mesme të ulëta në Kosovë
Learning Albanian grammar in lower secondary schools in Kosovo 52

Belgizare Kryeziu & Vlora Bunjaku
Ndërtimi i shkathtësive të së ardhmes – përtej teknologjisë
Building future skills – beyond technology 54

Demush Bajrami & Arafat Shabani
Të mësuarit gjatë gjithë jetës në epokën e transformimit digjital
Lifelong Learning in the era of digital transformation 56

Dhurata Çoçaj
Efektet e teknologjisë digjitale në të nxënit e gjuhës shqipe në shkollën e mesme të lartë
The effects of digital technology on learning the Albanian Language in upper secondary school 58

Dijellza Hasani & Naser Zabeli
Zbatimi i dizajnit universal të të mësuarit: Qasje proaktive për ndërtimin e mjediseve gjithëpërfshirëse në arsimin fillor në Kosovë
Implementation of universal design for learning: A proactive approach to building inclusive environments in primary education in Kosovo 60

Dorentina Murturi-Cyril
Inteligjenca emocionale e mësimdhënësve dhe efektiviteti i tyre: një analizë e ndikimit të tipareve të personalitetit, gjinisë dhe përvojës profesionale
Teachers' emotional intelligence and effectiveness: An analysis of the impact of personality traits, gender and professional experience 62

D.Sokoli, **A. Kastrati, M. Xhemaili, E. Kodheli, O. Buleshkaj**
Masivizimi dhe cilësia e mësimdhënies në Universitetet e Ballkanit Perëndimor
Massification and teaching quality in Western Balkan Universities 64

Erenestina Gjergji (Halili)
Aftësitë e të lexuarit në Arsimin Parauniversitar dhe objektivat e PISA-s: Rasti i trajnimit të mësimdhënësve në UT (PKZHPM 2024-25)
Reading skills in pre-university education and the objectives of PISA: The case of teacher training at the University of Tirana (PKZHPM 2024–25) 66

Gentiana Lajqi
Zbatimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë: Studim rasti
Implementation of school-based teacher professional development: Case study 68

Gentiana Zabeli & Anduena Kelmendi
Zëri i prindërve në arsimin gjithëpërfshirës
The voice of parents in inclusive education..... 70

Hajrije Devetaku Gojani
Qasjet inovative të mësimit në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve
Innovative teaching approaches in function of student competence development …… 72

Haxhere Zylfiu
Analiza e hulumtimeve nga IPK per arsimin e të rriturve: Jetësimi i rekomandimeve në politikat dhe praktikat arsimore
Analysis of research conducted by the Kosovo Pedagogical Institute on adult education: Implementation of recommendations in educational policies and practices 75

Jetmire I. - Shabedini, Buniamin Memedi, Majlinda Kurtishi
Përdorimi i teknologjisë në mësimin e letërsisë
The use of technology in literature teaching 77

Leonora Carkaj
Edukimi mjedisor në fëmijërinë e hershme në Kosovë: Analizë e gjendjes aktuale dhe rekomandime për përmirësim
Environmental education in early childhood in Kosovo: Analysis of the current situation and recommendations for improvement 79

Linda Hoxha, **Majlinda Zh. - Gjelaj**, **Lulavere Behluli**
Qendrat me bazë në komunitet për edukimin e hershëm në Kosovë
Community-based centers for Early Childhood Education in Kosovo 80

Lirije Bytyqi - Beqiri
Aplikimi i qasjes ndërlëndore në arsimin fillor
Applying the cross-curricular aproach in primary education 82

Lon Laska
Qasja gjithëpërfshirëse në arsim: Identifikimi dhe mbështetja e fëmijëve me dhunti dhe talente të veçanta
Inclusive approach in education: Identification and support for gifted and talented children 84

Luljeta Hysenaj
Ndikimi i vlerësimit formues në të shprehurit me shkrim të nxënësve në ShMU
The impact of formative assessment on students' writing expression in secondary education 86

Luljeta Shala
Ndikimi i përdorimit të ChatGPT te nxënësit: përparësitë dhe sfidat
The impact of ChatGPT use on students: Advantages and challenges 88

Mevlude Aliu - Gashi
Shfrytëzimi i mjedisit të jashtëm në institucionet parashkollore në Kosovë: Një vlerësim i frekuentimit dhe ndikimit në zhvillimin e fëmijëve
The use of outdoor environments in preschool institutions in Kosovo: An assessment of frequency and impact on children's development 90

Migena Arllati
Motivimi dhe roli i tij në efikasitetin e mësimdhënies
Motivation and its role in teaching effectiveness 92

Mimoza Hoti Kolukaj & Senad Orhani
Edukimi për qytetarinë digjitale në shkollat fillore: Qasje pedagogjike
Digital citizenship education in primary schools: Pedagogical approach 94

Mimoza Voca, Brikena Ademi, Artiola Hyseni
Roli i lëvdatës krahasuar me kritikën në motivimin e nxënësve
The role of praise compared to criticism in student motivation 96

Mirlinda Bunjaku Isufi
Bashkëpunimi prindër–mësues në zbatimin e aktiviteteve jashtëshkollore si pjesë e kurrikulës së zgjeruar
Parent–teacher collaboration in the implementation of extracurricular activities as part of the expanded curriculum 98

Mirlinda Bunjaku Isufi & Eranda Bilali
Qasjet gjithëpërfshirëse në edukim: Roli i partneritetit shkollë–familje në realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore
Inclusive approaches in education: The role of school–family partnership in implementing extracurricular activities 100

Mirsad Suhodolli
Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve në Kosovë: Eksplorimi i nevojave, sfidave dhe mundësive
Continuous professional development of teachers in Kosovo: Exploring needs, challenges, and opportunities ……..102

Murteza Osdautaj
Sekuencimi dhe përmbajtjet tematike në tekstet shkollore: Ndikimi në kulturën e leximit të nxënësve 15-vjeçarë
Sequencing and thematic content in school textbooks: Their impact on the reading culture of 15-year-old students 104

Mynever Basha
Efekti i programit psikoedukues, bazuar në qasjen kognitive për menaxhimin e agresivitetit te fëmijët e shkollës fillore
The effect of a psychoeducational program based on a cognitive approach on aggression management in primary school children 106

Addhe Krasniqi & Nehat Duraku
Përvojat e drejtorëve të shkollave gjatë zbatimit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve
School principals' experiences during the implementation of teacher performance appraisal 108

Nehat Duraku
Roli i zhvillimit profesional të vazhdueshëm në udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollës: Studim rasti në komunën e Rahovecit 110

Osman Buleshkaj, Fadil Latifi, Armend Shabani, Mihaela Singer
Ngritja e kapaciteteve për rishikim dhe përmirësim të teksteve shkollore: Përvoja nga mësimdhënësit
Developing capacities for review and revision of textbooks: Teachers' experiences 112

Qendresa Mustafi & Buniamin Memedi
Roli i edukatorit special dhe rehabilitatorit në institucionet arsimore: Një qasje teorike
The role of the special educator and rehabilitator in educational institutions: A theoretical approach ..114

Safete Statovci – Shala
Format e bashkëpunimit efektiv mësimdhënës-nxënës në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë
Effective teacher-student collaboration models in upper secondary education in Kosovo 116

Sahare Reçica-Havolli
Përceptimet e mësuesve udhëtues për praktikat e gjithëpërfshirjes në Kosovë
Itinerant teacher perceptions of inclusive practices in Kosovo 118

Selim Mehmeti, Rita Llumnica, Rita Çadraku
Përfshirja dhe promovimi i standardeve për drejtorë të shkollave në Kosovë në programet për udhëheqje arsimore
Inclusion and promotion of standards for school principals in Kosovo in educational leadership programs 120

Senad Orhani & Kyvete Shatri
Motivimi i nxënësve për të nxënë përmes lojërave kompjuterike
Student motivation to learn through computer games 122

Shkelqim Millaku
Lidhshmëria e gjuhës shqipe ndërmjet programeve parauniversitare dhe atyre universitare
The Albanian language connectivty between pre-university and university programs 124

Suzana Gjergji & Servete Gashi
Qasja sociale dhe emocionale në procesin mësimor si faktor për zhvillimin e kompetencave personale dhe qytetare
Social and emotional approach in the learning process as a factor for the development of personal and citizen competences 126

Tringa Dedi, Zehrie Plakolli, Mevlude Aliu – Gashi
Praktikat edukative për integrimin e aktiviteteve fizike në punën me fëmijët 3-6 vjeç
Educational practices for integrating physical activities in working with children aged 3-6 Years ……128

Uranela Demaj & Agon Ahmeti
Shqyrtim kritik i lektyrave shkollore
Critical review of school literature readings ……130

Valdete Spahiu Çollaku
Ndikimi i mësimit plotësues në arritjet akademike të nxënësve
The impact of supplementary teaching on students' academic achievements 132

Vjollca (Llazani) Ameti & Sevdije Berisha - Krasniqi
Bashkëpunimi ndërmjet familjes dhe edukatoreve në edukimin e hershëm: sfidat dhe mundësitë
Collaboration between families and educators in early childhood education: Challenges and opportunities 134

Vlora Bunjaku & Belgizare Kryeziu
Roli i platformave digjitale në zhvillimin e kompetencave të qëndrueshme te nxënësit e arsimit fillor
The role of digital platforms in developing sustainable competencies in primary school students 136

Zehrie Plakolli
Rëndësia e mendimit kritik në fëmijërinë e hershme dhe mbështetja e tij nga edukatorja
The role of digital platforms in developing sustainable competencies in primary school students 138

Parathënie

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "**Arsimi gjatë gjithë jetës: Qasje gjithëpërfshirëse nga fëmijëria e hershme deri tek arsimi profesional**", e organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, më 18–19 shtator 2025, përfaqëson një hap të rëndësishëm në rrugëtimin e përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të qëndrueshëm. Kjo konferencë synon të krijojë një hapësirë shkëmbimi profesional e akademik, në të cilën ide, përvoja dhe rezultate kërkimore do të trajtohen si udhërrëfyes për zhvillimin e politikave dhe praktikave arsimore.

Tema e këtij viti, **arsimi gjatë gjithë jetës**, pasqyron bindjen se procesi i të nxënit është një rrugëtim i pandërprerë, i cili fillon në fëmijërinë e hershme dhe vazhdon gjatë gjithë jetës së individit. Një qasje e tillë kërkon politika të integruara, inovacione pedagogjike dhe mbështetje të vazhdueshme për mësimdhënësit, drejtuesit e arsimit/shkollave, nxënësit dhe komunitetet. Prandaj, arsimi nuk shihet vetëm si një përgatitje për tregun e punës, por si një mjet fuqizimi shoqëror, qytetar dhe kulturor.

Për të hapur debatin, konferenca sjell **katër kumtesa kryesore,** të cilat trajtojnë sfidat, mitet dhe realitetet e arsimit parauniversitar; transformimin e arsimit përmes teknologjive të avancuara dhe kalimin nga klasa tradicionale te Klasa 4.0; shkollën e së ardhmes si model të ndryshimit të qëndrueshëm, përmes partneriteteve ndërmjet shkollave dhe universiteteve; si dhe praktikat e suksesshme dhe risitë në zhvillimin

Preface

International Scientific Conference **"Lifelong Learning: Inclusive Approaches from Early Childhood to Vocational Education"**, organized by the Pedagogical Institute of Kosovo on September 18–19, 2025, represents an important step in the joint endeavor to build an inclusive, high-quality, and sustainable education system. The conference aims to create a professional and academic space for exchange, where ideas, experiences, and research findings serve as guiding principles for the development of educational policies and practices.

This year's theme, **lifelong learning,** reflects the conviction that learning is a continuous journey beginning in early childhood and extending throughout the entire life of the individual. Such an approach requires integrated policies, pedagogical innovations, and ongoing support for teachers, education/school leaders, students, and communities. Education is thus not seen solely as preparation for the labor market, but also as a means of social, civic, and cultural empowerment.

To open this dialogue, the conference brings **four keynote contributions** that address the challenges, myths, and realities of pre-university education, the transformation of education through advanced technologies and the transition from the traditional classroom to Classroom 4.0, the future school as a model of lasting change through partnerships between schools and universities, as well as successful practices and innovations in the professional development of educational leaders.

profesional të drejtuesve arsimorë. Këto kumtesa ofrojnë një kornizë të gjerë reflektimi mbi sfidat aktuale, mundësitë e transformimit dhe modelet inovative që mund të udhëheqin sistemet arsimore drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Përveç tyre, konferenca pasurohet nga **57 prezantime shkencore në sesione paralele**, të cilat ofrojnë një mozaik temash të ndërlidhura me fushën e arsimit, si: analizat e politikave dhe kurrikulave, roli i teknologjisë digjitale në procesin mësimor, praktikat gjithëpërfshirëse për fëmijët me nevoja të veçanta, arsimi i të rriturve dhe aftësimi profesional, zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe drejtorëve, ndërlidhja ndërmjet edukimit, kulturës dhe zhvillimit shoqëror.

Ky botim përmbledh abstraktet e të gjitha punimeve të paraqitura dhe synon të shërbejë si burim i vlefshëm për studiues, praktikues dhe politikëbërës, duke ofruar ide të reja, shembuj të mirë dhe perspektiva të ndryshme për përmirësimin e sistemit arsimor në Kosovë dhe më gjerë.

Instituti shpreh mirënjohje për autorët e punimeve, recensentët dhe të gjithë pjesëmarrësit që me përvojën dhe vizionin e tyre kontribuuan në pasurimin e kësaj konference. Falënderim i veçantë u drejtohet bashkëpunëtorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët e bëjnë të mundur shndërrimin e kësaj ngjarjeje në një platformë të qëndrueshme të dialogut shkencor.

Dr. Osman Buleshkaj
Prishtinë, shtator 2025

These keynotes provide a broad framework for reflection on current challenges, opportunities for transformation, and innovative models that can guide education systems toward sustainable development.

In addition, the conference is enriched by **57 scientific presentations in parallel sessions**, offering a mosaic of interrelated topics, such as: policy and curriculum analyses, the role of digital technology in the teaching process, inclusive practices for children with special needs, adult education and vocational training, the professional development of teachers and school leaders, the intersections between education, culture, and social development.

This volume brings together the abstracts of all presented works and seeks to serve as a valuable resource for researchers, practitioners, and policymakers. It provides new ideas, good practices, and diverse perspectives on improving the education system in Kosovo and beyond.

The Institute expresses its sincere gratitude to the authors, reviewers, and all participants who, with their expertise and vision, enriched the conference. Special thanks are also extended to local and international collaborators who made it possible for this event to become a sustainable platform for scientific dialogue.

Dr. Osman Buleshkaj
Prishtina, September 2025

Sfidat, mitet dhe të vërtetat e arsimit parauniversitar në Kosovë

Challenges, Myths and Realities of Pre-University Education in Kosovo

Dr. Xhavit Rexhaj

Abstrakt

Përmes një qasje deskriptove, punimi paraqet një prerje në gjendjen e arsimit kosovar pas një çerekshekulli në liri dhe 17 vjet pavarësi. Qëllimi është problematizimi i dukurive dhe i gjendjes së tanishme në arsim për të hapur rrugën për krahasimin e tyre, identifikimin e karakteristikave të përbashkëta të problemeve dhe identifikimin/ analizën e mëpastajme të shkaqeve. Fillimisht trajtohen disa segmente dhe tregues kryesorë të sistemit parauniversitar në Kosovë si: (a) përfshirja në edukimin në fëmijërinë e hershme / parafillor dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të fëmijëve në shkollë, (b) përfshirja e komuniteteve të pafavorizuara në edukimin e arsimin kosovar, (c) financimin e arsimit dhe trendët demografikë, (d) indekset HDI dhe HCI, si dhe rezultatet e testit PISA, dhe (f) menaxhimin e shkollës.

Gjendja e përshkruar në arsim rezulton e dëmshme për fëmijët e të rinjtë për shkak të pengimit të rëndësishëm të zhvillimit personal, për familjet e tyre që gjithnjë e më shumë duhet të orientohen kah institucionet private edukative e arsimore, si dhe në mungesën e kontributit të arsimit në zhvillimin e përgjithshëm të popullatës dhe të shoqërisë (HDI dhe HCI). Pastaj, shkurtazi

Abstract

Through a descriptive approach, this paper provides an overview of the state of education in Kosovo after a quarter of a century of freedom and 17 years of independence. The aim is to problematize the phenomena and current conditions in education in order to enable their comparison, the identification of common characteristics of the problems, and the subsequent identification and analysis of their causes. The paper first addresses several key segments and indicators of the pre-university system in Kosovo, such as: (a) participation in early childhood/pre-primary education and the duration of children's schooling, (b) the inclusion of disadvantaged communities in the Kosovar education system, (c) education financing and demographic trends, (d) HDI and HCI indices, PISA test results, and (f) school management.

The described state of education proves harmful for children and youth due to significant obstacles to their personal development; for families who are increasingly oriented toward private educational institutions; and for society as a whole, as education contributes little to the overall development of the population and society (HDI and HCI). The paper also briefly mentions some

përmenden edhe disa suksese të sistemit arsimor (AAP dhe AL) dhe elementet që kanë sjellë deri te suksesi relativ. Të dhënat për pjesën përshkruese janë nxjerrë nga databazat vendore dhe nga raportet e shumta vendore e ndërkombëtare për sektorin e arsimit, si dhe nga disa projekte hulumtuese të autorit në katër – pesë vitet e fundit në sektorin e arsimit.

Më tutje, prezantimi synon të trajtojë shkaqet e një gjendjeje të këtillë, përfshirë financimin dhe llogaridhënien, qartësinë e politikave nacionale, zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, dhe angazhimin e faktorëve kryesorë arsimorë. Në fund, prezantohen disa pyetje për reflektim dhe diskutim të mëtejmë të pjesëmarrësve, me qëllim të dhënies së rekomandimeve dhe trajtimit më të thellë - nxitjes së një debati me implikime edhe jashtë konferencës dhe pjesëmarrësve në të.

achievements of the education system (VET and adult learning) and the elements that have contributed to these relative successes. The descriptive data are drawn from local databases, numerous national and international reports on the education sector, as well as several of the author's own research projects in the past four to five years.

Furthermore, the presentation seeks to address the causes of this situation, including issues of financing and accountability, the clarity of national policies, the implementation of existing legal provisions, and the engagement of key educational stakeholders. Finally, it introduces several questions for further reflection and discussion among participants, with the aim of generating recommendations and fostering deeper debate—one with implications extending beyond the conference itself.



Dr. Xhavit Rexhaj

Biografia

Profesor në Kolegjin AAB dhe ligjërues me angazhim në Universitetin e Prishtinës, me

Boigraphy

Professor at AAB College and a part-time lecturer at the University of Prishtina, specializing in

specializim në teoritë e të nxënit, politikat arsimore dhe menaxhimin e sistemeve dhe institucioneve arsimore. Studimet e doktoratës, postdoktoratës dhe hulumtimet e tij fokusohen në arsimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve. Ka botuar një sërë punimesh shkencore, përfshirë artikuj, monografi, doracakë dhe një libër, që trajtojnë kërkime dhe praktika për përmirësimin e pjesëmarrjes dhe cilësisë në arsim.

Vitet e fundit është angazhuar në projekte kërkimore mbi efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit arsimor. Profesori Rexhaj ka shërbyer gjithashtu në agjenci të ndryshme, institucione qeveritare dhe asociacione profesionale në fushën e arsimit dhe shkencës, duke kontribuar me ekspertizën e tij në zhvillimin e politikave, forcimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale.

learning theories, education policy, and the management of education systems and institutions. His PhD, postdoctoral studies, and research are focused on education and the development of children and youth. He has authored numerous publications, including articles, monographs, handbooks, and a book, addressing research and practices aimed at improving participation and quality in education.

In recent years, he has been actively engaged in research projects examining the efficiency and effectiveness of the education system. Professor Rexhaj has also served in various agencies, government institutions, and professional associations in the field of education and science, contributing his expertise to policy development, institutional strengthening, and professional capacity-building.

Transformimi i arsimit përmes teknologjive të avancuara: Kalimi nga klasa tradicionale te Klasa 4.0

Transforming education through advanced technologies: From the traditional classroom to classroom 4.0

Dr. Edmond Hajrizi

Abstrakt

Ky punim paraqet një model pionier të qytetit të Mençur, UBT Smart City, i cili demonstron se si arsimi mund të mbështetet tërësisht në teknologjitë e avancuara. I konceptuar për arsimin fillor, të mesëm, të rriturve dhe të përshtatur për arsimin dual, ky model ofron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt së ardhmes, ku transformimi digjital nxit cilësinë mësimore, efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe kreativitetin. Ai nuk kufizohet vetëm në modernizimin e metodave tradicionale, por krijon një kulturë të re edukative, ku teknologjia ndërthuret ngushtë me zhvillimin personal dhe profesional të nxënësve.

Shkolla konceptohet si qendër dijesh dhe laborator praktik, ku nxënësit nuk janë konsumues pasivë, por kontribuues aktivë në gjenerimin e ideve dhe zgjidhjen e problemeve reale. Modeli integron Inteligjencën artificiale, lidhjen 5G, Realitetin e Shtuar e Virtual (AVR), binjakët digjitalë dhe sistemet e monitorimit në kohë reale. Këto nuk janë vetëm mjete ndihmëse, por shtylla kryesore e operacioneve, menaxhimit dhe inovacionit në arsim.

Abstract

This paper presents a pioneering model of the Smart City, the *UBT Smart City*, which demonstrates how education can be fully supported by advanced technologies. Designed for primary, secondary, and adult education, as well as adapted to dual education, this model offers a comprehensive and future-oriented approach where digital transformation drives learning quality, efficiency, sustainability, and creativity. It not only modernizes traditional methods but also establishes a new educational culture where technology is closely intertwined with the personal and professional development of learners.

The school is envisioned as a knowledge hub and a practical laboratory, where learners are not passive consumers but active contributors in generating ideas and solving real-world problems. The model integrates Artificial Intelligence, 5G connectivity, Augmented and Virtual Reality (AVR), digital twins, and real-time monitoring systems. These are not merely auxiliary tools but serve as the core pillars of operations, management, and innovation in education.

Një komponent thelbësor është qëndrueshmëria. Arsimi i brezit të ri lidhet me ndërgjegjësimin ekologjik, duke edukuar gjenerata që zotërojnë aftësi digjitale dhe ndjeshmëri ndaj sfidave globale, si ndryshimet klimatike dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve. Gjithashtu, modeli nxit sipërmarrjen dhe kreativitetin përmes IA, AVR dhe simulimeve, duke i pajisur nxënësit me aftësi për të zhvilluar projekte që mund të shndërrohen në nisma komunitare apo biznese.

Një element tjetër i rëndësishëm lidhet me konceptin e Klasës 4.0, që përfaqëson evolucionin e edukimit drejt një sistemi të mbështetur plotësisht në teknologji. Ndryshe nga Klasa 1.0, e bazuar në tekstin e shtypur dhe mësuesin si burim i vetëm i dijes, apo Klasa 2.0 dhe 3.0, që sollën internetin dhe multimedian, Klasa 4.0 vendos teknologjinë në qendër. Ky integrim i inovacionit, qëndrueshmërisë dhe filozofisë së Klasës 4.0, e pozicionon modelin si laborator të gjallë për të ardhmen e edukimit dhe katalizator për zhvillimin e shoqërisë dhe komuniteteve lokale.

Fjalët çelës: arsimi digjital, klasa 4.0, qyteti i mençur, qëndrueshmëria, inovacioni teknologjik

A key component of the model is sustainability. Education for the new generation is connected with ecological awareness, fostering learners who combine strong digital skills with sensitivity to global challenges such as climate change and sustainable resource management. Moreover, the model promotes entrepreneurship and creativity through AI, AVR, and simulations, equipping learners with the competencies to develop projects that can evolve into community initiatives or entrepreneurial ventures.

Another important element relates to the concept of *Classroom 4.0*, representing the evolution of education toward a system fully supported by technology. Unlike Classroom 1.0, based on printed textbooks and the teacher as the sole source of knowledge, or Classrooms 2.0 and 3.0, which introduced the internet and multimedia, Classroom 4.0 places technology at the very center of the learning process. This integration of innovation, sustainability, and the philosophy of Classroom 4.0 positions the model as a living laboratory for the future of education and a catalyst for the development of society and local communities.

Keywords: digital education, Classroom 4.0, smart city, sustainability, technological innovation



Prof. dr. Edmond Hajrizi

Biografia

Prof. dr. Edmond Hajrizi është themelues dhe president i Ekosistemit të UBT-së, që përfshin arsimin fillor, të mesëm, universitar dhe zhvillimin profesional gjatë gjithë jetës. Me mbi tri dekada përvojë akademike dhe udhëheqje mbi dy dekada, ai e ka shndërruar UBT-në në një qendër të avancuar të dijes, kërkimit, teknologjisë dhe sipërmarrjes.Prof. Hajrizi ka udhëhequr projekte vendore dhe ndërkombëtare në arsim, në kërkim, TIK, qëndrueshmëri dhe modernizim të arsimit, duke botuar në revista dhe konferenca ndërkombëtare. Ai është doktor i Menaxhimit të Sistemeve nga Universiteti i Teknologjisë së Vjenës dhe ka përfunduar studimet postdoktorale në City University London. Përvoja e tij shtrihet në automatizim, mekatronikë, shkenca kompjuterike, menaxhim të cilësisë dhe zhvillim rajonal. Si anëtar i akademive prestigjioze evropiane dhe fitues i çmimeve ndërkombëtare, prof. Hajrizi vazhdon të ndikojë në politikat kombëtare dhe debatet globale mbi inovacionin, transformimin digjital dhe ndërmarrësinë në edukim.

Biography

Prof. Dr. Edmond Hajrizi is the founder and president of the UBT Ecosystem, encompassing primary, secondary, and university education as well as lifelong professional development. With over three decades of academic experience and more than twenty years in leadership, he has transformed UBT into an advanced hub of knowledge, research, technology, and entrepreneurship. Prof. Hajrizi has led national and international projects in education, research, ICT, sustainability, and education modernization, publishing extensively in international journals and conferences. He holds a PhD in Systems Management from the Vienna University of Technology and completed postdoctoral studies at City University London. His expertise spans automation, mechatronics, computer science, quality management, and regional development. As a member of prestigious European academies and a recipient of international awards, Prof. Hajrizi continues to influence national policies and global debates on innovation, digital transformation, and entrepreneurship in education.

Shkolla e së ardhmes: Ndryshimi i qëndrueshëm përmes partneritetit shkollë– universitet

Future school: Lasting change through school – university partnerships

Kätlin Vanari

Abstrakt

Përpjekjet për përmirësimin e shkollave shpesh dështojnë sepse anashkalojnë dinamikat e ndërlikuara të kulturës shkollore – “kutia e zezë” që ndërmjetëson praktikat e reja. Duke u mbështetur në bazat teorike të zhvilluara në një kornizë konceptuale për përmirësimin e shkollave në Estoni, ky abstrakt paraqet programin *“Shkolla e së Ardhmes”* si një qasje sistematike për të zbërthyer këtë “kuti të zezë” dhe për të nxitur ndryshime të qëndrueshme, të bazuara në evidencë. Programi dëshmon se investimi në partneritete të thella dhe afatgjata ndërmjet universiteteve dhe shkollave është një strategji jashtëzakonisht efektive për reforma sistemore.

Korniza konceptuale e programit synon të krijojë ndryshime të qëndrueshme në mësimdhënie dhe të nxënie, duke forcuar aftësitë e drejtuesve shkollorë për udhëheqje të shpërndarë, vendimmarrje të bazuar në evidencë dhe bashkë-krijim në funksion të përmirësimit të të nxënit të nxënësve. Me mbi 100 ekipe arsimore pjesëmarrëse, programi përfaqëson një zbatim praktik të parimeve që kanë mundësuar suksesin e qëndrueshëm të Estonisë në vlerësimet PISA.

Abstract

School improvement efforts often fail because they overlook the complex internal dynamics of school culture—the "black box" that mediates new practices. Drawing on theoretical foundations detailed in a conceptual framework for school improvement in Estonia, this abstract presents the "Future School" program as a systematic approach to unpacking this black box and fostering sustainable, evidence-driven change. The program demonstrates that investing in deep, long-term partnerships between universities and schools is a highly effective strategy for systemic reform.

The program's conceptual framework is designed to create lasting changes in teaching and learning by strengthening school leaders' capabilities for distributed leadership, evidence-driven decision-making, and co-creation to improve student learning. With more than 100 educational teams having participated, the program represents a practical application of the principles that have driven Estonia's consistent success in PISA assessments.

Kjo kumtesë do të shqyrtojë mundësuesit institucionalë dhe kombëtarë që kanë dalë në pah gjatë zbatimit të programit që prej vitit 2017. Rezultatet për shkollat dhe universitetin prezantohen mbi bazën e monitorimit, duke analizuar pikat e forta dhe sfidat, si dhe duke ofruar rekomandime për zhvillimet e ardhshme në fushën e përmirësimit të shkollave dhe partneriteteve kërkim–praktikë.

This keynote will explore the institutional and national enablers that have emerged during the program's implementation since 2017. The outcomes for both schools and the university are detailed based on monitoring results, with the strengths and challenges analysed to provide recommendations for future developments in school improvement and research-practice partnerships.



Kätlin Vanari

Biografia

Kätlin Vanari është bashkëpunëtore e re kërkimore në Akademinë për Lidership Arsimor të Universitetit të Tallinn-it. Ajo ka përvojë të gjerë në lidershipin dhe menaxhimin e arsimit të lartë, duke udhëhequr nisma për përmirësimin e cilësisë akademike, nxitjen e inovacionit dhe mbështetjen e zhvillimit organizativ. Mban dy diploma masteri, një në Sociologji dhe një në Shkenca të Edukimit, ndërsa hulumtimi i saj doktoral eksploron kompleksitetin e përmirësimit të shkollave përmes teorisë së sistemeve sociale, me fokus në lidershipin arsimor, zhvillimin e kurrikulës dhe vetëvlerësimin e shkollës.

Biography

Kätlin Vanari is a Junior Research Fellow at the Academy for Educational Leadership at Tallinn University. She has extensive experience in higher education leadership and management, leading initiatives to improve academic quality, foster innovation, and support organizational development. She holds two master’s degrees, one in Sociology and one in Educational Sciences, and her doctoral research explores the complexity of school improvement through social systems theory, with a focus on educational leadership, curriculum development, and school self-evaluation.

Praktika të suksesshme dhe risi në zhvillimin profesional të drejtuesve arsimorë

Successful practices and innovations in the professional development of educational leaders

Dr. Aida Goga

Abstrakt

Ky punim analizon zhvillimin profesional të udhëheqësve arsimorë bazuar në disa praktika të suksesshme në vende të ndryshme, si Estonia, Kroacia etj., si dhe trajton rastin e formimit, edukimit dhe zhvillimit profesional të drejtuesve arsimorë në Shqipëri. Përmes kësaj trajtese, del në pah rëndësia e përmirësimit të mëtejshëm dhe zhvillimit profesional të drejtuesve dhe programeve përgatitore, por edhe nevoja e shkëmbimit të përvojave midis Shqipërisë dhe Kosovës në këtë drejtim. Ky studim bazohet në një meta-analizë të studimeve në këtë fushë, rregullimit ligjor dhe profesional, Programeve Kombëtare për Zhvillim Profesional, politikave arsimore, udhëzuesve për zhvillimin profesional të drejtuesve, si dhe praktikave të bazuara në standardet e drejtuesve arsimorë.

Zhvillimi profesional efektiv i drejtuesve ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe rezultateve të nxënësit, prandaj është e domosdoshme të zhvillohet lidershipi pedagogjik në institucionet arsimore. Praktika mjaft të mira ofrohen nga përvoja ndërkombëtare lidhur me zhvillimin profesional të drejtuesve, të cilat duhet në mënyrë të vazhduar të pasurojnë sistemet tona arsimore

Abstract

This paper analyzes the professional development of educational leaders based on successful practices from various countries, including Estonia and Croatia, while also examining the formation, education, and professional development of school leaders in Albania. Through this analysis, the study highlights the importance of ongoing professional growth, preparatory programs for leaders, and the need for experience-sharing between Albania and Kosovo. The study draws on a meta-analysis of research in this field, legal and professional regulations, National Professional Development Programs, educational policies, guidelines for leadership development, and practices based on established educational leadership standards.

Effective professional development of school leaders directly impacts teaching quality and student outcomes, emphasizing the need to strengthen pedagogical leadership within educational institutions. International experiences offer valuable models for continuous improvement in our educational systems. All professional development organizations - including universities,

duke krijuar mundësi për përmirësim të vazhdueshëm. Me fokus të veçantë të gjithë organizmat për zhvillim profesional, duke filluar nga universitetet, rrjetet profesionale, Programet e Trajnimit të Detyrueshëm të Drejtuesve e të tjerë, duhet të përmirësojnë kontributin e tyre duke ndikuar në rritjen e performancës së drejtuesve bazuar në nevojat aktuale që ka edukimi sot. Një rol të rëndësishëm luajnë praktikat efektive të drejtuesve arsimorë, duke nxitur klimën e bashkëpunimit në institucion, krijimin e një komuniteti të të nxënit, si dhe identifikimin e nevojave reale për zhvillim profesional, duke promovuar kështu rolin e tyre si udhëheqës pedagogjikë, përmes zhvillimit profesional të vetes dhe të tjerëve. Format e zhvillimit profesional janë të larmishme dhe implementimi i tyre varet nga shumë faktorë, por praktikat aktuale të zhvillimit profesional në bazë shkolle mund të jenë funksionale dhe efektive nëse zhvillimi profesional i drejtuesve mbështetet nga ana ligjore dhe krijohet një model i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm.

Fjalët çelës: zhvillim profesional, drejtues arsimorë, lidership pedagogjik

professional networks, and Mandatory Training Programs for School Leaders—should enhance their contributions by responding to the current needs of education. Effective leadership practices foster collaborative school climates, create learning communities, and identify real professional development needs, thereby promoting leaders as pedagogical guides through the development of their own and others' professional skills.

Professional development formats are diverse, and their implementation depends on multiple factors. However, current school-based professional development practices can be functional and effective if they are supported by legal frameworks and structured into a sustainable and continuous model.

Keywords: professional development, educational leaders, pedagogical leadership



Prof. asoc. dr. Aida Goga

Biografia

Prof. asoc.dr. Aida Goga është lektore në Departamentin e Filozofisë, Universiteti i Tiranës. Prej vitit 2016-2024 ka qenë përgjegjëse e Departamentit të Filozofisë. Ajo u diplomua në Filozofi, në vitin 2000, në Departamentin e Filozofisë, Universiteti i Tiranës. Ka marrë titullin Profesor i Asociuar në Filozofi, në vitin 2022. Fushat e saj të interesit janë mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në fushën e filozofisë, edukimit, etikës dhe lidershipit. Ekspertiza e saj në këto fusha përfshin mësimdhënien në nivelin bachelor dhe nivelin master, si dhe punën kërkimore dhe botimet në këto fusha. Ajo është autore e mbi 30 referimeve dhe botimeve, në vend dhe jashtë tij. Aktualisht ligjëron në Hyrje në filozofi, Lidershipi dhe standardet, Teori etike bashkëkohore, Shkenca Edukimi etj. Kurrikulumi i saj përfshin dhe një eksperiencë të gjatë si eksperte në institucione e organizata të ndryshme. Që nga viti 2020, ajo është eksperte në Shkollën e Drejtorëve (Center for School Leadership).

Biography

Assoc. Prof. Dr. Aida Goga is a lecturer in the Department of Philosophy at the University of Tirana. From 2016 to 2024, she served as Head of the Department of Philosophy. She graduated in Philosophy in 2000 from the Department of Philosophy, University of Tirana, and was awarded the title of Associate Professor in Philosophy in 2022. Her research and teaching interests include philosophy, education, ethics, and leadership. Her expertise encompasses teaching at both the bachelor's and master's levels, as well as research and publications in these fields. She is the author of over 30 publications and scholarly works, nationally and internationally. Currently, she teaches courses such as Introduction to Philosophy, Leadership and Standards, Contemporary Ethical Theory, and Educational Sciences. Her curriculum vitae also reflects extensive experience as an expert in various institutions and organizations. Since 2020, she has served as an expert at the School of Directors (*Center for School Leadership*).

Podkastet si mjete për komunikim dhe të mësuarit gjatë gjjithë jetës në arsimin parauniversitar

Podcasts as tools for communication and Lifelong Learning in Pre-University Education

Afrim Aliti
Universiteti i Evropës Juglindore
E-mail: a.aliti@seeu.edu.mk

Demush Bajrami
Universiteti i Evropës Juglindore
E-mail: d.bajrami@seeu.edu.mk

Abstrakt

Me përdorimin gjithnjë e në rritje të mjeteve të teknologjisë së infomimit dhe komunikimit (TIK) në fushën arsimore, podkastet janë shfaqur si mjete fleksibile dhe të arritshme për të përmirësuar komunikimin, mësimdhënien dhe të nxënit në faza të ndryshme arsimore. Megjithatë, integrimet efektive të podkasteve në mjediset e arsimit të hershëm, fillor dhe të mesëm, vërehen të jenë të paeksploruara. Prandaj, ky punim përdorë një qasje sistematike rishikimi për të shqyrtuar se sa efektive kanë qenë podkastet në nxitjen e komunikimit, angazhimin e nxënësve dhe zhvillimin e aftësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Pas një kërkimi të thelluar të literaturës ekzistuese, janë analizuar 16 studime të recensuara. Ky rishikim nxjerr në pah përfitimet e aftësive të përmirësuara të të dëgjuarit dhe të të folurit, bashkëpunimitn efektiv, aftësitë e forta të të menduarit kritik dhe njohuri të rëndësishme informacioni për ndërhyrjet e bazuara në podkaste. Pikërisht për këtë, podkastet afirmohen si një

Abstract

With the increasing use of Information and Communication Technology (ICT) in the field of education, podcasts have emerged as flexible and accessible tools for enhancing communication, teaching, and learning at different educational stages. However, the effective integration of podcasts into early childhood, primary, and secondary education remains largely underexplored. Therefore, this paper adopts a systematic review approach to examine the effectiveness of podcasts in fostering communication, student engagement, and the development of lifelong learning skills. After a thorough review of existing literature, 16 peer-reviewed studies were analyzed. The findings highlight the benefits of improved listening and speaking skills, effective collaboration, strengthened critical thinking, and valuable insights regarding podcast-based interventions. Consequently, podcasts are affirmed as an

alternativë efektive ndaj metodave tradicionale të mësimdhënies, sepse ofrojnë perspektiva për të nxënit fleksibël dhe gjithëpërfshirës.

Ky punim, ofron rekomandime të bazuara në prova për politikëbërësit, institucionet dhe edukatorët për të integruar mediat e podkasteve në mjediset e të nxënit për të përmirësuar kompetencat e komunikimit që do të ngjallnin të nxënit gjatë gjithë jetës që nga mosha e hershme.

Fjalë çelës: Podkastet, komunikimi, TIK, të mësuarit gjatë gjithë jetës, angazhimi i nxënësve

effective alternative to traditional teaching methods, as they offer opportunities for flexible and inclusive learning.

This paper provides evidence-based recommendations for policymakers, institutions, and educators to integrate podcasts into learning environments, with the aim of enhancing communication competencies and promoting lifelong learning from an early age.

Keywords: podcasts, communication, ICT, lifelong learning, student engagement

Raport analitik mbi provimin e maturës shtetërore

Analytical report on the state Matura exam

Agon Ahmeti
Organizata ETEA
E-mail: agonahmeti@gmail.com

Bleona Kurteshi
Universiteti i Prishtinës
E-mail: bleonaakurteshi@gmail.com

Abstrakt

Ky punim paraqet gjetjet e një analize kritike të realizuar nga organizata ETEA mbi Provimin e Maturës Shtetërore në Kosovë. Studimi bazohet në metodologji cilësore, përfshirë fokus-grupe me nxënës dhe mësimdhënës, si dhe analizë të dokumenteve institucionale relevante. Qëllimi i tij është të identifikojë lëshimet dhe sfidat ekzistuese në organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore, të ofrojë rekomandime për përmirësimin e këtij procesi dhe të nxisë politika arsimore të bazuara në të dhëna për të zhvilluar cilësinë e arsimit në Kosovë.

Gjetjet theksojnë mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet përmbajtjes së testit dhe asaj që mësohet realisht në shkolla, barasvlerësim të debatueshëm të notës mesatare me rezultatet e testit, dhe mungesë të mekanizmave të qartë të llogaridhënies. Raporti dokumenton shqetësime të theksuara për stresin psikologjik që përjetojnë maturantët, përhapjen e kopjimit të toleruar institucionalisht, dhe ndjesinë e

Abstract

This paper presents the findings of a critical analysis conducted by the organization **ETEA** on the State Matura Exam in Kosovo. The study is based on qualitative methodology, including focus groups with students and teachers, as well as an analysis of relevant institutional documents. Its aim is to identify the shortcomings and existing challenges in the organization and administration of the State Matura Exam, to provide recommendations for improving this process, and to stimulate evidence-based education policies that enhance the quality of education in Kosovo.

The findings highlight significant discrepancies between the content of the exam and what is actually taught in schools, a debatable equivalence between the grade point average and test results, and the absence of clear accountability mechanisms. The report documents serious concerns about the psychological stress experienced by students, the prevalence of institutionally tolerated cheating, and the overall

përgjithshme të padrejtësisë që ndikon në motivimin dhe mirëqenien e tyre.

Rekomandohet një reformë gjithëpërfshirëse e Provimit të Maturës Shtetërore, duke reduktuar mbështetjen në një provim të vetëm dhe duke promovuar vlerësim të kombinuar që reflekton më drejtë përpjekjet e nxënësve. Përmes këtij studimi, synohet të kontribuohet në ndërtimin e një sistemi të vlerësimit që përforcon integritetin, besimin në institucionet arsimore dhe orientimin e drejtë profesional të të rinjve në përputhje me aftësitë dhe interesat e tyre.

Fjalë çelës: maturantë, Provimi i Maturës Shtetërore, integritet akademik, politika arsimore

sense of unfairness that undermines their motivation and well-being.

The study recommends a comprehensive reform of the State Matura Exam, reducing reliance on a single exam and promoting a combined assessment model that more fairly reflects students' efforts. Through this research, the intention is to contribute to building an assessment system that reinforces integrity, strengthens trust in educational institutions, and ensures appropriate professional orientation of young people in line with their abilities and interests.

Keywords: high school graduates, State Matura Exam, academic integrity, education policy

Fjalëformimi në tekstet e AMU-së dhe problematikat e trajtimit të tij (*Përmirësimi i kurrikulave dhe planeve mësimore*)

Word formation in AMU texts and challenges in its treatment *(Improving Curricula and Lesson Plans)*

Albana Deda (Ndoja)
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë
E-mail: albana.deda@fhf.edu.al

Abstrakt

Problematikat në tekstet parauniverstare të gjuhës shqipe dhe letërsisë ka vite që janë identifikuar edhe nga publiku i gjerë. Specialistët e fushës i kanë parashtruar ato në një numër konferencash të mbajtura përgjatë dy dekadave, që ne jemi pjesë e këtij grupi interesi. Fatkeqësisht, shumë pak janë reflektuar në lidhje me përmirësimin e situatës. Një ndër faktorët që ndikojnë në këtë panoramë janë edhe kurrikulat e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Po kështu, edhe problematikat e bartura nga tekstet referuese gjatë hartimit të teksteve të nivelit parauniversitar shtojnë gamën e problemeve që shfaqen në këto tekste. Në këtë punim synojmë të qartësojmë situatën në lidhje me disa nga problematikat që lidhen me fjalëformimin dhe të japim alternativa në lidhje me to.

Metodologjia që do të përdoret në këtë punim reflekton një ndërthurje të metodave sasiore me ato cilësore, pasi fillimisht identifikohet problematika në tekstet parauniversitare, në një pjesë prej tyre (AMU), dhe pastaj fillon analiza cilësore, gjatë së cilës përqasim trajtimet referuese

Abstract

Issues in pre-university texts of Albanian language and literature have been recognized for years by both specialists and the general public. Experts in the field have discussed these problems in numerous conferences over the past two decades. Unfortunately, few measures have been taken to improve the situation. One contributing factor is the curricula for Albanian language and literature. Additionally, issues inherited from reference texts during the preparation of pre-university textbooks exacerbate these problems. This paper aims to clarify some of the issues related to word formation and propose alternative approaches.

The methodology combines quantitative and qualitative methods: initially, word formation issues are identified in a subset of pre-university texts (AMU), followed by a qualitative analysis comparing reference treatments with those found in textbooks. Alternative approaches proposed are grounded in Generative Grammar (the concept of

me ato që gjenden në tekstet parauniversitare. Trajtimet alternative që jepen si zgjidhje e këtyre problematikave i përkasin Gramatikës Gjenerative fillimisht (me konceptin e kokës) dhe pastaj Gramatikës së Konstruktit (me matricat që përfaqësojnë rregulla fjalëformuese).

Të dhënat që analizohen në këtë punim mblidhen fillimisht nga trajtimet në tekstet e tri shtëpive botuese kryesore në Shqipëri: Albas, Pegi, Filara (mbështetemi kryesisht në trajtimin në sistem AMU, pasi në AML dihet që këto çështje nuk janë në fokusin e tyre kryesor dhe janë trajtime remineshente të atyre që gjenden në AMU). Analiza fillon me terminologjitë në lidhje me konceptet e morfemës dhe llojeve të saj, temës së fjalës dhe temës fjalëformuese, dhe llojeve të tipave të fjalëformimit. Vihen re problematika të shumta që kanë të bëjnë me dallimin e llojeve të morfemave ndajshtesore dhe konceptit të fjalës tradicionale; fjalëformimi prapavajtës, lokucionet, rëniet e tingujve, apo modifikimet e tyre etj. (të cilat nuk parashikohen në grupin e gjedheve fjalëformuese përfaqësuese), dallimit parashtesim, kompozitë dhe përngjitje etj., konversion dhe prejardhje pa ndajshtesë. Vihet re se nuk ka përcaktime të sakta të modifikimeve gramatikore, fonologjike, ortografike etj., të cilat të studiohen në korpuse të gjera e të përcaktojnë rregulla fjalëformuese specifike për formante fjalëformuese. Kriteri semantik, megjithëse parashikohet, pothuajse nuk aplikohet në analizë. Kriteri gramatikor është shumë sporadik, me pohime shumë sipërfaqësore, dhe nuk i

the “head”) and Construct Grammar (matrices representing word formation rules).

Data were collected from three main Albanian publishers—Albas, Pegi, and Filara—with primary focus on AMU treatments, as AML texts largely reflect residual approaches from AMU and do not emphasize these issues.

The analysis begins with terminology related to morphemes, word stems, word formation stems, and types of word formation. Numerous issues were observed, including differentiation of affix types and traditional word concepts, regressive word formation, idiomatic expressions, sound losses and modifications, prefixation, composition and attachment, conversion, and derivation without affixation. Precise definitions for grammatical, phonological, and orthographic modifications, which could inform specific word formation rules, are largely absent.

Semantic criteria, though mentioned, are rarely applied; grammatical criteria are sporadic and superficial; phonological and orthographic criteria are not addressed. As a result, functional word formation rules are largely missing.

The study emphasizes the need to reconsider key concepts of word formation analysis and to conceptualize semantic, phonological, and grammatical criteria in descriptions. Problematic issues should be addressed within the framework of Construct Grammar, initially examining

parashikon të gjitha formantet fjalëformuese. Kriteri fonologjik dhe ortografik nuk parashikohet fare në analizë. Praktikisht nuk kemi rregulla fjalëformuese.

Punimi synon të reflektojë faktin se ritrajtimi i koncepteve kryesore, që janë pjesë e analizës fjalëformuese, është i domosdoshëm. Po kështu, rikonceptimi i kriterit semantik, fonologjik dhe gramatikor, në përshkrimin e këtyre proceseve duhet të jetë pjesë e përshkrimit. Edhe trajtimi i problematikave të parashtruara duhet të bëhet në kuadrin e trajtimit të Gramatikës së Konstruktit, duke hulumtuar në këtë kontekst fillimisht formantet kryesore që janë prodhimtare, qofshin këto koka ose jo. Më tej duhet bërë shtrirja e studimit në kompozim dhe konversion etj. Gjithashtu, gjykojmë se është domosdoshmëri reflektimi i këtyre trajtimeve në nivel parauniversitar.

Fjalët çelës: temë fjale, formant, kokë, nivel semantik, nivel kategorial, matricë fjalëformuese

productive word formation morphemes, whether heads or not, and extending the study to composition and conversion. It is essential that these treatments are reflected at the pre-university level.

Keywords: word stem, formant, head, semantic level, categorical level, word formation matrix.

Sfidat dhe strategjitë për zhvillimin e shkencave ndërdisiplinore në Kosovë dhe mundësitë për integrimin e tyre në programet ndërkombëtare

Challenges and strategies for the development of interdisciplinary sciences in Kosovo and opportunities for heir integration into international programs

Amantina Pervizaj Kelmendi
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Në epokën e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar dhe përballjes me sfida globale komplekse, zhvillimi i shkencave ndërdisiplinore përfaqëson një domosdoshmëri për sistemet arsimore dhe kërkimore, që synojnë avancim, inovacion dhe konkurrencë. Ky studim analizon gjendjen aktuale të shkencave ndërdisiplinore në Kosovë, duke adresuar sfidat strukturore, institucionale dhe konceptuale, të cilat pengojnë zhvillimin e tyre, si mungesa e fondeve të dedikuara, kapacitetet e kufizuara administrative, politikat e pakoordinuara dhe qasjet tradicionale në arsim. Paralelisht, studimi shqyrton mundësitë për integrimin e tyre në programe ndërkombëtare, si Horizon Europe dhe strukturat e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA).

Qasja metodologjike është shumëdimensionale dhe synon prodhimin e evidencës së qëndrueshme për nivelin e politikave dhe praktikave akademike. Studimi kombinon: (1) të dhëna sasiore nga 100 pjesëmarrës, përmes pyetësorëve statistikorë të shpërndarë në komunitetin akademik e politikëbërës; (2) intervista gjysmë të strukturuara, me 25 profesorë,

Abstract

In the era of international scientific collaboration and complex global challenges, the development of interdisciplinary sciences represents a necessity for educational and research systems aiming for advancement, innovation, and competitiveness. This study analyzes the current state of interdisciplinary sciences in Kosovo, addressing the structural, institutional, and conceptual challenges hindering their development, such as the lack of dedicated funding, limited administrative capacities, uncoordinated policies, and traditional approaches in education. At the same time, it examines opportunities for their integration into international programs such as Horizon Europe and the structures of the European Research Area (ERA).

The methodological approach is multidimensional, designed to generate sustainable evidence for both policymaking and academic practice. The study combines: (1) quantitative data from 100 participants through statistical questionnaires distributed across the academic and policymaking community; (2) semi-structured interviews with 25 professors, vice-rectors, and experts recognized

prorektorë dhe ekspertë të identifikuar për kontributin e tyre në kërkimin ndërdisiplinor; (3) analizë të dokumenteve strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë raportet e Komisionit Evropian dhe organizatave partnere në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Analiza tematike dhe krahasuese zbulon se mungesa e fondeve dhe ngarkesa administrative janë pengesat dominuese, ndërsa politikat e papërshtatshme dhe barrierat strukturore e vështirësojnë zhvillimin. Megjithatë, ekziston një konsensus i gjerë mbi rëndësinë e ndërdisiplinaritetit për rritjen e cilësisë akademike dhe përfitimet që ofrojnë programet ndërkombëtare.

Kontributi i studimit është i dyfishtë: në nivel teorik, ai pasuron literaturën mbi vendet në zhvillim që synojnë integrimin në agjendat ndërkombëtare të kërkimit; në nivel praktik, ai ofron rekomandime të zbatueshme për krijimin e strukturave të dedikuara institucionale, rritjen e financimit, thjeshtimin e procedurave, hartimin e një strategjie kombëtare për kërkimin ndërdisiplinor dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së Kosovës në bashkëpunimet shkencore ndërkombëtare. Këto masa janë thelbësore për ndërtimin e një ekosistemi kërkimor konkurrues dhe të integruar në standardet evropiane.

Fjalët çelës: shkenca ndërdisiplinore, kërkim i integruar, politika arsimore, zhvillim akademik, analiza strategjike, sfida kërkimore, integrimi ndërkombëtar

for their contributions to interdisciplinary research; and (3) in-depth analysis of national and international strategic documents, including European Commission reports and documents of international partner organizations active in research and innovation.

Thematic and comparative analysis reveals that lack of funding and administrative overload are the dominant barriers, while inadequate policies and structural obstacles further constrain development. Nevertheless, there is broad consensus on the importance of interdisciplinarity for academic quality and innovation, as well as recognition of the opportunities offered by international programs.

The contribution of the study is twofold: at the theoretical level, it enriches the literature on developing countries striving to integrate into international research agendas; at the practical level, it provides actionable recommendations for establishing dedicated institutional structures, increasing funding, simplifying procedures, drafting a national strategy for interdisciplinary research, and strengthening Kosovo's participation in international scientific collaborations. These measures are essential for building a competitive research ecosystem aligned with European standards.

Keywords: interdisciplinary sciences, integrated research, education policy, academic development, strategic analysis, research challenges, international integration

Ndërlidhja ndërmjet zhvillimit emocional, kognitiv dhe social të fëmijëve në prag të klasës së parë

The interconnection between emotional, cognitive and social development of children on the eve of first grade

Anita Beiqi
"Ora Education"
E-mail: aanitabeiqi@gmail.com

Vesa Bardheci
"Horizon School"
E-mail: vesabardheci@gmail.com

Abstrakt

Përgatitja për shkollë është një proces shumëdimensional, i ndikuar nga faktorë të ndryshëm që lidhen me zhvillimin emocional, kognitiv dhe social të fëmijëve. Ky proces është thelbësor për përgatitjen e fëmijëve ndaj sfidave të klasës së parë, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për t'u përballur me ambientin shkollor dhe për të krijuar themelet e një arsimimi të suksesshëm. Gjatë periudhës parashkollore, ndërlidhja mes zhvillimit emocional, kognitiv dhe social është vërejtur si një komponent kyç, pasi fëmijët e kësaj moshe janë në një fazë të zhvillimit që ndikojnë në formimin e aftësive të tyre.

Ky studim ka shqyrtuar dhe analizuar ndërlidhjen mes këtyre aspekteve të zhvillimit në përgatitjen për klasën e parë dhe ka vlerësuar praktikat edukative që e kanë mbështetur këtë proces. Studimi do të realizohet duke përdorur metodën cilësore dhe do të mbështetet në intervista gjysmë të strukturuara, me edukatore dhe mësimdhënëse. Kjo qasje ka mundësuar mbledhjen e të dhënave

Abstract

School readiness is a multidimensional process influenced by various factors related to children's emotional, cognitive, and social development. This process is essential in preparing children for the challenges of first grade, enabling them to develop the skills necessary to navigate the school environment and establish the foundations for successful learning. During the preschool period, the interconnection between emotional, cognitive, and social development has been identified as a key component, as children at this age are in a developmental stage that shapes their abilities.

This study examined and analyzed the interconnection among these developmental aspects in preparation for first grade and evaluated educational practices that support this process. A qualitative methodology was employed, relying on semi-structured interviews with preschool educators and teachers. This approach allowed for the collection of data on educational practices and

mbi praktikat edukative dhe përvojat e tyre. Gjetjet e këtij hulumtimi pritet të ofrojnë informacione të vlefshme për praktika më të mira në përgatitjen e fëmijëve për shkollën, duke përfshirë mënyra më efektive për mbështetjen e zhvillimit të tyre emocional, kognitiv dhe social.

Fjalët çelës: fëmijët, klasa parafillore, klasa e parë, zhvillimi emocional, zhvillimi kognitiv, zhvillimi social

professional experiences. The findings are expected to provide valuable insights for improving school readiness practices, including effective strategies to support children's emotional, cognitive, and social development.

Keywords: children, preschool, first grade, emotional development, cognitive development, social development

Edukimi dhe emancipimi i femrës në Kosovë (1945–1975): Politikat arsimore dhe sfidat shoqërore

Education and emancipation of women in Kosovo (1945–1975): Educational policies and social challenges

Arben Berisha
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Filozofik
E-mail: hetiti@hotmail.de dhe arben.berisha@kosovopolice.com

Behxhet Dibrani
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Filozofik
E-mail: bdibrani@hotmail.com

Abstrakt

Punimi trajton procesin e edukimit dhe emancipimit të femrës shqiptare në Kosovë në periudhën 1945–1975, duke u mbështetur në dokumente historike, statistika arsimore dhe analiza të politikave shtetërore dhe shoqërore të kohës. Qëllimi i studimit është që të qartësohet se sa ishte niveli i analfabetizmit te gratë shqiptare pas vitit 1945, si dhe të paraqiten përpjekjet për emancipimin e tyre.

Duke përdorur metodën përshkruese, do të analizohen masat institucionale, si Ligji për arsimin e detyrueshëm, organizimi i kurseve kundër analfabetizmit dhe kurseve shëndetësore. Analizohen po ashtu format e pengesave familjare, si manipulimi me të dhënat e lindjes, fejesa e hershme dhe praktikat e izolimit, si bartja e ferexhesë.

Pas analizimit të burimeve dhe statistikave nga institucionet përkatëse që janë marrë me problemin e edukimit, do të krijohet një pasqyrë më e qartë dhe e saktë se çfarë ka qenë gjendja e emancipimit të femrave në Kosovë nga vitet 1945-1975. Është me rëndësishme të dihet se sa e

Abstract

This study examines the process of education and emancipation of Albanian women in Kosovo during the period 1945–1975, drawing on historical documents, educational statistics, and analyses of state and social policies of the time. The aim is to clarify the level of female illiteracy after 1945 and to present efforts made toward women's emancipation.

Using a descriptive methodology, the study analyzes institutional measures, including the Law on Compulsory Education, literacy courses, and health education programs. It also considers familial barriers such as manipulation of birth records, early engagement, isolation practices, and the use of the veil.

By analyzing sources and statistics from relevant institutions addressing educational issues, the study provides a clearer and more accurate picture of the status of women's emancipation in Kosovo from 1945 to 1975. Understanding the difficulties of

vështirë ishte rruga e emancipimit të femrës shqiptare pas vitit 1945, sepse me emancipimin e saj edhe shoqëria shqiptare do të ngrihej dhe avancohej më lart, në të gjitha institucionet edukative, dhe kjo do të ishte një moment shumë i rëndësishëm edhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe shtetërore. Studimi nxjerr në pah përmasën shumëdimensionale të emancipimit, duke e lidhur zhvillimin arsimor me transformimin e roleve gjinore dhe modernizimin shoqëror në Kosovë gjatë periudhës socialiste.

Fjalët çelës: edukimi i femrës, emancipimi, analfabetizmi në Kosovë, shkollimi i vajzave, politikat arsimore

women's emancipation is essential, as their advancement contributed significantly to broader societal progress, educational development, and the rise of national and state consciousness. The study highlights the multidimensional nature of emancipation, linking educational development with changes in gender roles and social modernization in Kosovo during the socialist period.

Keywords: women's education, emancipation, illiteracy in Kosovo, girls' schooling, educational policies

Roli i mësimdhënësit mbështetës në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta (Studim rasti)

The role of the support teacher in the inclusion of students with special needs: A case study

Arben Zabeli
Shkolla jopublike “Mileniumi i Tretë”
E-mail: arben.zabeli@mileniumi3.net

Abstrakt

Mësimdhënësi mbështetës luan një rol thelbësor në promovimin e gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta, duke kontribuar në zhvillimin e tyre akademik, social dhe emocional, si dhe në ndërtimin e një klime shkollore mbështetëse dhe të barabartë. Ky studim kualitativ synon të eksplorojë dimensionet e këtij roli përmes përvojave të drejtpërdrejta të aktorëve të përfshirë në procesin edukativo-arsimor.

Në fokus të hulumtimit janë pesë mësues të ciklit fillor (klasat 1–5), pesë kujdestarë klasash, të ciklit të mesëm të ulët (klasat 6–9), si dhe prindër të fëmijëve që marrin shërbime nga mësimdhënësit mbështetës. Qëllimi është të shqyrtohet ndërveprimi ndërmjet këtyre palëve dhe të vlerësohet ndikimi i bashkëpunimit të tyre në mbështetjen efektive të nxënësve me nevoja të veçanta.

Studimi do të përdorë një qasje kualitative, ku të dhënat do të mblidhen kryesisht përmes intervistave gjysmë të strukturuara dhe do t’i nënshtrohen analizës tematike. Ky proces përfshin transkriptimin, kodimin dhe identifikimin e temave dominuese, duke

Abstract

The support teacher plays a crucial role in promoting the full inclusion of students with special needs, contributing to their academic, social, and emotional development, as well as fostering a supportive and equitable school climate. This qualitative study aims to explore the dimensions of this role through the direct experiences of stakeholders involved in the educational process.

The study focuses on five primary school teachers (grades 1–5), five class tutors from lower secondary (grades 6–9), and parents of children receiving support services from support teachers. The aim is to examine the interaction among these parties and assess the impact of their collaboration on the effective support of students with special needs.

A qualitative approach will be employed, with data primarily collected through semi-structured interviews and analyzed thematically. The process includes transcription, coding, and identification of dominant themes to uncover diverse perspectives

synuar të zbulojë perspektiva të ndryshme dhe të ofrojë një kuptim më të thelluar të praktikave aktuale në kontekstin arsimor.

Gjetjet e pritshme pritet të kontribuojnë në avancimin e praktikave përfshirëse dhe në formulimin e rekomandimeve konkrete për fuqizimin e rolit të mësimdhënësit mbështetës në bashkëpunim me mësuesit e klasës dhe prindërit.

Fjalët çelës: mësimdhënës mbështetës, edukim gjithëpërfshirës, nxënës me nevoja të veçanta, bashkëpunim, analizë tematike

and provide deeper insight into current practices in the educational context.

The expected findings are anticipated to contribute to the advancement of inclusive practices and to inform concrete recommendations for strengthening the role of the support teacher in collaboration with classroom teachers and parents.

Keywords: support teacher, inclusive education, students with special needs, collaboration, thematic analysis

Tekstet dhe materialet mësimore që përdoren në shkollat profesionale

Textbooks and learning materials used in vocational schools

Arbnesha Mexhuani
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: arbnesha.mexhuani@gmail.com

Skender Mekolli
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: skender.mekolli@gmail.com

Abstrakt

Ndër problemet e ngritura vazhdimisht në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional është përdorimi dhe cilësia e teksteve dhe materialeve mësimore për shumicën e profileve në shkollat profesionale. Qëllimi i studimit është të vlerësojë gjendjen aktuale të shkollave profesionale në lidhje me përdorimin dhe cilësinë e teksteve dhe materialeve mësimore nga nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave profesionale, si dhe identifikimin e sfidave dhe kërkesave gjatë përdorimit të teksteve dhe materialeve mësimore.

Në këtë studim është përdorur qasja hulumtuese e përzier (sasiore dhe cilësore). Mostra është e qëllimshme, përbëhet nga 18 mësimdhënës dhe 150 nxënës të profileve të ndryshme të shkollave profesionale. Studimi është realizuar në të gjitha shkollat profesionale (tetë) të komunës së Prishtinës.

Për mbledhjen e të dhënave sasiore nga nxënësit është përdorur pyetësori, ndërsa për mbledhjen e të dhënave cilësore është përdorur intervista

Abstract

The use and quality of textbooks and learning materials in vocational schools remain a persistent challenge in the field of education and vocational training. This study aims to assess the current status of vocational schools regarding the use and quality of textbooks and learning materials among students and teachers, as well as to identify challenges and needs during their use.

A mixed-methods research approach (quantitative and qualitative) was employed. The purposive sample included 18 teachers and 150 students from various vocational profiles. The study was conducted across all eight vocational schools in the municipality of Prishtina.

Quantitative data were collected from students through questionnaires, while qualitative data were gathered via semi-structured interviews with teachers. This approach enabled identification of

gjysmë e strukturar, me 18 mësimdhënës, dhe përmes kësaj qasjeje janë identifikuar llojet e teksteve dhe materialeve fizike dhe digjitale që i përdorin mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave profesionale, si dhe sfidat dhe kërkesat që i kanë hasur mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë përdorimit të tyre.

Rezultatet tregojnë se ka shumë pak tekste dhe materiale mësimore për lëndët profesionale, po ashtu cilësia e materialeve që posedojnë vlerësohet ulët për shkak të përmbajtjes së vjetërsuar dhe mungesës së përshtatjes me plan-programin. Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve dhe mësimdhënësve përdorin materiale alternative digjitale, nga interneti (YouTube, ChatGPT), për të kompensuar mungesën e literaturës adekuate.

Rekomandohet përgatitja e teksteve shkollore të përshtatura me realitetin lokal dhe plan-programet e arsimit profesional ,mbështetja e shkollave për zhvillimin e materialeve digjitale cilësore dhe trajnimi i mësimdhënësve për hartimin e teksteve dhe materialeve mësimore cilësore. Duke pasur parasysh mungesën e një strategjie arsimore për arsimin profesional, rekomandohet që institucionet përgjegjëse të hartojnë dhe të miratojnë një strategji sektoriale, e cila do të udhëhiqte zhvillimin dhe përmirësimin e arsimit profesional në nivel kombëtar.

Fjalët çelës: materialet mësimore, mësimdhënës, nxënës, tekstet, shkollë profesionale

the types of physical and digital textbooks and materials used, as well as the challenges and demands faced by both teachers and students.

Findings reveal a shortage of textbooks and learning materials for professional subjects. Additionally, the quality of existing materials is rated low due to outdated content and lack of alignment with the curriculum. Many students and teachers use alternative digital resources from the internet (e.g., YouTube, ChatGPT) to compensate for the lack of adequate literature.

Recommendations include the development of textbooks tailored to local realities and vocational education curricula, support for schools in producing quality digital materials, and training for teachers in creating effective learning resources. Given the absence of a national vocational education strategy, it is further recommended that relevant institutions develop and approve a sectorial strategy to guide the advancement of vocational education nationwide.

Keywords: learning materials, teachers, students, textbooks, vocational school.

Metodat mësimore që i përdorin mësimdhënësit e lëndës së gjuhës gjermane në shkollat e Kosovës

Teaching methods used by German Language teachers in schools of Kosovo

Arbron Mexhuani
E-mail: arbron.mexhuani@student-uni.pr.edu
arbronmexhuani@gmail.com

Abstrakt

Studimi ka për qëllim identifikimin e metodave, mjeteve dhe burimeve mësimore që mësimdhënësit i përdorin për të siguruar një mësimdhënie efektive dhe të suksesshme.

Edhe pse ka një shumëllojshmëri metodash dhe qasjesh për ligjërimin e gjuhës gjermane, si gjuhë të huaj në Kosovë, shpesh është e vështirë për mësimdhënësit të zgjedhin metodën më të përshtatshme për secilin nxënës dhe për çdo situatë mësimore, për arsye se ata përballen me grupe të ndryshme nxënësish, të cilët kanë nivele dhe nevoja të ndryshme mësimore, ku secili nxënës ka mundësi të barabarta për të mësuar dhe për të zhvilluar kompetencat për arsimimin gjatë gjithë jetës.

Për të marrë një pasqyrë të përgjithshme të studimit, është përdorur qasja e përzier kërkimore, përmes pyetjes kërkimore *Cilat metoda, mjete dhe burime i përdorin mësimdhënësit e gjuhës gjermane në shkollat e Kosovës?*

Në këtë studim është përdorur qasja e përzier kërkimore, duke kombinuar metodën përshkruese me analizën e të dhënave. Mostra është

Abstract

This study aims to identify the methods, tools, and instructional resources that teachers use to ensure effective and successful teaching.

Although there is a variety of approaches for teaching German as a foreign language in Kosovo, teachers often face challenges in selecting the most appropriate method for each student and situation, as they work with diverse student groups with varying levels and learning needs, while ensuring equal opportunities for all students to develop lifelong competencies.

To provide an overview of the study, a mixed-methods approach was applied, guided by the research question: Which methods, tools, and resources do German language teachers use in schools in Kosovo? The study combined descriptive methodology with data analysis. The sample was randomly selected, and data were collected through questionnaires administered to

përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe të dhënat janë mbledhur përmes pyetësorëve të zhvilluar me 15 mësimdhënës (klasat 6–9) dhe 21 nxënës nga 10 shkolla të komunës së Prishtinës.

Rezultatet e studimit me mësimdhënës tregojnë se një nga metodat që mësimdhënësit e përdorin më së shpeshti gjatë procesit mësimor është metoda e mësimit përmes aktiviteteve të ndryshme, ndërsa rezultatet nga pyetësori me nxënës tregojnë se ata preferojnë më së shumti të përdorin metodën auditive dhe vizuale. Sa u përket mjeteve mësimore, mësimdhënësit kanë deklaruar se tekstet janë mjetet më efektive për nxënien e gjuhës gjermane, ndërsa nxënësit kanë deklaruar se mësimdhënësit TIK-un dhe mediat i përdorin shumë rrallë. Ata rekomandojnë që, për të pasur një mësimdhënie efektive, mësimdhënësit duhet të bëjnë integrimin e këtyre mjeteve/burimeve në mësimdhënie (TIK-TV- programet televizive, filma, muzikë).

Përmes këtij hulumtimi, janë ofruar rekomandime për përmirësimin e metodave të mësimdhënies së gjuhës gjermane, si gjuhë e huaj, për të kontribuar në zhvillimin e praktikave mësimore që u shërbejnë nevojave të nxënësve, duke e bërë mësimin më efektiv dhe më kreativ.

Fjalët çelës: gjuha gjermane, metodat mësimore, mjetet dhe burimet mësimore, mësimdhënësit, nxënësit

15 teachers (grades 6–9) and 21 students from 10 schools in the Prishtina municipality.

Results indicate that teachers most frequently use activity-based learning methods during instruction, whereas students prefer auditory and visual methods. Regarding instructional tools, teachers reported that textbooks are the most effective for learning German, while students noted that teachers rarely use ICT and media resources. Students recommend integrating these tools and resources (ICT, TV programs, films, music) into teaching to enhance learning effectiveness.

This research provides recommendations for improving German language teaching methods as a foreign language, contributing to the development of instructional practices that meet students' needs and making learning more effective and creative.

Keywords: German language, teaching methods, instructional tools and resources, teachers, students

Praktikat gjithëpërfshirëse në orët e gjuhës angleze të arsimit fillor në Kosovë

Inclusive practices in english language classes in primary education in Kosovo

Azra Thaqi Gashi
ShFMU "Lidhja e Prizrenit", Prizren
E-mail: azrathaqi12@gmail.com

Abstrakt

Ky rast studimor cilësor heton zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse në orët e gjuhës angleze, si gjuhë e huaj (EFL) në Kosovë. Studimi fokusohet në mësimdhënësit e gjuhës angleze (ELT) dhe eksploron të kuptuarit e tyre mbi zbatimin e politikave të arsimit gjithëpërfshirës, sfidat me të cilat përballen, praktikat e përdorura, dhe vizionin e tyre për një klasë ideale gjithëpërfshirëse.

Metodologjia kërkimore e përdorur për këtë studim ishte metoda e studimit të rastit, e zgjedhur për përshtatshmërinë e saj, për të ofruar një kuptim të thellë të praktikave të arsimit gjithëpërfshirës në mesin e mësimdhënësve të gjuhës angleze në Kosovë. Intervistat gjysmë të strukturuara u përdorën për të mbledhur të dhëna nga pjesëmarrësit. Më pas, analiza tematike u përdor për të interpretuar të dhënat, duke identifikuar modele dhe tema të përsëritura. Një qasje përshkruese u përshtat për të përshkruar në mënyrë sistematike praktikat më të mira për mësimin e anglishtes dhe nxitjen e gjithëpërfshirjes në institucionet e arsimit fillor. Duke i kombinuar këto metoda, studimi synoi të ofrojë një kuptim

Abstract

This qualitative case study investigates the implementation of inclusive practices in English as a Foreign Language (EFL) classes in primary education in Kosovo. The study focuses on English language teachers (ELT) and explores their understanding of inclusive education policies, the challenges they face, the practices they employ, and their vision of an ideal inclusive classroom.

The research methodology employed was a case study approach, chosen for its suitability to provide an in-depth understanding of inclusive education practices among English language teachers in Kosovo. Semi-structured interviews were conducted to collect data from participants. Subsequently, thematic analysis was used to interpret the data, identifying recurring patterns and themes. A descriptive approach complemented the analysis to systematically outline best practices in teaching English and fostering inclusivity in primary education institutions. By combining these methods, the study aimed to provide a comprehensive

gjithëpërfshirës të praktikave të arsimit gjithëpërfshirës në mesin e mësimdhënësve të gjuhës angleze në Kosovë.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një kuptim të thellë të parimeve të arsimit gjithëpërfshirës, duke nxitur një mjedis të respektueshëm dhe të barabartë. Pavarësisht se përballen me sfida, të tilla si klasat e mbipopulluara, mundësitë e kufizuara të trajnimit dhe rezistencën shoqërore, mësimdhënësit e gjuhës angleze demonstrojnë qëndrueshmëri përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke theksuar përkushtimin e tyre ndaj gjithëpërfshirjes. Ky studim zbulon strategji të ndryshme gjithëpërfshirëse, duke filluar nga dinamika e klasës deri te mbështetja individuale. Këto praktika, pavarësisht kufizimeve, nxjerrin në pah shkathtësinë dhe përshtatshmërinë e mësimdhënësve për të promovuar gjithëpërfshirjen. Ky studim ofron njohuri praktike për iniciativat e ardhshme, duke synuar të sigurojë që çdo nxënës të ketë qasje në arsimin cilësor brenda një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe mbështetës.

Fjalët çelës*:* arsim gjithëpërfshirës, praktika gjithëpërfshirëse, klasë e gjuhës angleze, ELT

understanding of inclusive education practices among English language teachers in Kosovo.

Overall, the findings reveal a deep understanding of inclusive education principles, fostering a respectful and equitable learning environment. Despite challenges such as overcrowded classrooms, limited training opportunities, and social resistance, English language teachers demonstrate resilience through continuous professional development and a strong commitment to inclusivity. The study identifies various inclusive strategies, ranging from classroom dynamics to individual support. These practices, despite constraints, highlight the adaptability and skill of teachers in promoting inclusivity. The study offers practical insights for future initiatives, aiming to ensure that every student has access to quality education within a supportive and inclusive learning environment.

Keywords: inclusive education, inclusive practices, English language classroom, ELT

Rishikimi i kurrikulës si mjet për përmirësim cilësor dhe gjithëpërfshirje në arsimin parauniversitar: Praktika ndërkombëtare dhe perspektiva nga Kosova

Curriculum review as a tool for quality improvement and inclusivity in pre-university education: International practices and perspectives from Kosovo

Bardha Gashi
"Bedri Pejani
E-mail: bardhag2@gmail.com

Abstrakt

Në një kohë kur shoqëritë po përballen me ndryshime të shpejta teknologjike, kulturore dhe sociale, kurrikulat shkollore duhet të përshtaten për të reflektuar këto realitete dhe për të përmbushur nevojat e një brezi gjithnjë e më të ndryshëm. Ky punim synon të analizojë nevojën për përmirësimin e kurrikulave dhe planeve mësimore në arsimin parauniversitar, duke u bazuar në standardet e arsimit gjithëpërfshirës dhe kompetencave kyçe për shekullin XXI.

Duke u mbështetur në të dhëna nga analiza dokumentare, si kurrikulat nga Kosova, Finlanda dhe Estonia, dhe intervista me mësimdhënës dhe drejtues shkollash në Kosovë, studimi shqyrton sfidat aktuale në zbatimin e kurrikulës, si dhe hapësirat për përmirësim. Në Kosovë, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, arsimi gjithëpërfshirës përballet ende me sfida të rëndësishme lidhur me mungesën e burimeve, trajnimet e mësuesve dhe mungesën e lidhjes me sigurimin e barazisë për të gjithë nxënësit. Rezultatet tregojnë se integrimi i metodologjisë aktive ndërdisiplinore dhe përdorimi

Abstract

In an era of rapid technological, cultural, and social changes, school curricula must adapt to reflect these realities and meet the needs of an increasingly diverse generation. This paper aims to analyze the need for improving curricula and lesson plans in pre-university education, based on inclusive education standards and key competencies for the 21st century.

Drawing on data from documentary analysis—including curricula from Kosovo, Finland, and Estonia—and interviews with teachers and school leaders in Kosovo, the study examines current challenges in curriculum implementation and identifies areas for improvement. Despite ongoing efforts, inclusive education in Kosovo still faces significant challenges related to resource shortages, teacher training, and insufficient mechanisms to ensure equity for all students. The findings indicate that integrating active interdisciplinary methodologies and effectively using technology increases student engagement

efektiv i teknologjisë rrisin angazhimin dhe përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor, si dhe përmirësojnë cilësinë e të nxënit. Gjithashtu, përfshirja aktive e mësimdhënësve në zhvillimin dhe rishikimin e planeve mësimore kontribuon në krijimin e një mjedisi arsimor më gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm.

Punimi rekomandon qasje fleksibile dhe kontekstuale në zhvillimin e planeve mësimore, si dhe paraqet rekomandime konkrete për politikat arsimore që synojnë të harmonizojnë përmbajtjen kurrikulare me realitetin e klasës dhe nevojat e të gjithë nxënësve.

Fjalët çelës: kurrikula, planet mësimore, arsimi parauniversitar, përmirësimi cilësor, gjithëpërfshirje, metodologji bashkëkohore, politika arsimore

and inclusion while enhancing learning quality. Furthermore, active teacher involvement in curriculum development and review contributes to creating a more inclusive and responsive educational environment.

The study recommends a flexible and context-sensitive approach to curriculum development and provides concrete policy recommendations aimed at aligning curricular content with classroom realities and the needs of all students.

Keywords: curriculum, lesson plans, pre-university education, quality improvement, inclusivity, modern methodologies, educational policy

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkolla mundëson zhvillimin e të lexuarit të kuptimshëm përmes strategjive ndërvepruese

Improving teaching quality in schools to enhance reading comprehension through interactive strategies

Bardhyl Musai

Abstrakt

Tema e të lexuarit të kuptimshëm në arsimin e obliguar ka fituar rëndësi të veçantë në kontekstin e reformave arsimore dhe vlerësimeve ndërkombëtare, sidomos në PISA, duke theksuar domosdoshmërinë për strategji mësimore ndërvepruese që e fuqizojnë këtë shprehi themelore përmes të nxënit aktiv. Ky studim trajton përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkolla, një nga gjetjet kryesore të rezultateve të pakënaqshme të nxënësve të Kosovës në PISA, strategjitë e të cilave ndikojnë në zhvillimin e të lexuarit të kuptimshëm të nxënësit**.** Qëllimi i hulumtimit ishte të identifikojë dhe të analizojë metodat dhe teknikat më të shpeshta që përdoren për të lexuarit e kuptimshëm të përmbajtjeve mësimore, parashtrimin e pyetjeve që nxitin të menduarit kritik, krijimtarinë, komunikimin përmes diskutimeve ndërvepruese dhe inkurajimin e bashkëpunimit.

Studimi aplikon një qasje të përzier (sasiore dhe cilësore), me mostër të përzgjedhur prej mbi 1000 mësimdhënësish, nga klasa e parë deri në të nëntën. Të dhënat janë mbledhur përmes analizës së teksteve shkollore dhe materialeve mësimore, si dhe pyetësorëve me mësimdhënës. Gjetjet

Abstract

The topic of reading comprehension in compulsory education has gained particular importance within the context of educational reforms and international assessments, especially PISA, highlighting the necessity for interactive teaching strategies that strengthen this fundamental skill through active learning. This study addresses the improvement of teaching quality in schools, one of the main findings underlying Kosovo students' unsatisfactory PISA results, by examining strategies that influence the development of students' reading comprehension. The research aimed to identify and analyze the most commonly used methods and techniques for reading comprehension of curricular content, including the posing of questions that stimulate critical thinking, creativity, communication through interactive discussions, and the encouragement of collaboration.

The study employs a mixed-methods approach (quantitative and qualitative) with a selected sample of over 1,000 teachers, from grades one through nine. Data were collected through the analysis of school texts and teaching materials, as well as teacher questionnaires. Findings indicate

tregojnë se shumë mësimdhënës kanë vështirësi në përzgjedhjen dhe zbatimin e strategjive produktive të të lexuarit e kuptimshëm, për shkak të shprehive të kufizuara metodologjike që burojnë nga mungesa e trajnimeve të duhura për zhvillim profesional.

Rezultatet dëshmojnë gjithashtu se vetëm një përqindje e vogël e mësimdhënësve përdorin strategji të strukturuara, që zhvillojnë në mënyrë të qëndrueshme aftësinë e nxënësve për të kuptuar dhe interpretuar tekstin. Zbatimi në nivel të ulët i këtyre strategjive ndikon drejtpërdrejt në shprehitë bazë të të lexuarit të kuptimshëm dhe që reflektohet në arritjet e pakënaqshme mësimore të nxënësve.

Studimi konfirmon se strategjitë e mësimdhënies janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në zhvillimin e të lexuarit të kuptimshëm të nxënësve, andaj përmirësimi i praktikave mësimore lypset të jetë prioritet në politikat e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Rekomandohet që në të ardhmen mësimdhënësit të mbështeten me programe të zhvillimit profesional të vazhdueshëm, duke përfshirë praktika të bazuara në dëshmi që fuqizojnë kompetencat e nxënësve në zhvillimin e të kuptuarit gjatë të lexuarit.

Fjalët çelës: cilësi e mësimdhënies, strategji të mësimdhënies, të lexuarit e kuptimshëm, mësimdhënës, qasja metodologjike, rezultate të nxënësve

that many teachers face difficulties in selecting and applying effective reading comprehension strategies, due to limited methodological repertoire stemming from insufficient professional development training.

The results also show that only a small proportion of teachers employ structured strategies that consistently develop students' ability to understand and interpret texts. Low implementation of these strategies directly affects students' foundational reading comprehension habits, which is reflected in their unsatisfactory academic achievements.

The study confirms that teaching strategies are essential for improving teaching quality and fostering students' reading comprehension; therefore, enhancing instructional practices should be a priority within teachers' continuous professional development policies. It is recommended that teachers be supported with ongoing professional development programs, including evidence-based practices that strengthen students' competencies in developing comprehension skills during reading.

Keywords: teaching quality, teaching strategies, reading comprehension, teachers, methodological approach, student outcomes

Rëndësia e komunikimit efektiv në mësimdhënie

The importance of effective communication in teaching

Bashkim Ali Azemi
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: Bashkim.A.Azemi@rks.gov.net

Abstrakt

Komunikimi është një nga nevojat e para të njeriut, prandaj hapat e parë hidhen që në fëmijëri. Në fillim ai është një mjet komunikimi i fëmijës me të rriturit, por me kalimin e kohës, kur fëmija ndërgjegjësohet për ekzistencën e tij, komunikimi bëhet cilësi e brendshme dhe nis të përmbushë funksionin zhvillimor dhe intelektual për individin. Prandaj, qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i rëndësisë së komunikimit efektiv të mësimdhënësit në klasë për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të nxënësve.

Aftësitë komunikuese të mësimdhënësit janë shumë të rëndësishme për përkrahjen e nxënësve, mundësinë e tyre për t'u shprehur, si dhe për kohën e bashkëbisedimit me nxënësit në mënyrë të pavarur e kritike. Aftësitë praktike dhe teorike të mësimdhënësve duhet t'u lejojnë atyre përshtatjen e strategjive të të mësuarit dhe nxënies sipas nevojave të nxënësve. Për të realizuar këtë funksion, mësimdhënësit duhet të kenë gjithnjë parasysh komunikimin efektiv, jo vetëm gjatë shpjegimit dhe bashkëbisedimit me nxënës, por edhe gjatë procesit të pyetjeve dhe vlerësimit të nxënësve.

Abstract

Communication is a fundamental human need, with its earliest forms developing in childhood. Initially, communication serves as a means for a child to interact with adults, but as the child grows aware of their own identity, communication transforms into an internal attribute that supports their developmental and intellectual growth. This study aims to evaluate the significance of effective communication by teachers in the classroom to enhance the quality of teaching and improve student outcomes.

A teacher's communication skills are crucial for supporting students, facilitating their self-expression, and encouraging independent and critical dialogue. For this purpose, teachers must be mindful of maintaining effective communication not only during explanations and conversations but also throughout questioning and assessment processes.

Pyetja kryesore e këtij studimi është: Si e praktikojnë mësimdhënësit komunikimin në procesin e mësimdhënies?

Për realizimin e këtij studimi, do të aplikohen metoda e analizës teorike, metoda e analizës së dokumentacionit, metoda statistikore, metoda e krahasimit, si dhe vëzhgimet në orët mësimore. Popullacioni i këtij studimi përbëhet nga 1260 mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të Kosovës, ndërsa mostra përfaqësuese është 127 mësimdhënës. Ndërsa vëzhgimi do të realizohet me një mostër prej 21 pjesëmarrësish, nga tri nivelet e arsimit parauniversitar.

Rezultatet e pritura të këtij studimi do të ndihmojnë në rekomandimet e praktikave më të mira, si dhe në programet mbështetëse për përmirësimin e komunikimit efektiv në mësimdhënie.

Fjalët çelës: komunikim, komunikim efektiv, metodologji e mësimdhënies, nxënës, reflekti

The main research question of this study is: How do teachers practice communication during the teaching process?

To address this, theoretical analysis, document review, statistical techniques, comparative methods, and classroom observations will be applied. The study population includes 1,260 teachers from primary and lower secondary schools in Kosovo, with a representative sample of 127 teachers. Observations will involve 21 participants across three levels of pre-university education.

The anticipated findings of this study are expected to inform recommendations for best practices and supportive programs to improve effective communication in teaching.

Keywords: communication, effective communication, teaching methodology, students, reflection.

Të mësuarit e gramatikës së gjuhës shqipe në shkollat e mesme të ulëta në Kosovë

Learning Albanian grammar in lower secondary schools in Kosovo

Bekim Morina
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Në fushën e Gjuhët dhe komunikimi, gjuha shqipe dhe letërsia trajtohen së bashku dhe janë përfshirë në një tekst të vetëm shkollor. Ky bashkim sjell përfitime dhe sfida në procesin e mësimit të gramatikës në shkollat e mesme të ulëta në Kosovë. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë mënyrën e të mësuarit të gramatikës dhe të vlerësojë nëse bashkimi i gjuhës dhe letërsisë e lehtëson apo e vështirëson këtë proces për nxënësit.

Hulumtimi është bazuar në qasje cilësore, përfshin analizën teorike dhe të dhëna empirike, të mbledhura përmes intervistave me 10 mësimdhënës dhe 2 autorë tekstesh shkollore, si dhe përmes vëzhgimit të orëve të mësimit në shkollë.

Rezultatet tregojnë se gramatika dhe letërsia trajtohen pothuajse në mënyrë të barabartë në planet dhe programet mësimore, si dhe në tekstet shkollore, megjithëse disa mësimdhënës vërejnë një dominim të lehtë të letërsisë.

Ata konsiderojnë se fondi i orëve është i mjaftueshëm për të përmbushur objektivat e dy fushave. Integrimi i tyre ndihmon nxënësit të

Abstract

In the field of Language and Communication, Albanian language and literature are treated together and included in a single school textbook. This combination brings both benefits and challenges in the process of learning grammar in lower secondary schools in Kosovo. The aim of this study is to examine the way grammar is learned and to evaluate whether the integration of language and literature facilitates or complicates this process for students.

The research is based on a qualitative approach and includes theoretical analysis and empirical data collected through interviews with 10 teachers and 2 textbook authors, as well as through classroom observations in schools.

The results show that grammar and literature are treated almost equally in lesson plans and programs, as well as in textbooks, although some teachers note a slight dominance of literature.

They consider that the number of teaching hours is sufficient to meet the objectives of both fields. Their integration helps students develop linguistic and interpretative skills, and the assessment of

zhvillojnë aftësitë gjuhësore dhe interpretuese dhe vlerësimi i aftësive gramatikore përmes analizës letrare, edhe pse më kompleks, është më i lehtë dhe më i pranueshëm.

Rekomandohet organizimi i trajnimeve profesionale për mësimdhënësit, me fokus në qasjen integruese të gjuhës dhe letërsisë. Gjithashtu, sugjerohet përdorimi i metodave aktive dhe tërheqëse, si lojërat, garat dhe aktivitetet interaktive, të cilat e lidhin gramatikën me përmbajtjet letrare dhe situatat e jetës së përditshme, duke e bërë mësimin më funksional dhe gramatikën më të kuptueshme për nxënësit.

Fjalët çelës: gramatikë, letërsi, integrim, mësimdhënie, shkollë e mesme e ulët

grammatical skills through literary analysis, although more complex, yields more comprehensive and deeper results.

It is recommended to organize professional training for teachers, focusing on the integrative approach to language and literature. Furthermore, the use of active and engaging methods, such as games, competitions, and interactive activities, is suggested, which connect grammar with literary content and real-life situations, making learning more functional and understandable for students.

Keywords: grammar, literature, integration, teaching, lower secondary school.

Ndërtimi i shkathtësive të së ardhmes – përtej teknologjisë

Building future skills – beyond technology

Belgizare Kryeziu
Vlora Bunjaku

Abstrakt

Ndërtimi i shkathtësive të së ardhmes, si rezultat i ndryshimeve të shpejta e të vrullshme, kërkon një qasje më të gjerë se përvetësimi i teknologjisë, sikurse përcaktohet në Kornizën Kurrikulare "*Future skills*" të UNESCO-s. Shkathtësitë e buta (*soft skills*) po bëhen faktor kyç për përgatitjen e njerëzve për një të ardhme të paparashikueshme dhe të ndërlikuar, ku teknologjia ndryshon më shpejt se përshtatja e sistemit arsimor (OECD, 2019). Punimi ka për qëllim të kontribuojë në konceptimin e reformimit të kurrikulës në sistemin arsimor për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, përmes ndërtimit të shkathtësive të së ardhmes.

Hulumtimi, si studim krahasues teorik, bazohet në literaturën për arsimin nga organizatat ndërkombëtare (OECD, UNESCO) dhe autorë të spikatur në politikat arsimore. Qasja e këtij hulumtimi bazohet në analizën teorike dhe metodën krahasimtare. Përmes analizës teorike shqyrtohet literatura bashkëkohore për kompetencat e së ardhmes, përtej teknologjisë, me fokus të veçantë, përveç teknologjisë, në të menduarit kritik, krijimtarinë, inteligjencën emocionale, bashkëpunimin dhe të nxënit e

Abstract

Building future skills, as a response to rapid and accelerating changes, requires a broader approach than merely acquiring technological competence, as outlined in UNESCO's "Future Skills" Curriculum Framework. Soft skills are becoming key factors in preparing individuals for an unpredictable and complex future, where technology evolves faster than educational systems can adapt (OECD, 2019). This paper aims to contribute to curriculum reform in education systems to foster sustainable societal development through the cultivation of future skills.

The research, as a theoretical comparative study, draws on literature from international organizations (OECD, UNESCO) and leading authors in educational policy. The approach combines theoretical analysis and comparative methodology. Through theoretical analysis, contemporary literature on future competencies beyond technology is examined, with particular focus on critical thinking, creativity, emotional intelligence, collaboration, and lifelong learning. Subsequently, a comparative analysis investigates how education

vazhdueshëm. Më pas, përmes analizës krahasimtare shqyrtohen mënyrat e funksionimit të sistemeve arsimore në tre vende, për të zhvilluar këto kompetenca (Finlanda, Singapori, Kosova).

Mund të pritet identifikimi i kompetencave nga politika arsimore për të përshtatur kushtet dhe specifikat e Kosovës, mishëruar në përmbajtjen e kurrikulës, duke i bërë të realizueshme përmes veprimtarive dhe praktikave në shkolla, ndërsa fakulteti i përgatitjes së mësuesve përditëson metodat ndërvepruese për mësimdhënien me synim përmirësimin e të nxënit e studentëve dhe kësisoj shkollat krijojnë një kulturë të favorshme në një mjedis që mbështet të nxënit për të përballuar sfidat e së ardhmes. Teknologjia shërben si mjet lehtësues për të ndërtuar aftësitë njerëzore në përpunimin e informacionit, për ndërtimin dhe krijimin e dijes, e jo si qëllim në vetvete.

Fjalët çelës: mendim kritik, mësim gjatë gjithë jetës, bashkëpunim, inteligjencë emocional

systems in Finland, Singapore, and Kosovo develop these competencies.

The study anticipates identifying competencies in educational policy that can be adapted to Kosovo's specific context and integrated into the curriculum through school activities and practices. Teacher education programs update interactive teaching methods to improve student learning, while schools cultivate a supportive learning culture to prepare students for future challenges. Technology serves as a facilitating tool for developing human capacities in information processing, knowledge construction, and creation, rather than as an end in itself.

Keywords: critical thinking, lifelong learning, collaboration, emotional intelligence

Të mësuarit gjatë gjithë jetës në epokën e transformimit digjital

Lifelong Learning in the era of digital transformation

Demush Bajrami
Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriut
E-mail: d.bajrami@seeu.edu.mk

Arafat Shabani
Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriut
E-mail: a.shabani@seeu.edu.mk

Abstrakt

Në epokën digjitale me zhvillim të shpejtë, të mësuarit gjatë gjithë jetës është shfaqur si një domosdoshmëri e kohës për individët dhe shoqëritë që përpiqen të përshtaten me përparimet e vazhdueshme teknologjike.

Ky punim hulumton marrëdhënien komplekse midis të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ndryshimit digjital, duke vendosur theksin në atë se si transformimi digjital riformëson aftësitë, kompetencat dhe metodat e të mësuarit të kërkuara në të gjitha fazat e jetës.

Studimi heton si mundësitë, ashtu edhe sfidat e paraqitura nga digjitalizimi, duke përfshirë mundësitë për një qasje më të madhe në njohuri, mësim të personalizuar dhe modele arsimore fleksibile, krahas barrierave, siç janë: pabarazia digjitale, boshllëqet e aftësive dhe rezistenca ndaj ndryshimeve.

Përmes një qasjeje shumëdisiplinore, që përfshin analizën e literaturës aktuale, kornizat e politikave

Abstract

In the rapidly evolving digital era, lifelong learning has emerged as a necessity for individuals and societies striving to adapt to continuous technological advancements.

This paper investigates the complex relationship between lifelong learning and digital transformation, emphasizing how digital change reshapes the skills, competencies, and learning methods required across all stages of life.

The study examines both the opportunities and challenges posed by digitalization, including greater access to knowledge, personalized learning, and flexible educational models, alongside barriers such as the digital divide, skill gaps, and resistance to change.

Employing a multidisciplinary approach that integrates literature review, policy frameworks, and

dhe studimet e rasteve, hulumtimi nxjerr në pah nevojën për strategji të reja arsimore të mirëdizajnuara që integrojnë edukimin (shkrim-leximin) digjital, nxisin përshtatshmërinë dhe promovojnë një qasje gjithëpërfshirëse në burimet e të nxënit.

Gjetjet theksojnë se, që të mësuarit gjatë gjithë jetës të jetë vërtetë efektiv në kontekstin e ndryshimit digjital, sistemet arsimore, qeveritë dhe institucionet, duhet të bashkëpunojnë për të krijuar mjedise mësimore dinamike, të barabarta dhe të orientuara drejt së ardhmes.

Fjalët çelës: të mësuarit gjatë gjithë jetës, transformimi digjital, aftësitë, metodat, institucionet

case studies, the research highlights the need for well-designed educational strategies that incorporate digital literacy, foster adaptability, and promote inclusive access to learning resources.

Findings underscore that for lifelong learning to be truly effective in the context of digital transformation, educational systems, governments, and institutions must collaborate to create dynamic, equitable, and future-oriented learning environments.

Keywords: lifelong learning, digital transformation, skills, learning methods, institutions

Efektet e teknologjisë digjitale në të nxënit e gjuhës shqipe në shkollën e mesme të lartë

The effects of digital technology on learning the Albanian Language in upper secondary school

Dhurata Çoçaj
E-mail: dhuratacocaj@gmail.com

Abstrakt

Në epokën e digjitalizimit, përdorimi i teknologjisë në arsim ka marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në përmirësimin e procesit mësimor. Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë efektet e teknologjisë digjitale në të nxënit e gjuhës shqipe në shkollën e mesme të lartë, me fokus të veçantë në përdorimin e platformave, si: Kahoot, Quizlet dhe Google Classroom në mësimdhënien e gramatikës, drejtshkrimit dhe letërsisë.

Përmes një metode kuazi-eksperimentale, janë krahasuar rezultatet dhe përfshirja e nxënësve në dy grupe: një grup që ka ndjekur mësimin përmes mjeteve digjitale dhe një grup që ka ndjekur mësimin në mënyrë tradicionale.

Të dhënat janë mbledhur përmes testimeve, pyetësorëve dhe vëzhgimit të drejtpërdrejtë. Rezultatet paraprake tregojnë se përdorimi i mjeteve digjitale ka ndikuar pozitivisht në motivimin e nxënësve, përvetësimin më të shpejtë të përmbajtjes dhe rritjen e interaktivitetit në mësim. Ky studim synon të kontribuojë në zhvillimin e praktikave bashkëkohore të mësimdhënies në

Abstract

In the digital era, the use of technology in education has taken on an increasingly significant role in enhancing the teaching and learning process. This study aims to examine the effects of digital technology on learning the Albanian language in upper secondary school, with a particular focus on the use of platforms such as *Kahoot, Quizlet,* and *Google Classroom* in the teaching of grammar, orthography, and literature.

Through a quasi-experimental method, the outcomes and engagement of students were compared across two groups: one group that followed lessons through digital tools and another that engaged in traditional instruction. Data were collected through testing, questionnaires, and direct classroom observation.

Preliminary findings indicate that the use of digital tools positively influences student motivation, accelerates content acquisition, and increases interactivity in the learning process. This study seeks to contribute to the advancement of contemporary teaching practices in the Albanian

gjuhën shqipe, duke nxitur integrimin e teknologjisë në mënyrë të qëllimshme dhe të efektshme.

Fjalët çelës: teknologjia digjitale, gjuha shqipe, Kahoot, Quizlet, Google Classroom, mësimdhënia aktive, shkolla e mesme

language by promoting the purposeful and effective integration of technology in education.

Keywords: digital technology, Albanian language, Kahoot, Quizlet, Google Classroom, active learning, upper secondary school

Zbatimi i dizajnit universal të të mësuarit: Qasje proaktive për ndërtimin e mjediseve gjithëpërfshirëse në arsimin fillor në Kosovë

Implementation of universal design for learning: A proactive approach to building inclusive environments in primary education in Kosovo

Dijellza Hasani
ShFMU "Osman Rama"
E-mail: dijellza.hasani@student.uni-pr.edu

Naser Zabeli
Universitet i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit
E-mail: naser.zabeli@uni-pr.edu

Abstrakt

Në përpjekje për të ndërtuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që adreson diversitetin e nxënësve, Dizajni Universal i të të Mësuarit (DUM) ofron një qasje proaktive për krijimin e mjediseve mësimore të qasshme nga të gjithë. Ky hulumtim ka eksploruar njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e mësimdhënësve, si dhe sfidat që mësimdhënësit mund të hasin në zbatimin e DUM-it në arsimin parauniversitar në Kosovë, me fokus të veçantë në arsimin fillor.

Dizajni i hulumtimit është kuantitativ. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor online i strukturuar, i cili ka matur nivelin e njohurive dhe strategjitë praktike të mësimdhënësve për të mundësuar një mësimdhënie më gjithëpërfshirëse. Mostra përfshin 58 mësimdhënës nga shkolla fillore të komunave të ndryshme të Kosovës. Të dhënat u analizuan përmes programit SPSS.

Abstract

In the effort to build an inclusive educational system that addresses student diversity, Universal Design for Learning (UDL) offers a proactive approach for creating learning environments accessible to all. This study explored teachers' knowledge, attitudes, and practices, as well as the challenges they face in implementing UDL in pre-university education in Kosovo, with a special focus on primary education.

The research design was quantitative. Data were collected through a structured online questionnaire measuring teachers' knowledge and practical strategies to enable more inclusive teaching. The sample included 58 primary school teachers from various municipalities in Kosovo. Data were analyzed using SPSS.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se mësimdhënësit e arsimit fillor kanë njohuri mesatare për Dizajnin Universal për të Mësuarit (DUM), të fituara kryesisht përmes trajnimeve. Megjithëse shfaqin qëndrime pozitive ndaj DUM-it, zbatimi praktik në klasë mbetet i pjesshëm për shkak të mungesës së resurseve dhe strukturës së qartë. Sfidat më të mëdha lidhen me mungesën e mjeteve teknologjike, trajnimeve të specializuara dhe materialeve didaktike.

Ky studim rekomandon që MASHTI të zhvillojë trajnime të rregullta dhe të specializuara për mësimdhënësit mbi Dizajnin Universal për të Mësuarit (DUM), të integrojnë këtë qasje në programet e zhvillimit profesional të mësimdhënësit fillestarë në fazën hyrëse në profesion të pajisen shkollat me mjete teknologjike dhe materiale didaktike të përshtatshme, si dhe të hartohen udhëzues praktikë për zbatimin e DUM në klasë.

Fjalët çelës: Dizajni Universal për të Mësuarit, gjithëpërfshirja, praktikat mësimore, sfidat, arsimi fillor

Findings indicate that primary education teachers possess moderate knowledge of UDL, mainly acquired through training. Although teachers demonstrate positive attitudes toward UDL, its practical implementation in the classroom remains partial due to limited resources and unclear structures. The main challenges include lack of technological tools, specialized training, and appropriate instructional materials.

The study recommends that the Ministry of Education, Science, Technology, and Innovation (MASHTI) provide regular and specialized training for teachers on UDL, integrate this approach into professional development programs for novice teachers, equip schools with technological tools and suitable didactic materials, and develop practical guidelines for UDL implementation in the classroom.

Keywords: Universal Design for Learning, inclusion, teaching practices, challenges, primary education

Inteligjenca emocionale e mësimdhënësve dhe efektiviteti i tyre: një analizë e ndikimit të tipareve të personalitetit, gjinisë dhe përvojës profesionale

Teachers' emotional intelligence and effectiveness: An analysis of the impact of personality traits, gender and professional experience

Dorentina Murturi-Cyril

Abstrakt

Ky studim shqyrton ndërlidhjen ndërmjet inteligjencës emocionale (IE) dhe efektivitetit të mësimdhënësve, duke analizuar ndikimin që kanë tiparet e personalitetit, gjinia dhe përvoja në arsim mbi këto dy aspekte. Është përzgjedhur një mostër prej 150 mësimdhënësish nga shkollat fillore dhe të mesme të Rajonit të Prishtinës, përmes kampionimit të rastësishëm të shtresuar, për të siguruar përfaqësim të balancuar të gjinisë, nivelit shkollor dhe viteve të përvojës së punës.

Analizat kuantitative, përfshirë korrelacionin dhe regresionin, treguan ndërlidhje pozitive domethënëse midis IE-së dhe nënkategorive të efektivitetit të mësimdhënësve si menaxhimi i klasës ($r = 0.39$, $p < .001$), strategjitë mësimore ($r = 0.50$, $p < .001$) dhe angazhimi i nxënësve ($r = 0.28$, $p < .001$). Rezultatet e regresionit treguan se vetëdijshmëria dhe hapja ndaj përvojës janë parashikuesit më të fortë të IE-së dhe efektivitetit të mësimdhënësve, ndërsa neurotizmi kishte ndikim negativ. Përvoja në arsim gjithashtu ndikon pozitivisht në të dyja variablat.

Dallimet gjinore u analizuan përmes T-testit, ku u tregua se mësimdhënëset gra shënuan nivel më

Abstract

This study examines the relationship between emotional intelligence (EI) and teacher effectiveness, analyzing the influence of personality traits, gender, and teaching experience on these two aspects. A sample of 150 teachers from primary and secondary schools in the Prishtina Region was selected through stratified random sampling to ensure balanced representation in terms of gender, school level, and years of professional experience.

Quantitative analyses, including correlation and regression, indicated significant positive associations between EI and teacher effectiveness subdomains such as classroom management ($r = 0.39$, $p < .001$), instructional strategies ($r = 0.50$, $p < .001$), and student engagement ($r = 0.28$, $p < .001$). Regression results showed that self-awareness and openness to experience were the strongest predictors of both EI and teacher effectiveness, whereas neuroticism had a negative impact. Teaching experience also positively influenced both variables.

Gender differences were analyzed using T-tests, revealing that female teachers scored higher in EI

lartë në IE (p = 0.022). Mësimdhënëset gra shënuan mesatare më të lartë edhe në efektivitetin e mësimdhënies (p = 0.067), por këto të dhëna nuk ishin signifikante. Të dhënat cilësore nga intervistat me 12 mësimdhënës përforcuan gjetjet statistikore, duke vënë në pah pesë tema kryesore si: roli qendror i IE-së në krijimin e një mjedisi pozitiv shkollor, mungesa e trajnimit formal në IE, ndikimi i IE në mirëqenien dhe menaxhimin e klasës, vështirësitë në kuptimin e emocioneve të nxënësve, dhe rëndësia e mbështetjes nga kolegët.

Në përgjithësi, studimi thekson rëndësinë e integrimit të trajnimeve për inteligjencën emocionale në programet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve për të rritur efektivitetin dhe mirëqenien e tyre.

Fjalët çelës: Inteligjenca emocionale, efektiviteti i mësimdhënësit, tiparet e personalitetit, dallimet gjinore

(p = 0.022). Female teachers also had higher average scores in teaching effectiveness (p = 0.067), although these differences were not statistically significant. Qualitative data from interviews with 12 teachers reinforced the statistical findings, highlighting five main themes: the central role of EI in creating a positive school environment, lack of formal EI training, the impact of EI on teacher well-being and classroom management, challenges in understanding students' emotions, and the importance of peer support.

Overall, the study emphasizes the importance of integrating emotional intelligence training into teachers' professional development programs to enhance both effectiveness and well-being.

Keywords: emotional intelligence, teacher effectiveness, personality traits, gender differences

Masivizimi dhe cilësia e mësimdhënies në Universitetet e Ballkanit Perëndimor

Massification and teaching quality in Western Balkan Universities

Dugagjin Sokoli[1], Albulenë Kastrati[2], Mirvan Xhemaili[3] & Elona Kodhel[4] Osman Buleshkaj[5]

[1] Profesor Asistent, Fakulteti i Stomatologjisë, Kolegji UBT, Kosovë
[2] Profesor Asistent, Departamenti i Ekonomisë, Bridgewater State University, SHBA
[3] Profesor i Asociuar, Fakulteti i Gjuhës Angleze, Kolegji AAB, Kosovë.
[4] Ligjëruese, Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti i Korçës „Fan S. Noli", Shqipëri
[5] Bashkëpunëtor Shkencor, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Kosovë

Abstrakt

Kontributi synon të shqyrtojë mënyrën se si masivizimi i arsimit të lartë ndikon në cilësinë e mësimdhënies, duke e vendosur këtë diskutim në kuadrin e qeverisjes gjithëpërfshirëse të institucioneve arsimore. Duke përdorur të dhëna anketuese nga 764 studentë dhe 197 pedagogë në tetë universitete publike e private, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut (2021–2022), u implementua modeli i regresionit logjistik shumë-nominal për të identifikuar faktorët parashikues të cilësisë së perceptuar të mësimdhënies.

Rezultatet tregojnë se mbiregjistrimi, mungesa e kuotave pranuese, praktikat mësimore të vjetruara dhe infrastruktura e pamjaftueshme, lidhen ndjeshëm me rënie të cilësisë së mësimdhënies. Për më tepër, boshllëqet etike, korrupsioni dhe ngacmimet seksuale, minojnë besimin institucional. Interpretimi i gjetjeve sugjeron se, në mungesë të mekanizmave të fortë monitorimi dhe

Abstract

This study examines how the massification of higher education affects teaching quality, situating the discussion within the framework of comprehensive governance of educational institutions. Using survey data from 764 students and 197 faculty members across eight public and private universities in Albania, Kosovo, and North Macedonia (2021–2022), a multinomial logistic regression model was employed to identify predictors of perceived teaching quality.

Results indicate that over-enrollment, lack of admission quotas, outdated teaching practices, and insufficient infrastructure are significantly associated with declines in teaching quality. Furthermore, ethical gaps, corruption, and sexual harassment undermine institutional trust. The interpretation of findings suggests that, in the absence of strong monitoring mechanisms and professional development for staff, massification

të zhvillimit profesional të stafit, masivizimi shndërrohet në pengesë për mësimin gjatë gjithë jetës, përputhjen me nevojat e tregut të punës dhe programet e arsimit parauniversitar.

Rekomandohet: (1) vendosja e kuotave të bazuara në analiza të tregut, (2) forcimi i sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë, dhe (3) investimi i synuar në zhvillimin pedagogjik të stafit. Këto masa priten të përmirësojnë udhëheqjen gjithëpërfshirëse, transparencën dhe ciklin e vazhdueshëm të vlerësimit që fuqizon institucionet e arsimit të lartë, si nyje thelbësore të ekosistemit të arsimit gjatë gjithë jetës dhe ndërlidhjes me arsimin parauniversitar.

Fjalët çelës: masivizimi, arsimi i lartë, cilësia e mësimdhënies, menaxhimi cilësor, arsimi parauniversitar

becomes a barrier to lifelong learning, alignment with labor market needs, and pre-university education programs.

Recommendations include: (1) implementing quotas based on market analyses, (2) strengthening internal quality assurance systems, and (3) targeted investment in pedagogical development of staff. These measures are expected to enhance comprehensive governance, transparency, and continuous evaluation cycles, empowering higher education institutions as central nodes in the lifelong learning ecosystem and their interconnection with pre-university education.

Keywords: massification, higher education, teaching quality, quality management, pre-university education

Aftësitë e të lexuarit në Arsimin Parauniversitar dhe objektivat e PISA-s: Rasti i trajnimit të mësimdhënësve në UT (PKZHPM 2024-25)

Reading skills in pre-university education and the objectives of PISA: The case of teacher training at the University of Tirana (PKZHPM 2024–25)

Erenestina Gjergji (Halili)
Prof.Asoc.Dr. Erenestina Gjergji (Halili)
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës
Email: erenestina.halili@fhf.edu.al

Abstrakt

Në kontekstin zhvillimor të arsimit dhe përmirësimit të cilësisë, raporti ndërveprues mësues-nxënës konsiderohet thelb i të nxënit aktiv, që synon komunikimin efektiv, inovacionin, diversitetin dhe gjithëpërfshirjen. Përmirësimi i vazhdueshëm i tyre identifikohet si fuqi transformuese, por edhe sfidë e rëndësishme për të gjithë komponentët bashkëpjesëmarrës në arsim e edukim.

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve (PKZHPM) 2024-2025 ofroi në Shqipëri 3(tre) module trajnimi profesional për mësuesit e niveleve parauniversitare. Në veçanti mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë ridimensionuan në bashkëpunim me Universitetet në vend, strategji pedagogjike, metoda e teknika në funksion të mësimdhënies gjithëpërfshirëse dhe aftësive të shekullit XXI. Kjo qasje e re rikualifikoi aktin e leximit, si një kompetencë kyçe jetësore, e cila i shërben ndër të tjera edhe mësimit gjatë gjithë jetës.

Abstract

In the developmental context of education and quality improvement, the teacher–student interactive relationship is considered the essence of active learning, aiming at effective communication, innovation, diversity, and inclusiveness. Their continuous enhancement is identified both as a transformative force and as a significant challenge for all stakeholders in education.

The National Program for Teacher Professional Development (PKZHPM) 2024–2025 in Albania offered three professional training modules for pre-university teachers. In particular, Albanian language and literature teachers, in collaboration with universities, redefined pedagogical strategies, methods, and techniques in support of inclusive teaching and 21st-century skills. This new approach repositioned reading as a key life competence, essential also for lifelong learning.

Punimi argumenton se zhvillimi profesional i mësuesve kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë, performancës, kënaqësisë estetike e holistike, aftësitë e nxënësve në lexim të thelluar, duke kontribuar në përputhshmërinë me indikatorët ndërkombëtarë të matjes së cilësisë si PISA. Në punim trajtohen metodat, teknikat e mjetet e përdorura gjatë trajnimit në Universitetin e Tiranës, si një bashkëpunim dinamik, i nevojshëm dhe përftues standardesh.

Fjalët çelës: Të nxënit aktiv, aftësi të shek.XXI, arsimi gjithëpërfshirës, përdorimi i teknikave ndërvepruese.

The paper argues that professional development of teachers directly contributes to raising the quality of education, teaching performance, aesthetic and holistic satisfaction, and students' deep reading skills, thereby aligning with international quality indicators such as PISA. The study discusses the methods, techniques, and tools used during training at the University of Tirana, highlighting the importance of dynamic collaboration as a necessary and standards-driven process.

Keywords: active learning, 21st-century skills, inclusive education, interactive techniques

Zbatimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë: Studim rasti

Implementation of school-based teacher professional development: Case study

Gentiana Lajqi

Abstrakt

Kur flasim për cilësinë, është e pamundur të japim një përkufizim universal, sepse ajo është dinamike, ndryshon sipas kontekstit, si dhe varet nga shumë faktorë. Ngjashëm ndodh edhe me cilësinë në sistemin arsimor. Përderisa zhvillimi profesional i dedikohet përmirësimit të punës praktike të mësimdhënësve dhe ngritjes së cilësisë, i tillë duhet të jetë edhe organizimi dhe realizimi i tij, gjithmonë duke marrë për bazë nevojat individuale të mësimdhënësve, dhe të jetë në shërbim të tyre. Ky studim ka të bëjë me zbatimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë.

Qëllimi i hulumtimit është të kuptojë dhe të eksplorojë mënyrat efektive të zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Kjo përfshin analizën e strategjive, politikave dhe praktikave që shkollat mund të përdorin për të përmirësuar aftësitë profesionale të stafit akademik. Në kuadër të këtij studimi, është realizuar një studim rasti në shkollën publike "Qamil Batalli", me qëllim identifikimin e praktikave më të mira të zhvillimit profesional në nivel shkolle. Popullacioni i përzgjedhur për hulumtim përfshin 15 respondentë: 12 mësimdhënës, drejtorin, psikologen dhe

Abstract

When discussing quality, it is impossible to provide a universal definition, as it is dynamic, context-dependent, and influenced by multiple factors. The same applies to quality in the educational system. Since professional development aims to improve teachers' practical work and enhance educational quality, its organization and implementation should likewise be tailored, taking into account the individual needs of teachers and serving them effectively. This study focuses on the implementation of school-based teacher professional development.

The aim of the research is to understand and explore effective methods of school-based professional development. This includes analyzing strategies, policies, and practices that schools can use to enhance the professional skills of their teaching staff. The study was conducted as a case study at the public school "Qamil Batalli," aiming to identify best practices in school-based professional development. The research population included 15 participants: 12 teachers, the principal, the school psychologist, and the quality coordinator. Methods employed included

koordinatorin e cilësisë. Metodat e përdorura në këtë hulumtim përfshijnë intervistat gjysmë të strukturuara, me rreth 10 pyetje, dhe analizën e dokumenteve, duke mundësuar një qasje të thelluar në procesin e zhvillimit profesional në këtë shkollë.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një faktor kyç për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe për ndërtimin e një skenari të qëndrueshëm zhvillimi për shkollat. Modelet e suksesshme të zhvillimit profesional, kur zbatohen në mënyrë të përshtatur për kontekstin specifik të shkollave, mund të ndihmojnë në ngritjen e standardeve arsimore dhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Bazuar në këtë studim, shkolla "Qamil Batalli" identifikohet si një model suksesi në zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Kjo e bën atë një shembull të vlefshëm për shkollat e tjera, të cilat mund të përshtatin këtë qasje në varësi të nevojave dhe sfidave të tyre specifike. Në fund, ky studim sjell rekomandime konkrete për DKA, duke sugjeruar strategji të zbatueshme për shkollat që synojnë të integrojnë zhvillimin profesional si një pjesë thelbësore të përmirësimit të tyre.

Fjalët çelës: mësimdhënës, zhvillimi i vazhdueshëm profesional me bazë në shkollë, zbatim, eksplorim

semi-structured interviews with around 10 questions and document analysis, providing an in-depth view of the professional development process in this school.

Findings indicate that teacher professional development is a key factor in improving educational quality and establishing a sustainable development framework for schools. Successful models of professional development, when adapted to the specific context of schools, can contribute to raising educational standards and enhancing teaching quality. Based on this study, "Qamil Batalli" school is identified as a successful model in implementing school-based professional development, serving as a valuable example for other schools that can adapt this approach according to their specific needs and challenges. Finally, the study offers concrete recommendations for the Municipal Education Directorate, suggesting actionable strategies for schools seeking to integrate professional development as a core component of their improvement efforts.

Keywords: teachers, school-based continuous professional development, implementation, exploration

Zëri i prindërve në arsimin gjithëpërfshirës

The voice of parents in inclusive education

Gentiana Zabeli & Anduena Kelmendi
E-mail: gzabeli20@gmail.com
E-mail: kelmendianduena@gmail.com

Abstrakt

Ky studim shqyrton rolin aktiv të prindërve në procesin e arsimit gjithëpërfshirës, me fokus të veçantë në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme. Në një sistem edukativ që synon gjithëpërfshirjen, bashkëpunimi ndërmjet prindërve, mësimdhënësve dhe institucioneve është thelbësor për të garantuar një mjedis që mbështet diversitetin dhe përfshirjen e barabartë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të eksplorojë përvojat dhe sfidat që hasin prindërit në përpjekjet e tyre për integrimin e fëmijëve në arsimin formal. Është përdorur mostra prej dhjetë (10) respodentëve përmes qasjes cilësore, duke realizuar intervista të thelluara me prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta, me qëllim identifikimin e pengesave strukturore dhe mbështetjes së munguar.

Gjetjet preliminare theksojnë rëndësinë e politikave të qarta arsimore, komunikimit efektiv ndërmjet shkollës dhe familjes, si dhe nevojën për ndërtimin e mekanizmave mbështetës për të fuqizuar këtë partneritet.

Ky hulumtim kontribuon në diskursin shkencor mbi arsimin gjithëpërfshirës, duke theksuar zërin e

Abstract

This study examines the active role of parents in the process of inclusive education, with a particular focus on the inclusion of children with special needs in mainstream schools. In an educational system aiming for inclusivity, collaboration among parents, teachers, and institutions is essential to ensure an environment that supports diversity and equal participation.

The research aims to explore parents' experiences and challenges in their efforts to integrate children into formal education. A sample of ten (10) respondents was employed using a qualitative approach, conducting in-depth interviews with parents of children with special needs to identify structural barriers and gaps in support.

Preliminary findings highlight the importance of clear educational policies, effective communication between schools and families, and the need to develop supportive mechanisms to strengthen this partnership.

This study contributes to the scholarly discourse on inclusive education by emphasizing parents'

prindërve si faktorë kryesorë në krijimin e një sistemi arsimor më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të ndryshme të nxënësve.

Fjalët çelës: prindër, fëmijë me nevoja të veçanta, arsim gjithëpërfshirës, bashkëpunim shkollë-familje, politika arsimore

voices as key factors in creating a fairer, more inclusive educational system that is responsive to the diverse needs of students.

Keywords: parents, children with special needs, inclusive education, school-family collaboration, educational policies

Qasjet inovative të mësimit në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve

Innovative teaching approaches in function of student competence development

Hajrije Devetaku Gojani
Universiteti për Biznes dhe Teknologji UBT
E-mail: hajrije.devetaku@ubt-uni.net

Abstrakt

Praktikat inovative të mësimit të cilat ndërlidhen ngusht me zhvillimin e kompetencave të nxënësve, përkatësisht me parimet konstruktiviste, si: të nxënit paraprak, të nxënit përmes bashkëpunimit dhe ndërveprimit, pjesëmarrja aktive, puna e pavarur, relevanca e mësimit si dhe mjedisi i të nxënit në shkolla, përbëjnë fokusin kryesor të këtij hulumtimi. Prandaj, synimi i studimit është verifikimi dhe prania e këtyre praktikave inovative në arsimin formal në Kosovë si dhe të konstatimi se në çfarë mase këto praktika kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, në përputhje me parimet konstruktiviste të cilat dalin si kërkesë e kurrikulës së Kosovës.

Rezultatet e testeve ndërkombëtare, si: PISA organizuar nga OECD, rezultatet e testeve të arritshmërisë të organizuara nga MASHTI, rekomandimet e raportit të progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian,si dhe hulumtime e raporte të tjera në nivel vendi, janë tregues për nevojën e reagimit të shpejtë dhe korigjimit të politikave arsimore, sidomos politikave që ndërlidhen me zhvillimin profesional të mësimdhënësve,

Abstract

Innovative teaching practices closely related to the development of student competences—particularly those grounded in constructivist principles such as prior learning, learning through cooperation and interaction, active participation, independent work, learning relevance, and the school learning environment—constitute the main focus of this study. The aim is to verify the presence of such innovative practices in formal education in Kosovo and to determine the extent to which they contribute to student competence development, in line with the constructivist principles required by the Kosovo Curriculum.

Findings from international assessments such as PISA (OECD), national achievement tests organized by the Ministry of Education, Science, Technology, and Innovation (MESTI), recommendations from the European Commission's Progress Report for Kosovo, along with other national studies and reports, indicate the urgent need to react and adjust educational policies. This is particularly relevant for policies related to teacher professional development,

bashkëpunimin e AP_ve në nivel të shkollës dhe shfrytëzimin e të dhënave me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm.

Të dhënat janë mbledhur përmes vëzhgimit me anë të instrumentit përkatës, protokolit të vëzhgimit, gjatë orëve mësimore. Janë përfshirë gjithsej 30 mësimdhënës të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar, në dymbëdhjetë shkolla të Kosovës.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se të kuptuarit e kurrikulës nga mësimdhënësit është kryesisht sipërfaqësor, gjë që rezulton në një zbatim të pjesshëm dhe në mospërputhje me qëllimet thelbësore të saj. Përpjekjet për zhvillimin e kompetencave shpesh janë të pasuksesshme, mbeten në nivel formal dhe nuk arrijnë të përfshihen në mënyrë të qëndrueshme në procesin mësimor, veçanërisht në shkollën e mesme të ulët dhe në shkollën e mesme të lartë.

Gjithashtu, teksti shkollor vazhdon të jetë burimi kryesor dhe dominant i informacionit, duke kufizuar përdorimin e metodave dhe burimeve alternative të të nxënit. Këto gjetje nënvizojnë nevojën për trajnim më të thelluar profesional të mësimdhënësve dhe qasje më funksionale ndaj zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca, përkatësisht fuqizimin e parimeve konstruktiviste përmes të cilave synohet pjesëmarrja aktive e nxënësve në të gjitha proceset arsimore.

Rekomandimet mund të shërbejnë si bazë për procese të tjera hulumtuese, për rishikim të

school-level professional learning communities, and the effective use of data to foster continuous improvement.

Data were collected through classroom observations using a structured observation protocol. The sample included 30 teachers from all three levels of pre-university education, across twelve schools in Kosovo.

The results reveal that teachers' understanding of the curriculum is largely superficial, resulting in partial implementation and misalignment with its core objectives. Efforts toward competence development often remain unsuccessful, formalistic, and unsustainably integrated into the teaching process, particularly in lower and upper secondary schools. Moreover, textbooks continue to serve as the dominant source of information, limiting the use of alternative methods and resources for learning.

These findings underscore the need for deeper professional training of teachers and more functional approaches to the implementation of the competence-based curriculum, specifically by reinforcing constructivist principles that aim for active student participation in all educational processes.

The recommendations of this study may serve as a basis for further research, for revising pre-service and in-service teacher professional development policies, strengthening school-based professional

politikave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve para shërbimit dhe në shërbim, duke fuqizuar edhe praktikat e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, si dhe për rishikimin e gjendjes së infrastrukturës shkollore.

Fjalët çelës: kurrikula e bazuar në kompetenca, parimet konstruktiviste, metodologji e mësimit, zhvillim i kompetencave, zhvillim profesional i mësimdhënësve, shkolla fillore, e mesme e ulët dhe e mesme e lartë

development practices, and re-evaluating school infrastructure conditions.

Keywords: competence-based curriculum, constructivist principles, teaching methodology, competence development, teacher professional development, primary school, lower secondary, upper secondary

Analiza e hulumtimeve nga IPK per arsimin e të rriturve: Jetësimi i rekomandimeve në politikat dhe praktikat arsimore

Analysis of research conducted by the KPI on adult education: Implementation of recommendations in educational policies and practices

Haxhere Zylfiu
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Arsimi i të rriturve në Kosovë është tematikë e trajtuar në vazhdimësi në kuadër të veprimtarisë hulumtuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës. Janë shtatë raporte të hulumtimeve të publikuara, qoftë si botime të veçanta, apo pjesë e vjetarit 'Kërkime pedagogjike'. Mbi bazën e gjetjeve janë dhënë rekomandime specifike, referuar rolit dhe përgjegjësive të bartësve.

Qëllimi i hulumtimit ishte të evidentojë nëse rekomandimet e dala nga hulumtimet e realizuara për ARr-në janë marrë për bazë për avancimin e politikave dhe praktikave të këtij komponenti. Pyetja e hulumtimit 'Cilat janë praktikat e jetësimit të rekomandimeve të dala nga hulumtimet e IPK-së për ARr-në për avancimin e politikave dhe praktikave për këtë komponent?' ndërlidhet me qëllimin dhe nxjerr në pah gjendjen dhe përceptimet e aktorëve bartës për çështjet e përfshira.

Për realizimin e studimit u zbatua qasja kërkimore cilësore, bazuar në modelin përshkrues, me analizë të dokumenteve të politikave, dëshmive për praktikat, si dhe legjislacionit për ARr-në.

Abstract

Adult education (AE) in Kosovo is a topic that is continuously addressed within the research activities of the Kosovo Pedagogical Institute (KPI). There are seven research reports published, either as separate publications or as part of the annual journal 'Kërkime Pedagogjike'. Based on the findings, specific recommendations have been provided, referring to the role and responsibilities of stakeholders.

The aim of the research was to identify whether the recommendations arising from the studies conducted by the KPI on AE have been considered for the advancement of AE policies and practices in Kosovo. The main research question – "What are the practices of implementing the recommendations arising from the KPI research on AE for advancing the policies and practices for this component?" – is related the purpose and highlights the situation and perceptions of key stakeholders on the issues involved.

A qualitative research approach was used for this study, based on the descriptive model, with analysis of policy documents, evidence of

Përmbajtja u plotësua me analizën e narracionit - intervistave individuale gjysmë të strukturuara, të realizuara me nëntë përfaqësues të institucioneve përgjegjëse. Për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave është përdorur Listë-kontrolli, Protokolli i analizës së përmbajtjeve dhe Protokoli i intervistës.

Mbledhja analiza dhe dokumentimi i të dhënave u bazua në modelin e prezantuar nga Mitchell Nicmanis (2024).

Rezultatet treguan se ka qëndrime pozitive për hulumtimet e IPK-së. Gjetjet dhe rekomandimet për ARr-në cilësohen si të mirëseardhura, mjaft të rëndësishme, të vlefshme, të bazuara në fakte dhe të qëlluara për hapa konkret për avancim. Megjithëatë, qëndrimet nuk përputhen me praktikat ekzistuese të jetësimit të rekomandimeve, meqenëse pas vitit 2016 dhe aktualisht, jetësimi i rekomandimeve rezulton të jetë jo i dukshëm dhe i padëshmuar në dokumentet e politikave dhe praktikave për ARr-në.

Rekomandohet qasje partneriteti hulumtues-praktikues në hulumtime, për të përafruar kërkesat dhe jetësimin e rekomandimeve.

Fjalët çelës: Arsimi i te rriturve, hulumtimet e IPK-së, politikat arsimore, praktikat, rekomandimet

practices, and legislation on AE. The content was supplemented with narrative analysis –semi-structured individual interviews conducted with nine representatives of the responsible institutions. A Checklist, Content Analysis Protocol and Interview Protocol were use for data collection, analysis and interpretation.

The collection, analysis and documentation of data was on the model presented by Mitchell Nicmanis (2024).

The results showed that there are positive attitudes toward the KPI research. The findings and recommendations on AE are considered welcome, highly important, valuable, fact-based, and targeted for taking concrete steps for advancement. However, these attitudes do not align with the actual implementation of the recommendations, as since 2016 their implementation has remained invisible and undocumented in the AE's policy and practice.

A research-practitioner partnership approach in research is recommended, to align the requirements and implementation of the recommendations.

Keywords: adult education, KPI research, educational policies, practices, recommendations.

Përdorimi i teknologjisë në mësimin e letërsisë

The use of technology in literature teaching

Jetmire Isufi Shabedini
SHTMK 'Nace Bugjoni'-Kumanovë
E-mail: Isufijetmire@gmail.com

Buniamin Memedi
Universiteti i Tetovës

Majlinda Kurtishi
SHTMK 'Nace Bugjoni'-Kumanovë

Abstrakt

Në epokën e zhvillimit të shpejtë teknologjik, arsimi përballet me sfida dhe mundësi të reja për të përmirësuar metodat tradicionale të mësimdhënies, veçanërisht në lëndët teorike si letërsia.

Ky hulumtim synon të shqyrtojë ndikimin e përdorimit të teknologjisë në mësimin e letërsisë nga perspektiva e nxënësve në shkollat e mesme të Komunës së Kumanovës. Përmes një ankete të zhvilluar online, janë mbledhur të dhëna mbi përvojat dhe perceptimet e tyre lidhur me mjetet digjitale të përdorura gjatë orëve të letërsisë.

Rezultatet treguan se shumica e nxënësve përjetojnë rritje motivimi dhe përfshirje më aktive kur në mësim përfshihen materiale audio-vizuale, detyra interaktive dhe bashkëpunimi virtual. Teknologjia ndihmon në kuptimin më të thellë të tekstit letrar dhe në zhvillimin e të menduarit kritik. Sfidat më të shpeshta lidhen me mungesën e

Abstract

In the era of rapid technological development, education faces new challenges and opportunities to improve traditional teaching methods, particularly in theoretical subjects such as literature.

This study aims to examine the impact of technology use in literature teaching from the perspective of high school students in the municipality of Kumanovë. Through an online survey, data were collected on their experiences and perceptions regarding digital tools used during literature classes.

The findings revealed that most students experience increased motivation and more active engagement when lessons incorporate audio-visual materials, interactive tasks, and virtual collaboration. Technology facilitates a deeper understanding of literary texts and fosters the development of critical thinking. The most common

pajisjeve dhe vështirësinë në përdorimin e disa platformave në gjuhën shqipe.

Rekomandohet rritja e përdorimit të teknologjisë në orët e letërsisë, zhvillimi i përmbajtjeve të përshtatshme në shqip dhe mbështetje për nxënësit në aspektin teknik. Kjo i ndihmon ata jo vetëm të mësojnë më lehtë, por edhe të përdorin teknologjinë në mënyrë të dobishme, larg përdorimit të teknologjisë gjatë kohës së lire si zbavitje.

Fjalë çelës: teknologji, letërsi, mësim digjital, arsimi i mesëm, nxënës.

challenges are related to the lack of devices and difficulties in using certain platforms in the Albanian language.

The study recommends increasing the integration of technology in literature classes, developing appropriate content in Albanian, and providing technical support for students. This not only enhances learning outcomes but also encourages students to use technology in a purposeful way, beyond its recreational use in free time.

Keywords: technology, literature, digital learning, secondary education, students

Edukimi mjedisor në fëmijërinë e hershme në Kosovë: Analizë e gjendjes aktuale dhe rekomandime për përmirësim

Environmental education in early childhood in Kosovo: Analysis of the current situation and recommendations for improvement

Leonora Carkaj
E-mail: Leonora.carkaj@umib.net

Abstrakt

Ky studim ofron një analizë të thelluar të edukimit mjedisor në fëmijërinë e hershme në Kosovë, duke shqyrtuar praktikat dhe politikat aktuale, si dhe sfidat dhe mundësitë për integrimin e tij në arsimin parashkollor. Analiza mbështetet në një rishikim të literaturës relevante dhe dokumenteve politike dhe identifikon barrierat kryesore që pengojnë zbatimin efektiv të edukimit mjedisor. Gjetjet sugjerojnë se, ndonëse ka përpjekje për të integruar edukimin mjedisor, ende ekzistojnë pengesa të konsiderueshme, si mungesa e trajnimeve të përshtatshme për edukatorët dhe mungesa e burimeve didaktike. Në përfundim, studimi ofron rekomandime për përmirësimin e integrimit të edukimit mjedisor, duke theksuar nevojën për zhvillimin e politikave mbështetëse dhe sigurimin e burimeve mësimore cilësore.

Fjalët çelës: edukim mjedisor, fëmijëria e hershme, trajnime, analiza

Abstract

This study provides an in-depth analysis of environmental education in early childhood in Kosovo, examining current practices and policies, as well as the challenges and opportunities for its integration into preschool education. The analysis is based on a review of relevant literature and policy documents, identifying the main barriers hindering effective implementation. Findings indicate that, although there are efforts to integrate environmental education, significant obstacles remain, including inadequate training for educators and limited teaching resources. The study concludes with recommendations to enhance the integration of environmental education, emphasizing the need for supportive policies and the provision of high-quality educational materials.

Keywords: environmental education, early childhood, educator training, policy analysis

Qendrat me bazë në komunitet për edukimin e hershëm në Kosovë

Community-based centers for Early Childhood Education in Kosovo

Linda Hoxha, Majlinda Zhitija-Gjelaj, Lulavere Behluli
(Studim nga Save the Children)

Abstrakt

Kujdesi dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme (KZhFH) është një faktor kyç për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve dhe për përgatitjen e tyre për jetën dhe shkollimin. Në Kosovë, qasja në shërbimet cilësore të KZhFH në zonat rurale mbetet e kufizuar, duke ndikuar në pabarazi në mundësitë e hershme për fëmijët. Për të adresuar këtë sfidë, janë ndërmarrë iniciativa inovative që synojnë të afrojnë këto shërbime me komunitetet më të margjinalizuara.

Ky punim paraqet gjetjet kryesore nga zbatimi i modelit të Qendrave me Bazë në Komunitet në Kosovë, si pjesë e projekteve të Save the Children në partneritet me degët e saj në Itali dhe Zvicër. Që nga viti 2015, janë krijuar 32 qendra në zona rurale për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e Kujdesit dhe Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme (KZhFH) për fëmijët e moshës 3–6 vjeç.

Vlerësimi i modelit u zhvillua përmes një metodologjie mikse, duke analizuar ndikimin në pesë fusha kryesore: zhvillimi i fëmijëve, përshtatshmëria kontekstuale, përfitimet për edukatorët, ndryshimet në praktikat prindërore dhe qëndrueshmëria institucionale. Rezultatet tregojnë përmirësime të ndjeshme në zhvillimin

Abstract

Early Childhood Care and Development (ECCD) is a key factor for the holistic development of children and for preparing them for life and schooling. In Kosovo, access to quality ECCD services in rural areas remains limited, contributing to inequities in early opportunities for children. To address this challenge, innovative initiatives have been implemented to bring these services closer to marginalized communities.

This paper presents the main findings from the implementation of the Community-Based Centers model in Kosovo, as part of projects by Save the Children in partnership with its branches in Italy and Switzerland. Since 2015, 32 centers have been established in rural areas to improve access and quality of ECCD services for children aged 3–6 years.

The model was evaluated through a mixed-methods approach, analyzing its impact across five key areas: child development, contextual adaptability, benefits for educators, changes in parenting practices, and institutional sustainability. Results indicate significant improvements in children's holistic development, strengthening of

gjithëpërfshirës të fëmijëve, forcim të kapaciteteve të prindërve dhe edukatorëve, si dhe angazhim të qëndrueshëm të komunitetit.

Modeli ka dëshmuar efektivitet dhe qëndrueshmëri, duke adresuar boshllëqet ekzistuese në ofrimin e shërbimeve në zonat rurale dhe duke kontribuar në përgatitjen e fëmijëve për arsimin formal. Ai gjithashtu ka nxitur bashkëpunim ndërsektorial dhe avancim të reformave legjislative në fushën e KZhFH. Gjetjet ofrojnë rekomandime të rëndësishme për politikëbërje të bazuar në prova dhe institucionalizimin e modelit në nivel nacional, si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse për arsimin gjatë gjithë jetës.

Fjalë çelës: edukimi i hershëm, qendrat me bazë në komunitet, zhvillimi i fëmijës, zonat rurale, politika arsimore

parental and educator capacities, and sustained community engagement.

The model has demonstrated effectiveness and sustainability, addressing existing gaps in service provision in rural areas and contributing to the preparation of children for formal education. It has also fostered intersectoral collaboration and advanced legislative reforms in the ECCD sector. The findings provide important recommendations for evidence-based policymaking and institutionalization of the model at the national level, as part of a comprehensive lifelong learning approach.

Keywords: early childhood education, community-based centers, child development, rural areas, educational policy

Aplikimi i qasjes ndërlëndore në arsimin fillor

Applying the cross-curricular aproach in primary education

Lirije Bytyqi Beqiri
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail:lirije.bytyqi@rks-gov.net

Abstrakt

Qasja ndërlëndore është një kërkesë e kurrikulës së re, e cila synon të integrojë njohuritë nga fusha të ndryshme për të nxitur mësim gjithpërfshirës dhe të kuptueshëm për nxënësit.

Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë zbatimin e qasjes ndërlëndore në arsimin fillor në Kosovë, duke analizuar perceptimet dhe përvojat e mësimdhënësve, mundësitë dhe sfidat, me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit të kësaj qasjeje.

Për të arritur qëllimin e përcaktuar për këtë studim, përdorëm metodologji të kombinuar, duke kombinuar qasjen sasiore dhe cilësore. Të dhënat i mblodhëm përmes pyetësorëve me mësimdhënësit e arsimit fillor, intervistave me kryesues të aktiveve profesionale (departamenteve të shkollave) në arsimin fillor, si dhe përmes analizës së planifikimeve mësimore (planeve vjetore, dymujore, javore dhe përgatitjeve mësimore), të hartuara nga mësimdhënësit e arsimit fillor.

Popullatën e hulumtimit e përbëjnë mësimdhënësit e arsimit fillor në shkollat publike në Kosovë,

Abstract

The interdisciplinary approach is a requirement of the new curriculum, which aims to integrate knowledge from different fields to promote comprehensive and understandable learning for students.

This study aims to examine the implementation of the cross-curricular approach in primary education in Kosovo, by analyzing teachers` perceptions and experiences, the opportunities and challenges they face when implementing this approach.

To achieve the goal set for this study, we used a combined methodology, combining quantitative and qualitative approaches. We collected data through questionnaires with primary education teachers, interviews with heads of professional assets (school departments) in primary education, and through the analysis of lesson plans (annual, bimonthly, weekly plans, and lesson plans) developed by primary education teachers.

The research population consists of primary education teachers in public schools in Kosovo, while the sample was selected based on several

ndërsa mostrën e përzgjodhëm duke u bazuar në disa kritere, të cilat sigurojnë përfaqësim të balancuar të mësimdhënësve në shkolla të ndryshme.

Rezultatet identifikuan praktika të suksesshme të zbatimit të kësaj qasjeje dhe faktorët që ndikojnë në efektivitetin e saj. Gjithashtu, u identifikuan mundësitë për përmirësimin e zbatimit të qasjes ndërlëndore, duke ofruar rekomandime për përmirësime, si në aspektin e mbështetjes ashtu edhe në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Ky studim synon të kontribuojë edhe në përmirësimin e politikave arsimore, duke ofruar udhëzime e rekomandime për mësimdhënësit, por edhe rekomandime për përforcimin e mbështetjes institucionale, sigurimin e kushteve të përshtatshme për punë, sigurimin e mjeteve e materialeve didaktike të mjaftueshme dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillim profesional të mësimdhënësve.

Fjalët çelës: qasje, integrim, aplikim, lëndë mësimore, arsim fillor

criteria that ensure balanced representation of teachers in different schools.

The result identified successful practices in implementing this approach and factors that influence its effectiveness. Opportunities for improving the implementation of the cross-curricular approach were also identified, providing recommendations for improvements in both teacher support and professional development. This study also aims to contribute to the improvement of educational policies, providing guidelines and recommendations for strengthening institutional support, ensuring appropriate working conditions, providing sufficient teaching tools and materials, and creating appropriate conditions for teacher professional development.

Keywords: Access, integration, application, subject, primary education

Qasja gjithëpërfshirëse në arsim: Identifikimi dhe mbështetja e fëmijëve me dhunti dhe talente të veçanta

Inclusive approach in education: Identification and support for gifted and talented children

Lon Laska
Kolegji HEIMERER, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Psikologjike
E-mail: lon.laska@kolegji-heimerer.eu

Abstrakt

Ky studim shqyrton nivelin e njohurive dhe përvojës praktike të mësimdhënësve në identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve me dhunti dhe talente të veçanta. Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësori të strukturuar, i cili është plotësuar nga 147 mësimdhënës të arsimit parauniversitar. Gjetjet tregojnë se shumë mësimdhënës kanë njohuri të kufizuara dhe mungesë trajnimesh të specializuara për punën me fëmijët e talentuar. Këto mangësi lidhen me vështirësitë në identifikimin dhe zhvillimin e potencialit të nxënësve. Përkrahja nga prindërit dhe institucionet edukativo-arsimore shpesh konsiderohet e pamjaftueshme dhe e paqëndrueshme.

Sfida të tjera të theksuara përfshijnë mungesën e kohës dhe resurseve për vlerësimin e plotë, vështirësitë në vlerësimin objektiv të aftësive dhe mungesën e bashkëpunimit ndërinstitucional. Megjithatë, shumica e mësimdhënësve shprehin gatishmëri për zhvillim profesional dhe propozojnë masa, si trajnime të dedikuara, krijimin e programeve të veçanta për fëmijët me dhunti, përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe

Abstract

This study examines the knowledge level and practical experience of teachers in identifying and supporting gifted and talented children. Data were collected through a structured questionnaire completed by 147 pre-university teachers. Findings indicate that many teachers have limited knowledge and lack specialized training for working with gifted students. These gaps are associated with difficulties in identifying and developing students' potential. Support from parents and educational institutions is often perceived as insufficient and unsustainable.

Other challenges highlighted include a lack of time and resources for comprehensive assessment, difficulties in objectively evaluating abilities, and insufficient inter-institutional collaboration. Nevertheless, most teachers expressed a willingness for professional development and proposed measures such as dedicated training, creation of special programs for gifted children, use of technology in teaching, and strengthening cooperation with parents and specialists.

forcimin e bashkëpunimit me prindërit dhe specialistët. Rezultatet e këtij studimi theksojnë nevojën për ndërhyrje të qëndrueshme institucionale dhe zhvillimin e politikave arsimore që promovojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për fëmijët me dhunti dhe talente të veçanta.

Fjalët çelës: dhunti, talente të veçanta, mësimdhënës, identifikim, përkrahje institucionale

The results of this study emphasize the need for sustainable institutional interventions and the development of educational policies that promote an inclusive and supportive approach for gifted and talented children.

Keywords: giftedness, special talents, teachers, identification, institutional support

Ndikimi i vlerësimit formues në të shprehurit me shkrim të nxënësve në ShMU

The impact of formative assessment on students' writing expression in secondary education

Luljeta Hysenaj
Instituti "PESHA"
E-mail: hysenajluljeta@gmail.com

Abstrakt

Në ditët e sotme, jo vetëm te ne, por edhe në botën e jashtme, të shprehurit drejt dhe bukur me shkrim i nxënësve paraqet një problem mjaft serioz. Ky studim synon të hetojë ndikimin e vlerësimit formues (formativ) në përmirësimin e të shprehurit me shkrim të nxënësve - kriter qendror për suksesin akademik. Studimi është kryer në ShFMU "Xhemajl Kada" në Pejë. Popullacioni i synuar përbëhet nga 101 nxënës të klasave të teta dhe 11 mësimdhënës të fushës Gjuhët dhe komunikimi.

Për të vërtetuar hipotezën që sugjeron mundësinë e zhvillimit të shkathtësisë së të shkruarit nëpërmjet vlerësimit formativ. Është përdorur metoda e intervistës me shkrim dhe kemi përzgjedhur pyetësorët si instrumente matëse. Pyetësori i parë është aplikuar te nxënësit dhe pyetësori i dytë iu drejtua mësimdhënësve të fushës Gjuhët dhe komunikimi. E gjithë kjo u realizua brenda tri ditësh.

Analiza e pyetësorit të nxënësve tregon se nxënësit kanë qëndrime pozitive ndaj domosdoshmërisë së zhvillimit të aftësisë së tyre të të shprehurit me shkrim, si dhe ndaj

Abstract

Today, not only locally but also globally, students' ability to write clearly and effectively remains a significant challenge. This study investigates the impact of formative assessment on improving students' writing expression—a central criterion for academic success. The study was conducted at ShFMU "Xhemajl Kada" in Pejë. The target population included 101 eighth-grade students and 11 teachers in the Languages and Communication field.

To test the hypothesis suggesting that writing skills can be developed through formative assessment, written interviews and questionnaires were used as measurement tools. The first questionnaire was administered to students, and the second to teachers of the Languages and Communication field. The data collection took place over three days.

Analysis of student questionnaires shows that students have positive attitudes toward developing their writing skills and appreciate teacher feedback during the writing process (78%). However, in

preferencave të tyre pozitive për korrigjimin nga mësimdhënësit gjatë procesit të të shkruarit (78%,) por në disa faza të të shkruarit ky lloj vlerësim nuk përdoret fare (91%), prandaj edhe s'është habi që në shumë raste nxënësit tanë kanë zbrazëti të madhe. Për sa i përket analizës së pyetësorit të mësimdhënësve, argumentohet se mësimdhënësit nuk i kushtojnë vëmendje të madhe vlerësimit formues në të shprehurit e drejtë me shkrim të nxënësve, e cila te nxënësit tanë ende nuk është ngritur në shkallë të duhur të përvetësimit.

Fjalët çelës: përmirëson, të shprehurit me shkrim, vlerësim formativ

some stages of writing, formative assessment is rarely applied (91%), which partly explains the significant gaps observed in students' writing. Teacher questionnaires indicate that teachers do not consistently focus on formative assessment in students' writing, and students' writing skills have not yet reached the desired level of mastery.

Keywords: improvement, writing expression, formative assessment

Ndikimi i përdorimit të ChatGPT te nxënësit: përparësitë dhe sfidat

The impact of ChatGPT use on students: Advantages and challenges

Luljeta Shala
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Në epokën e digjitalizimit, inteligjenca artificiale (IA) po e transformon ndjeshëm mënyrën e të nxënit në arsimin e mesëm të lartë. Ky studim shqyrton ndikimin e përdorimit të IA-së, me fokus në ChatGPT, në përvojën e të nxënit të nxënësve 14–15 vjeç në komunën e Prishtinës. Theksi vihet mbi balancimin midis përfitimeve dhe sfidave të integrimit të IA-së në arsim, duke analizuar ndikimin e saj në rezultatet mësimore, zhvillimin e mendimit kritik dhe ruajtjen e etikës shkollore.

Metodologjia përfshin analizën sasiore përmes pyetësorëve të plotësuar nga 150 nxënës dhe intervistën me 34 mësimdhënës, duke ofruar një panoramë të thelluar mbi përdorimin dhe përmbajtjen e IA-së në mjedisin shkollor. Nxënësit raportojnë përfitime të dukshme, si përmirësimi i aftësive të shkrimit, pasurimi i fjalorit dhe mbështetje në kuptimin e teksteve. Megjithatë, ata theksojnë edhe sfida, të tilla si varësia nga teknologjia, pasaktësia e informacionit dhe ndikimi në aftësinë për të menduar në mënyrë të pavarur.

Mësimdhënësit shfaqin shqetësime lidhur me autenticitetin e punimeve të nxënësve dhe humbjen e mendimit kritik, duke kërkuar politika

Abstract

In the era of digitalization, artificial intelligence (AI) is significantly transforming the way learning takes place in upper secondary education. This study examines the impact of AI use, with a particular focus on ChatGPT, on the learning experience of 14–15-year-old students in the municipality of Prishtina. The emphasis is placed on balancing the benefits and challenges of integrating AI in education, analyzing its influence on learning outcomes, the development of critical thinking, and the preservation of school ethics.

The methodology includes a quantitative analysis using questionnaires completed by 150 students and interviews with 34 teachers, providing an in-depth view of AI usage and content in the school environment. Students report clear benefits such as improved writing skills, enriched vocabulary, and assistance in understanding texts. However, they also highlight challenges such as dependency on technology, the accuracy of information, and the impact on independent thinking.

Teachers express concerns about the authenticity of student work and the decline of critical thinking, calling for clearer policies and guidelines on the ethical and effective use of AI. The study

dhe udhëzime më të qarta për përdorimin etik dhe efektiv të IA-së. Studimi nënvizon nevojën për edukim digjital dhe trajnime për mësimdhënësit, në mënyrë që përdorimi i teknologjisë të përputhet me zhvillimin e aftësive të pavarura të të nxënit.

Gjetjet sugjerojnë se, nëse përdoret me ndërgjegjësim dhe nën kontroll të vazhdueshëm, ChatGPT mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e të nxënit, duke ruajtur njëkohësisht integritetin shkollor dhe mendimin kritik. Rekomandohet hartimi i politikave arsimore që përfshijnë udhëzime etike, trajnime dhe mbikëqyrje të qëndrueshme për një integrim të plotë dhe të përgjegjshëm të inteligjencës artificiale në arsimin e mesëm të lartë.

Fjalët çelës: inteligjenca artificiale, edukimi, ChatGPT, përparësitë, sfidat

underlines the need for digital education and training for teachers to ensure that technology use aligns with the development of students' autonomous learning skills.

The findings suggest that, when used conscientiously and under continuous supervision, ChatGPT can significantly enhance the quality of learning while maintaining school integrity and critical thinking. It is recommended that educational policies incorporate ethical guidelines, training, and consistent oversight to ensure the responsible and comprehensive integration of artificial intelligence into upper secondary education.

Keywords: artificial intelligence, education, ChatGPT, advantages, challenges.

Shfrytëzimi i mjedisit të jashtëm në institucionet parashkollore në Kosovë: Një vlerësim i frekuentimit dhe ndikimit në zhvillimin e fëmijëve

The use of outdoor environments in preschool institutions in Kosovo: An assessment of frequency and impact on children's development

Mevlude Aliu Gashi
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: mevlude.aliu@rks-gov.net

Abstrakt

Në zhvillimin e fëmijëve në moshë të hershme, mjedisi i jashtëm luan një rol të rëndësishëm, duke ndikuar në aftësitë lëvizore, sociale dhe njohëse. Në kontekstin e institucioneve parashkollore në Kosovë, përdorimi i mjedisit të jashtëm mbetet i kufizuar dhe shpesh i ndikuar nga infrastruktura, metodat e punës dhe qasja ndaj përdorimit të mjedisit stimulues për realizim të aktiviteteve me fëmijë. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë dhe të shqyrtojë mënyrën se si shfrytëzohet mjedisi i jashtëm në institucionet parashkollore dhe si ndikojnë këto aktivitete në zhvillimin e holistik të fëmijës. Studimi, gjithashtu, analizon perceptimet e drejtorëve dhe të prindërve lidhur me këtë dhe identifikon sfidat dhe kufizimet që hasen në shfrytëzimin e mjediseve të jashtme të institucioneve parashkollore.

Studimi është realizuar përmes metodës cilësore, në 10 komuna, duke përfshirë vëzhgimin në aktivitetet e realizuara në mjedise edukative dhe me intervistë gjysmë të strukturuar, me drejtorë dhe prindër. Mostra përfshin 10 edukatore, 10

Abstract

The outdoor environment plays a crucial role in early childhood development, influencing children's motor, social, and cognitive skills. In the context of preschool institutions in Kosovo, the use of outdoor spaces remains limited and is often influenced by infrastructure, teaching methods, and educators' approaches to integrating stimulating environments into daily activities with children. The aim of this study is to examine how outdoor environments are utilized in preschool institutions and how these activities impact children's holistic development. The study also explores the perceptions of directors and parents, identifying challenges and limitations in the use of outdoor spaces in preschool settings.

The study was conducted using a qualitative research approach in 10 municipalities, combining observations of educational activities with semi-structured interviews with directors and parents. The sample included 10 educators, 10 parents, and 10 preschool directors.

prindër dhe 10 drejtorë të institucioneve parashkollore.

Rezultatet nga vëzhgimi i edukatoreve treguan se mjedisi i jashtëm kryesisht shfrytëzohet për aktivitete të lira, më pak ka fokus në shfrytëzimin e këtij mjedisi për zhvillimin social, emocional dhe njohës të fëmijëve. Drejtoreshat theksuan se sfidë janë mungesa e infrastrukturës adekuate dhe planifikimi i strukturuar i punës edukative, ndërsa prindërit theksuan se shfrytëzimi i hapësirave të jashtme duhet të jetë jo vetëm për argëtim të fëmijëve, por edhe për aktivitete edukative dhe të jenë pjesë e planifikimit edukativ dhe e realizimit të përditshëm, pavarësisht kushteve atmosferike.

Studimi jo vetëm që adreson gjendjen aktuale të shfrytëzimit të mjedisit të jashtëm dhe ndikimin në zhvillimin e fëmijëve, por rekomandimet e tij kontribuojnë në politikat arsimore dhe në cilësinë e edukimit në këtë nivel.

Fjalët çelës: institucione parashkollore, mjedis i jashtëm, zhvillim i fëmijëve.

Findings from the observations showed that outdoor environments were mainly used for free play activities, with limited focus on supporting children's social, emotional, and cognitive development. Directors emphasized the lack of adequate infrastructure and structured planning as major challenges, while parents highlighted that outdoor spaces should not only serve as recreational areas but also be integrated into educational activities and daily planning, regardless of weather conditions.

This study not only addresses the current state of outdoor environment use and its impact on children's development but also provides recommendations that can contribute to educational policies and improve the quality of early childhood education.

Keywords: preschool institutions, outdoor environment, child development

Motivimi dhe roli i tij në efikasitetin e mësimdhënies

Motivation and its role in teaching effectiveness

Migena Arllati

Abstrakt

Motivimi përbën një nga faktorët më thelbësorë në procesin arsimor, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe efikasitetin e mësimdhënies. Qëllimi i kësaj kumtese është të analizojë mënyrën se si motivimi, si i mësuesit ashtu edhe i nxënësit, ndikon në arritjen e rezultateve të larta në mësim. Përmes një qasjeje teorike dhe praktike, kumtesa shqyrton format e ndryshme të motivimit - të brendshëm dhe të jashtëm - dhe lidhjen e tyre me angazhimin, qëndrueshmërinë dhe suksesin në klasë. Gjithashtu, paraqiten faktorët që ndikojnë në motivimin e mësuesve, si dhe strategjitë që ata mund të përdorin për të nxitur një ambient të përshtatshëm dhe frytdhënës për të nxënit.

Kumtesa synon të theksojë se motivimi nuk është vetëm një komponent emocional, por një mjet kyç për rritjen e efikasitetit pedagogjik dhe për ndërtimin e një kulture të qëndrueshme arsimore. Në arsimin e mesëm të lartë, ku kërkesat akademike rriten dhe nxënësit përballen me sfida të shumta zhvillimore dhe sociale, motivimi i mësimdhënësit luan një rol të rëndësishëm në garantimin e një procesi mësimor efektiv dhe gjithëpërfshirës. Ky punim trajton ndikimin e motivimit të mësuesit në efikasitetin e

Abstract

Motivation is one of the most essential factors in the educational process, directly influencing the quality and effectiveness of teaching. This paper aims to analyze how motivation—both of teachers and students—affects achieving high learning outcomes. Through a theoretical and practical approach, the study examines different forms of motivation, including intrinsic and extrinsic, and their relationship with engagement, persistence, and classroom success.

The paper also presents factors influencing teacher motivation and strategies that teachers can use to foster a supportive and productive learning environment. It emphasizes that motivation is not merely an emotional component but a key tool for enhancing pedagogical effectiveness and building a sustainable educational culture.

In upper secondary education, where academic demands increase and students face multiple developmental and social challenges, teacher motivation plays a crucial role in ensuring an effective and inclusive learning process. This study focuses on how teachers' attitudes, commitment levels, and interaction styles impact knowledge

mësimdhënies, duke u fokusuar në mënyrën se si qëndrimi, niveli i përkushtimit dhe stili i ndërveprimit me nxënësit ndikojnë në përvetësimin e njohurive dhe në klimën emocionale të klasës. Përmes analizës së literaturës bashkëkohore pedagogjike dhe të dhënave të mbledhura nga mësues të shkollave të mesme të larta, punimi synon të identifikojë faktorët kryesorë që ushqejnë ose dëmtojnë motivimin profesional. Në përfundim, sugjerohen strategji konkrete për të nxitur dhe ruajtur një motivim të qëndrueshëm te mësuesit e këtij niveli, me synimin për të përmirësuar rezultatet mësimore dhe për të zhvilluar një kulturë shkollore më të shëndetshme.

Fjalët çelës: motivimi i mësuesit, arsimi i mesëm i lartë, efikasiteti në mësimdhënie, marrëdhënia mësues-nxënës, cilësia e të nxënit

acquisition and the emotional climate of the classroom. Through the analysis of contemporary pedagogical literature and data collected from upper secondary school teachers, the paper identifies key factors that enhance or hinder professional motivation.

Finally, practical strategies are proposed to foster and maintain sustainable motivation among teachers, with the aim of improving learning outcomes and promoting a healthier school culture.

Keywords: teacher motivation, upper secondary education, teaching effectiveness, teacher-student relationship, learning quality

Edukimi për qytetarinë digjitale në shkollat fillore: Qasje pedagogjike

Digital citizenship education in primary schools: Pedagogical approach

Mimoza Hoti Kolukaj
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Prizren, Kosovë

Senad Orhani
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Në epokën e informacionit dhe komunikimit digjital, edukimi për qytetarinë digjitale është bërë një aspekt thelbësor i përgatitjes së nxënësve për të qenë pjesë aktive, e përgjegjshme dhe e sigurt e komunitetit online. Ky punim synon të shqyrtojë rëndësinë dhe mënyrat e integrimit të qytetarisë digjitale në arsimin fillor përmes një qasjeje pedagogjike gjithëpërfshirëse.

Duke u bazuar në literaturën bashkëkohore dhe në analiza të praktikave arsimore, hulumtimi eksploron njohuritë, qëndrimet dhe kompetencat digjitale që duhet të zhvillohen tek nxënësit që në moshë të hershme. Gjithashtu, paraqiten strategji didaktike për mësuesit që synojnë nxitjen e ndërgjegjësimit për etikën në internet, sigurinë kibernetike, sjelljen përgjegjëse dhe menaxhimin e informacionit në mjediset online.

Gjetjet theksojnë nevojën për zhvillimin profesional të mësuesve dhe përfshirjen e qytetarisë digjitale si komponent i integruar në kurrikulë. Studimi

Abstract

In the era of digital information and communication, education for digital citizenship has become a crucial aspect of preparing students to be active, responsible, and safe members of the online community. This paper examines the importance and methods of integrating digital citizenship into primary education through a comprehensive pedagogical approach.

Based on contemporary literature and analyses of educational practices, the study explores the digital knowledge, attitudes, and competencies that should be developed in students from an early age. It also presents didactic strategies for teachers aiming to promote awareness of online ethics, cybersecurity, responsible behavior, and information management in digital environments.

The findings highlight the need for teacher professional development and the inclusion of digital citizenship as an integrated component of the curriculum. The study suggests a balanced

sugjeron një qasje të balancuar mes teknologjisë, pedagogjisë dhe edukimit etik, duke e konsideruar qytetarinë digjitale jo thjesht si përmbajtje teknologjike, por si një dimension i formimit qytetar të brezave të rinj.

Fjalët çelës: edukimi fillor, kompetencat digjitale, pedagogjia, qytetaria digjitale, teknologjia

approach between technology, pedagogy, and ethical education, considering digital citizenship not merely as technological content but as a key dimension of civic formation for future generations

Keywords: primary education, digital competencies, pedagogy, digital citizenship, technology

Roli i lëvdatës krahasuar me kritikën në motivimin e nxënësve

The role of praise compared to criticism in student motivation

Mimoza Voca
Shkolla “Mileniumi i Tretë”
E-mail: mimoza.voca@student.uni-pr.edu

Brikena Ademi
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës
E-mail: brikena.ademi@student.uni-pr.edu

Artiola Hyseni
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës
E-mail: artiola.hyseni@student.uni-pr.edu

Abstrakt

Motivimi i nxënësve për të mësuar përbën një aspekt qendror në procesin edukativo-arsimor, veçanërisht në arsimin fillor. Ky studim në veprim ka për qëllim të shqyrtojë rolin e lëvdatës së sinqertë dhe të kritikës konstruktive në mënyrën se si nxënësit e përjetojnë dhe e shfaqin motivimin gjatë të nxënit.

I mbështetur në qasjen cilësore, hulumtimi përdor vëzhgimin sistematik në klasë, si metodë kryesore për mbledhjen e të dhënave, duke u shoqëruar edhe me ditar reflektiv të mësimdhënësit. Studimi do të zhvillohet gjatë periudhës 5–19 maj, me nxënës të klasës së dytë, dhe do të vëzhgohet reagimi i tyre ndaj formave të ndryshme të feedback-ut verbal gjatë situatave të mësimdhënies.

Sipas literaturës bashkëkohore, lëvdata e qartë dhe e përqendruar në përpjekje pritet të luajë një

Abstract

Student motivation is a central aspect of the educational process, particularly in primary education. This action research aims to examine the role of sincere praise and constructive criticism in how students perceive and express motivation during learning activities.

Based on a qualitative approach, the study employs systematic classroom observation as the primary data collection method, supplemented by the teacher’s reflective journal. The research is conducted from May 5–19 with second-grade students, observing their responses to different forms of verbal feedback during teaching situations.

According to contemporary literature, clear and effort-focused praise is expected to support

rol mbështetës në rritjen e përfshirjes dhe vetëbesimit të nxënësve, ndërsa kritika konstruktive, kur ofrohet në mënyrë të respektueshme, mund të shërbejë si nxitës për vetëreflektim dhe përmirësim të qëllimshëm. Ky hulumtim synon të kontribuojë në zhvillimin e praktikave pedagogjike që promovojnë përdorimin e vetëdijshëm të reagimeve verbale, si pjesë e procesit të të nxënit.

Fjalët çelës: motivimi, lëvdata, kritika konstruktive, feedback-u verbal, arsimi fillor, klasa e dytë

increased engagement and self-confidence among students, while constructive criticism, when delivered respectfully, can serve as a catalyst for self-reflection and purposeful improvement. This study seeks to contribute to the development of pedagogical practices that promote the conscious use of verbal feedback as an integral part of the learning process.

Keywords: motivation, praise, constructive criticism, verbal feedback, primary education, second grade

Bashkëpunimi prindër–mësues në zbatimin e aktiviteteve jashtëshkollore si pjesë e kurrikulës së zgjeruar

Parent–teacher collaboration in the implementation of extracurricular activities as part of the expanded curriculum

Mirlinda Bunjaku Isufi
Fakulteti i Edukimit, Universiteti 'Kadri Zeka', Gjilan
E-mail: mirlindabunjaku747@gmail.com

Abstrakt

Zbatimi i kurrikulës nuk kufizohet vetëm në përmbajtjen mësimore, por kërkon ndërlidhje me jetën reale, përmes aktiviteteve jashtëshkollore dhe jashtëmësimore. Këto aktivitete janë të parashikuara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, si pjesë thelbësore për zhvillimin e kompetencave të përgjithshme të nxënësve, si komunikimi, puna në grup dhe përgjegjësia qytetare.

Ky studim trajton rolin e partneritetit prindër–mësues në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore, si pjesë e kurrikulës së zgjeruar. Në hulumtim janë përfshirë 500 pjesëmarrës – 250 mësues dhe 250 prindër – nga dhjetë shkolla fillore publike në Kosovë, të përzgjedhura nga zona urbane dhe rurale. Është aplikuar një qasje e kombinuar metodologjike, me pyetësorë të strukturuar për të dhëna sasiore dhe intervista gjysmë të strukturuara për pasurim cilësor. Është analizuar gjithashtu dokumentacioni shkollor mbi përfshirjen formale të aktiviteteve jashtëkurrikulare në kurrikulë.

Abstract

The implementation of the curriculum goes beyond instructional content, requiring meaningful connections to real-life experiences through extracurricular and co-curricular activities. These activities are highlighted in the Kosovo Curriculum Framework as essential components for developing students' key competencies, including communication, teamwork, and civic responsibility.

This study explores the role of parent–teacher collaboration in the planning and execution of extracurricular activities as an integral part of the expanded curriculum. The research involved 500 participants—250 teachers and 250 parents—from ten public primary schools in Kosovo, selected from both urban and rural areas. A mixed-methods approach was employed, combining structured questionnaires for quantitative data collection and semi-structured interviews for qualitative enrichment. Additionally, school documents were analyzed to evaluate the formal inclusion of extracurricular activities within the curriculum framework.

Gjetjet tregojnë se përfshirja aktive e prindërve në jetën shkollore, sidomos përmes aktiviteteve jashtëmësimore, forcon bashkëpunimin shkollë–familje dhe krijon një klimë mbështetëse për zbatimin efektiv të kurrikulës. Rekomandohet që shkollat të institucionalizojnë këtë partneritet dhe të shfrytëzojnë aktivitetet jashtëshkollore/jashtëmësimore, si ura ndërmjet të nxënit dhe jetës reale.

Fjalët çelës: kurrikula zgjeruar, partneriteti prindër–mësues, aktivitetet jashtëshkollore, aktivitetet jashtëmësimore, zhvillimi i kompetencave

The findings reveal that active parental involvement in school life, particularly through extracurricular engagement, strengthens the school–family partnership and fosters a supportive environment for effective curriculum implementation. The study recommends institutionalizing such collaboration and leveraging extracurricular and co-curricular activities as bridges between formal learning and real-life application.

Keywords: expanded curriculum; parent–teacher partnership; extracurricular activities; co-curricular activities; competency development

Qasjet gjithëpërfshirëse në edukim: Roli i partneritetit shkollë–familje në realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore

Inclusive approaches in education: The role of school–family partnership in implementing extracurricular activities

Mirlinda Bunjaku Isufi
Fakulteti i Edukimit, Universiteti 'Kadri Zeka', Gjilan
E-mail: mirlindabunjaku747@gmail.com

Eranda Bilali
Universiteti i Shkodes "Luigj Gurakuqi" Shkoder, Shqipri
E-mail: eranda.bilali@unishk.edu.al

Abstrakt

Në qasjet bashkëkohore për edukim gjithëpërfshirës, partneriteti ndërmjet shkollës dhe familjes zë një vend thelbësor, veçanërisht në zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore që mbështesin rritjen e gjithanshme të nxënësve. Aktivitetet jashtëshkollore, si projektet kreative, klubet tematike, ekskursionet dhe aktivitetet sportive, përbëjnë një mundësi të vlefshme për ndërtimin e aftësive sociale, emocionale dhe praktike te fëmijët, përtej përmbajtjes së kurrikulës formale.

Ky punim mbështetet në një studim të thelluar cilësor të realizuar në dhjetë shkolla fillore publike në Kosovë, të përzgjedhura në mënyrë të balancuar nga mjedise urbane dhe rurale. Në qendër të hulumtimit qëndronin përvojat, perceptimet dhe praktikat e aktorëve kyç arsimor, mësuesve, prindërve, drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë lidhur me mënyrën se si ndërtohet dhe funksionon partneriteti shkollë–

Abstract

In contemporary approaches to inclusive education, the partnership between school and family holds a crucial place, particularly in the development of extracurricular activities that support the holistic growth of students. Extracurricular activities—such as creative projects, thematic clubs, excursions, and sports—provide valuable opportunities to foster students' social, emotional, and practical skills beyond the formal curriculum.

This paper is based on an in-depth qualitative study conducted in ten public primary schools in Kosovo, selected in a balanced way from both urban and rural settings. The research focused on the experiences, perceptions, and practices of key educational actors—teachers, parents, school principals, and quality coordinators—regarding how the school–family partnership is built and functions within the context of extracurricular

familje në kontekstin e aktiviteteve jashtëshkollore. Qëllimi i studimit ishte të shqyrtojë rolin e partneritetit shkollë–familje në funksionimin e suksesshëm të aktiviteteve jashtëshkollore. Përmes një metodologjie cilësore, me intervista gjysmë të strukturuara dhe analizë dokumentacioni, u vërejt se përfshirja aktive e prindërve në planifikim, mbështetje dhe pjesëmarrje kontribuon ndjeshëm në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtyre aktiviteteve.

Gjetjet theksojnë se kur partneriteti është i strukturuar dhe i vazhdueshëm, aktivitetet jashtëshkollore realizohen në mënyrë më efektive, duke ndikuar pozitivisht në përfshirjen dhe motivimin e nxënësve. Si përfundim, ky studim rekomandon fuqizimin institucional të këtij partneriteti si një shtyllë e rëndësishme për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës gjatë gjithë jetës.

Fjalët çelës: partneriteti shkollë–familje, aktivitetet jashtëshkollore, edukimi gjithëpërfshirës, bashkëpunimi prindër–mësues, arsimi fillor

activities. The aim was to examine the role of this partnership in ensuring the effective implementation of such activities. Using a qualitative methodology, semi-structured interviews and document analysis were employed. Findings revealed that active parental involvement in the planning, support, and participation processes significantly enhances the quality and sustainability of extracurricular programs.

The study concludes that when partnerships are well-structured and continuous, extracurricular activities are implemented more effectively, positively impacting students' engagement and motivation. It recommends institutional reinforcement of school–family collaboration as a key pillar for the development of inclusive lifelong education.

Keywords: school–family partnership, extracurricular activities, Inclusive education, parent–teacher collaboration, primary education

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve në Kosovë: Eksplorimi i nevojave, sfidave dhe mundësive

Continuous professional development of teachers in Kosovo: Exploring needs, challenges, and opportunities

Mirsad Suhodolli
Public International Business College – Mitrovica, Kosovo
E-mail: m.suhodolli@ibcmitrovica.eu | mirsad.suhodolli@gmail.com

Abstrakt

Në Kosovë, zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP) i mësimdhënësve është një nga komponentët më të rëndësishëm në përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Janë organizuar shumë trajnime në këtë drejtim, prandaj sigurimi i të dhënave më të sakta dhe gjetja e mënyrave për avancimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve ishin në qendër të këtij punimi. Metodologjia u bazua në hulumtim në literaturë, ku studiuesi konsultoi një gamë të gjerë literaturash dhe dokumentesh nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, si dhe studime të kryera nga organizata ndërkombëtare, si Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF) dhe UNICEF-i. Për qëllime krahasimi, u analizuan edhe studime të kryera në vende të tjera.

Rezultatet tregojnë se ekzistojnë mundësi për mësimdhënësit që të ndjekin zhvillimin e vazhdueshëm profesional për sa kohë që zbatohen sisteme dhe mjete moderne për këtë qëllim. Prandaj, është e nevojshme një strategji më e mirë për të mundësuar zhvillimin efektiv profesional të mësimdhënësve. Gjithashtu, ky

Abstract

In Kosovo, the continuous professional development (CPD) of teachers is one of the most critical components in ongoing efforts to improve the quality of education. Numerous training initiatives have been organized in this area, making it essential to gather accurate data and identify ways to advance teachers' professional development.

The methodology is based on a literature review, consulting a wide range of documents from the Ministry of Education, Science, and Technology, as well as studies conducted by international organizations such as the European Training Foundation (ETF) and UNICEF. Comparative analyses of studies from other countries were also included.

The results indicate that opportunities exist for teachers to engage in continuous professional development, provided that modern systems and tools are implemented for this purpose. Therefore, a well-structured strategy is necessary to enable effective professional growth.

studim vë në pah rëndësinë e mekanizmave të feedback-ut dhe mjeteve digjitale, si dhe të politikave gjithëpërfshirëse për një ZHVP më të qëndrueshme. Për ta arritur këtë, qasjet e përdorura duhet të jenë më të synuara dhe të përshtatura me kontekstin, që do të thotë se ato duhet të zbatohen brenda kornizës së sistemit arsimor të Kosovës. Këto aspekte do të trajtohen më hollësisht në pjesët e rezultateve dhe diskutimit të këtij punimi.

Fjalët çelës: zhvillim i vazhdueshëm profesional, mësim i kombinuar, zhvillim sistematik i mësimdhënësve, trajnim i mësimdhënësve, qasje të përshtatura me kontekstin

The study also highlights the importance of feedback mechanisms, digital tools, and comprehensive policies for sustainable CPD. Approaches should be targeted and contextually adapted, meaning they must align with the framework of Kosovo's education system. These aspects are discussed in detail in the results and discussion sections of this study.

Keywords: continuous professional development, blended learning, systematic teacher development, teacher training, contextually adapted approaches

Sekuencimi dhe përmbajtjet tematike në tekstet shkollore: Ndikimi në kulturën e leximit të nxënësve 15-vjeçarë

Sequencing and thematic content in school textbooks: Their impact on the reading culture of 15-year-old students

Murteza Osdautaj
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Ky punim shqyrton ndikimin e sekuencimit kohor dhe tematik të përmbajtjeve në tekstet shkollore dhe rolin e tij në zhvillimin e kulturës së leximit te nxënësit 15-vjeçarë. Qëllimi është të analizohet se si struktura, koherenca dhe përkatësia e përmbajtjes tematike ndikojnë në motivimin, angazhimin e qëndrueshëm dhe kuptimin e thelluar gjatë leximit. Duke përdorur një qasje të kombinuar metodologjike - analizë përmbajtjeje, anketime me nxënës dhe të dhëna krahasuese nga testimet PISA dhe PIRLS - studimi identifikon modele pedagogjike që ndihmojnë ose pengojnë zhvillimin e shprehive të leximit. Gjetjet theksojnë se tekstet me koherencë tematike dhe përmbajtje të përshtatur kulturore, të renditura në mënyrë strategjike, rrisin të menduarit kritik dhe mbështesin zhvillimin afatgjatë të shkrim-leximit. Studimi ofron rekomandime praktike për autorët e teksteve, hartuesit e kurrikulës dhe mësuesit e arsimit të mesëm të ulët.

Për t'i konstatuar këto ndikime dhe për ta hulumtuar nëse përmbajtjet tematike të teksteve tona kanë ndikim në zhvillimin e kulturës së leximit,

Abstract

This paper investigates the role of thematic sequencing in school textbooks and its influence on the development of reading culture among 15-year-old students. The study focuses on how the structure, coherence, and relevance of thematic content contribute to student motivation, sustained reading engagement, and deeper comprehension. Using a mixed-methods approach—including textbook content analysis, student surveys, and references to PISA and PIRLS data—the research identifies pedagogical patterns that either foster or hinder reading habits. The findings suggest that thematically coherent and culturally resonant texts, when sequenced strategically, can enhance critical thinking and support long-term literacy development. The study offers actionable insights for textbook authors, curriculum developers, and educators committed to improving reading outcomes at the lower secondary level.

As part of our research, we interviewed 57 school principals from both lower and upper secondary schools across the country. In addition, we analyzed responses from over 100 Albanian

gjatë hulumtimit, kemi intervistuar 57 drejtorë shkollash, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, nga krejt Kosova. Kemi analizuar përgjigjet e dhëna nga më shumë 100 mësimdhënës të Gjuhës Shqipe, në klasat e nënta dhe të dhjeta, si dhe kemi mbledhur dhe analizuar përgjigjet e më shumë se 160 prindërve dhe të 480 nxënësve.

Rezultatet e mbledhura dhe të analizuara dhe krahasimi i tyre me arritshmërinë në testimet ndërkombëtare na japin një sfond tepër kompleks në lidhje me temën dha na japin perspektiva të reja se si duhet t'i qasemi shkrimit të teksteve shkollore, përmbajtjeve tematike të tyre, si dhe sekuencimit të atyre përmbajtjeve në funksion të zhvillimit të kulturës së leximit.

Fjalët çelës: kultura e leximit, sekuencimi tematik, përmbajtja e teksteve shkollore, nxënësit 15-vjeçarë, dizajni i kurrikulës, PISA, PIRLS, zhvillimi i shkrim-leximit, angazhimi në lexim, politika arsimore

language teachers teaching 9th and 10th grade. To gain a broader perspective, we also collected and reviewed the opinions of more than 160 parents and 480 students.

The data gathered from these diverse sources, when compared with student performance on international assessments such as PISA and PIRLS, reveals a complex and nuanced picture. These findings offer fresh insights into how we might rethink textbook development—specifically, how we design thematic content and structure its sequencing—in order to support the formation of a strong and lasting reading culture among students.

Keywords: reading culture, thematic sequencing, textbook content, 15-year-old students, curriculum design, PISA, PIRLS, literacy development, reading engagement, education policy

Efekti i programit psikoedukues, bazuar në qasjen kognitive për menaxhimin e agresivitetit te fëmijët e shkollës fillore

The effect of a psychoeducational program based on a cognitive approach on aggression management in primary school children

Mynever Basha
E-mail: myneverbasha.med@gmail.com

Abstrakt

Ky studim shqyrton efektin e një programi psikoedukues të bazuar në qasjen kognitive për menaxhimin e sjelljeve agresive te fëmijët e shkollës fillore. Programi synon të zhvillojë te fëmijët aftësi për kontrollin e impulseve, rregullimin emocional dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve, përmes teknikave kognitive të strukturuara dhe ushtrimeve praktike.

Studimi është realizuar me një dizajn kuantitativ të tipit para-test/pas-test, duke përfshirë 120 nxënës nga shkolla fillore “Ibrahim Fehmiu”. Programi u zbatua gjatë katër seancave edukative dhe u vlerësua përmes një pyetësori të standardizuar me shkallë Likert.

Rezultatet tregojnë një përmirësim të dukshëm pas zbatimit të programit: 67.5% e nxënësve raportuan kontroll më të mirë të impulseve agresive, 73.3% menaxhuan më mirë situatat provokuese dhe 75% përvetësuan strategji më efektive për zgjidhjen e konflikteve. U evidentua gjithashtu një përmirësim i ndjeshëm në komunikim dhe bashkëpunim me bashkëmoshatarët. Analizat statistikore (T-test,

Abstract

This study examines the effect of a cognitive-based psychoeducational program on managing aggressive behaviors in primary school children. The program aims to develop children’s skills in impulse control, emotional regulation, and peaceful conflict resolution through structured cognitive techniques and practical exercises.

The study employed a quantitative pre-test/post-test design, involving 120 students from “Ibrahim Fehmiu” Primary School. The program was implemented over four educational sessions and evaluated using a standardized Likert-scale questionnaire.

Results indicate significant improvements following the program: 67.5% of students reported better control over aggressive impulses, 73.3% managed provocative situations more effectively, and 75% adopted more effective conflict-resolution strategies. Improvements were also observed in communication and peer collaboration. Statistical analyses (T-test, ANOVA) confirmed statistically

ANOVA) konfirmuan dallime statistikisht të rëndësishme në disa nga treguesit, si dhe disa variacione në bazë gjinie ($p < .05$).

Ky program përfaqëson një ndërhyrje të strukturuar dhe të përshtatshme për mjedisin shkollor. Në krahasim me ndërhyrjet ekzistuese, ai thekson zhvillimin e aftësive mendore për vetë-rregullim dhe menaxhim të emocioneve, duke ofruar një qasje konkrete për parandalimin dhe reduktimin e sjelljeve agresive. Rekomandohet për zbatim të mëtejshëm në shkolla, me përfshirje të mësuesve dhe prindërve në proces.

Fjalët çelës: program psikoedukues, qasje kognitive, agresivitet, rregullim emocional, shkolla fillore

significant differences in several indicators, with some gender-based variations ($p < .05$).

This program represents a structured and context-appropriate intervention for the school environment. Compared to existing interventions, it emphasizes the development of cognitive skills for self-regulation and emotional management, offering a concrete approach to preventing and reducing aggressive behaviors. Further implementation in schools is recommended, with active involvement of teachers and parents in the process.

Keywords: psychoeducational program, cognitive approach, aggression, emotional regulation, primary school

Përvojat e drejtorëve të shkollave gjatë zbatimit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve

School principals' experiences during the implementation of teacher performance appraisal

Addhe Krasniqi
SHFMU "Pjetër Budi" - Pejë
E-mail: addhe.krasniqi@gmail.com

Nehat Duraku
SHFMU "Isa Boletini" - Rahovec
E-mail: nduraku11@gmail.com

Abstrakt

Ky studim synon të vërë në pah përvojat e drejtorëve të shkollave në komunën e Pejës gjatë fazës së parë të zbatimit të procesit të Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve (VPM). Theksi vihet në aspektet praktike të zbatimit të këtij procesi, duke përfshirë marrjen e udhëzimeve fillestare, organizimin e ekipit të brendshëm vlerësues, përdorimin e instrumenteve të vlerësimit dhe hartimin e raporteve përfundimtare që ndikojnë në licencimin e mësimdhënësve.

Përmes një qasjeje cilësore, do të intervistohen drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, të cilët kanë përfunduar procesin e VPM-së në institucionet e tyre. Të dhënat do të analizohen për të identifikuar përvojat e tyre, sfidat e hasura dhe nivelin e bashkëpunimit me DKA-të, MAShTI-n dhe aktorë të tjerë përkatës.

Rezultatet do të nxjerrin në pah vështirësitë teknike dhe administrative me të cilat janë përballur

Abstract

This study aims to highlight the experiences of school principals in the municipality of Peja during the initial phase of implementing the Teacher Performance Evaluation (TPE) process. The focus is on the practical aspects of this implementation, including receiving initial guidelines, organizing the internal evaluation team, using evaluation instruments, and preparing final reports that impact teacher licensing.

Through a qualitative approach, principals of primary, lower secondary, and upper secondary schools who have completed the TPE process in their institutions will be interviewed. The data will be analyzed to identify their experiences, challenges encountered, and the level of collaboration with Municipal Education Departments (DKAs), the Ministry of Education, Science, Technology, and Innovation (MESTI), and other relevant stakeholders.

drejtorët, përfshirë mungesën e qartësisë në udhëzime, ngarkesën e shtuar administrative dhe mbështetjen e paktë institucionale. Megjithatë, ato, gjithashtu, do të evidentojnë përpjekjet për zbatim korrekt dhe mbështetjen ndaj mësimdhënësve gjatë këtij procesi. Ky studim do të kontribuojë në kuptimin më të mirë të rolit të udhëheqësve të shkollave në zbatimin e politikave të reja arsimore dhe ofron rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të VPM-së në nivel institucional.

Fjalët çelës: vlerësimi i performancës, udhëheqësve të shkollave, zbatimi i politikave arsimore, licencimi i mësimdhënësve

The findings are expected to highlight the technical and administrative difficulties faced by principals, including unclear guidelines, increased administrative workload, and limited institutional support. However, they will also underscore efforts to ensure proper implementation and support for teachers throughout this process. This study will contribute to a better understanding of the role of school leaders in implementing new educational policies and provide recommendations for further improvement of the TPE process at the institutional level.

Keywords: performance evaluation, school leadership, implementation of educational policies, teacher licensing

Roli i zhvillimit profesional të vazhdueshëm në udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollës: Studim rasti në komunën e Rahovecit

The role of continuous professional development in school leadership and management: A case study in the municipality of Rahovec

Nehat Duraku
SHFMU "Isa Boletini"-Rahovec
E-mail: nduraku11@gmail.com

Abstrakt

Drejtuesit e shkollave luajnë një rol thelbësor në menaxhimin dhe udhëheqjen institucionale, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin profesional të stafit, cilësinë e mësimdhënies, arritjet e nxënësve dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për të nxënë dhe bashkëpunim. Me gjithë kërkesat e përcaktuara në standardet profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë, vërehet një mungesë përfshirjeje dhe mbështetjeje institucionale për zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë ndikimin e zhvillimit profesional të drejtorëve në përmirësimin e menaxhimit dhe udhëheqjes efektive të shkollës, si dhe të identifikojë sfidat dhe mundësitë për avancimin e këtij procesi. Studimi, i bazuar në pikëpamjet e drejtorëve të shkollave të komunës së Rahovecit, shqyrton efektivitetin e programeve të ndjekura në menaxhimin e stafit, zbatimin e strategjive bashkëkohore pedagogjike dhe krijimin e një klime mbështetëse për të nxënë.

Abstract

School leaders play a fundamental role in institutional management and leadership, directly influencing staff professional development, teaching quality, student achievement, and the establishment of a collaborative and supportive learning environment. Despite the requirements outlined in the professional standards for school principals in Kosovo, there remains a lack of systematic institutional support for continuous professional development (CPD).

This study aims to analyze the impact of principals' professional development on improving effective school leadership and management, while also identifying key challenges and opportunities to strengthen this process. Drawing on the perspectives of school principals in the municipality of Rahovec, the study examines the effectiveness of CPD programs in staff management, the application of contemporary pedagogical strategies, and the fostering of a supportive school climate.

Pyetja kryesore e hulumtimit është: Cili është roli i zhvillimit profesional të vazhdueshëm në përmirësimin e udhëheqjes dhe menaxhimit të shkollave në komunën e Rahovecit? Është përdorur një qasje e kombinuar metodologjike, përmes analizës përmbajtjesore të dokumenteve të programeve të trajnimit për drejtorë shkollash, pyetësorëve të strukturuar me 20 drejtorë - mostër nga 30 drejtorë, dhe intervistave gjysmë të strukturuara me 2 zyrtarë të DKA-së.

Rezultatet pritet të kontribuojnë në përmirësimin e politikave dhe praktikave të menaxhimit në nivel komunal dhe në rritjen e kapaciteteve udhëheqëse përmes zhvillimit profesional cilësor e të qëndrueshëm.

Fjalët çelës: zhvillim profesional, udhëheqje shkollore, menaxhim i arsimit, cilësi në mësimdhënie, trajnim i drejtorëve

The central research question guiding this study is: *What is the role of continuous professional development in enhancing school leadership and management in the municipality of Rahovec?* To address this, a mixed-methods approach was applied, including content analysis of training program documents for principals, structured questionnaires with 20 principals (sampled from a total of 30), and semi-structured interviews with 2 officials from the Municipal Education Directorate (MED).

The findings are expected to contribute to the improvement of educational management policies and practices at the municipal level, while also enhancing school leadership capacities through high-quality and sustainable professional development.

Keywords: professional development, school leadership, education management, teaching quality, principal training

Ngritja e kapaciteteve për rishikim dhe përmirësim të teksteve shkollore: Përvoja nga mësimdhënësit

Developing capacities for review and revision of textbooks: Teachers' experiences

Osman Buleshkaj
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Fadil Latifi, Armend Shabani, Mihaela Singer
KosED

Abstrakt

Ky studim synon të vlerësojë efektivitetin e trajnimit "Ngritja e kapaciteteve për rishikim dhe përmirësim të teksteve shkollore" në rritjen e kompetencave të mësimdhënësve për analizimin kritik të përmbajtjes, identifikimin e mangësive dhe përparësive të teksteve mësimore, si dhe në përzgjedhjen e materialeve më të përshtatshme për përdorim në klasë. Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në faktin se cilësia e teksteve mësimore ka ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e të nxënit dhe në rezultatet akademike të nxënësve. Në anën tjetër, mësimdhënësit, si përdorues dhe vlerësues të këtyre materialeve, luajnë një rol kyç në garantimin e standardeve të larta të teksteve në përdorim, si nga ana pedagogjike ashtu edhe përmbajtjesore.

Metodologjia e studimit bazohet në një qasje kuantitative, duke përdorur një pyetësor të strukturuar për matjen e perceptimeve të pjesëmarrësve mbi përfitimet nga trajnimi, si dhe

Abstract

This study aims to assess the effectiveness of the training program *"Capacity Building for the Review and Improvement of School Textbooks"* in enhancing teachers' competencies for critically analyzing content, identifying the shortcomings and strengths of textbooks, and selecting the most appropriate teaching materials for classroom use. The significance of this research lies in the fact that the quality of school textbooks has a direct impact on the learning process and students' academic outcomes. Teachers, as both users and evaluators of these materials, play a key role in ensuring high standards in textbooks, both in pedagogical and content-related terms.

The study's methodology is based on a quantitative approach, using a structured questionnaire to measure participants' perceptions of the training benefits, combined with a qualitative approach involving data analysis from participants'

kualitative, duke përdorur analizën e të dhënave nga raportet e pjesëmarrësve dhe trajnerëve të programit. Pyetësori përfshin variabla që lidhen me aftësinë për të aplikuar kritere profesionale në përzgjedhjen e teksteve, zhvillimin e mendimit kritik, vetëdijen për ndikimin e materialeve mësimore në arritjet e nxënësve dhe gatishmërinë për të kontribuar në proceset e përmirësimit të përmbajtjes. Ndërsa për analizën cilësore përdoret analiza tematike.

Të dhënat e mbledhura ofrojnë bazë për një analizë të argumentuar mbi ndikimin e programeve të zhvillimit profesional në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultatet e nxënësve. Gjithashtu, mund të shërbejnë si referencë për hartimin e politikave arsimore që synojnë avancimin e standardeve për tekste shkollore në Kosovë.

Fjalët çelës: zhvillim profesional, vlerësim trajnimi, tekste shkollore, cilësia e mësimdhënies, mësimdhënës

and trainers' reports. The questionnaire includes variables related to the ability to apply professional criteria in textbook selection, the development of critical thinking, awareness of the impact of educational materials on student achievement, and willingness to contribute to content improvement processes. For the qualitative analysis, thematic analysis is employed.

The collected data provide a basis for an evidence-based assessment of the impact of professional development programs on improving teaching quality and student outcomes. Furthermore, the findings may serve as a reference for the development of education policies aimed at advancing textbook standards in Kosovo.

Keywords: professional development, training evaluation, school textbooks, teaching quality, teachers.

Roli i edukatorit special dhe rehabilitatorit në institucionet arsimore: Një qasje teorike

The role of the special educator and rehabilitator in educational institutions: A theoretical approach

Qendresa Mustafi
SHTMK "Nace Bugjoni" Kumanovë

Buniamin Memedi
Universiteti i Tetovës

Abstrakt

Edukatori special dhe rehabilitatori luajnë një rol të pazëvendësueshëm në sistemin arsimor gjithëpërfshirës, veçanërisht në shkollat e rregullta në Maqedoninë e Veriut. Roli i tyre nuk kufizohet vetëm në mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, por shtrihet edhe në ndihmën që u ofrojnë mësimdhënësve për të zbatuar strategji të përshtatshme pedagogjike. Ky punim shqyrton në mënyrë teorike rëndësinë e këtij profesioni në përmirësimin e aftësive akademike, sociale dhe emocionale të nxënësve, duke e vendosur edukatorin special, si një hallkë kyçe në ndërtimin e një mjedisi gjithëpërfshirës.

Përmes analizës së literaturës dhe dokumenteve vendase të arsimit, janë identifikuar përgjegjësitë kryesore të edukatorit special: vlerësimi individual i nevojave të nxënësve, hartimi i planeve individuale arsimore, mbështetja për mësimdhënësit dhe familjen, si dhe zbatimi i metodave pedagogjike dhe rehabilituese. Rezultatet e analizës tregojnë se prania aktive e

Abstract

The special educator and rehabilitator play an irreplaceable role in an inclusive educational system, particularly in regular schools in North Macedonia. Their role extends beyond supporting students with special educational needs to assisting teachers in implementing appropriate pedagogical strategies. This paper theoretically examines the importance of this profession in enhancing students' academic, social, and emotional skills, positioning the special educator as a key link in creating an inclusive environment.

Through analysis of literature and national educational documents, the main responsibilities of the special educator have been identified: assessing individual student needs, designing individualized education plans, supporting teachers and families, and implementing pedagogical and rehabilitative methods. The analysis indicates that the active presence of special educators positively affects inclusion, self-confidence, and achievements of students with

edukatorit special ndikon pozitivisht në rritjen e përfshirjes, vetëbesimit dhe arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe në përmirësimin e praktikave mësimore të mësimdhënësve në klasë.

Megjithatë, sfida si mungesa e resurseve, trajnimi i kufizuar dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërdisiplinor, pengojnë zbatimin efektiv të këtij roli. Ky punim nxit reflektim profesional dhe institucional mbi rëndësinë e edukatorit special dhe rehabilitatorit në shkollat e rregullta dhe nevojën për mbështetje sistematike në Maqedoninë e Veriut.

Fjalët çelës: edukator special, rehabilitator, gjithëpërfshirje, mësimdhënës, Maqedonia e Veriut

special needs, as well as improving classroom teaching practices.

However, challenges such as lack of resources, limited training, and insufficient interdisciplinary collaboration hinder the effective implementation of this role. This paper encourages professional and institutional reflection on the importance of special educators and rehabilitators in regular schools and the need for systematic support in North Macedonia.

Keywords: special educator, rehabilitator, inclusion, teacher support, North Macedonia

Format e bashkëpunimit efektiv mësimdhënës-nxënës në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë

Effective teacher-student collaboration models in upper secondary education in Kosovo

Safete Statovci - Shala
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: Safete_shala2@hotmail.com

Abstrakt

Komunikimi dhe format e bashkëpunimit efektiv ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve përbëjnë komponentë thelbësorë në zhvillimin individual dhe ndërtimin e marrëdhënieve në kontekstin arsimor. Format e bashkëpunimit përfaqësojnë një proces ndërpersonal kompleks, duke krijuar mundësi të shumta për shprehjen e aftësive komunikuese dhe interpretative. Këto forma luajnë një rol shumë të rëndësishëm në strukturimin e marrëdhënieve, qoftë në nivel individual apo institucional, duke mundësuar ndërtimin e tyre në mënyrë të strukturuar, të këndshme dhe reciprokisht të pranueshme.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë dhe të identifikojë format e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve, duke u bazuar në përvojat praktike të shkollave në këtë drejtim. Për realizimin e studimit, kemi aplikuar qasje të kombinuar metodologjike, duke integruar metoda sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore janë mbledhur përmes pyetësorëve të administruar me nxënës, ndërsa të dhënat cilësore do të sigurohen përmes pyetjeve të hapura dhe intervistave të

Abstract

Communication and effective collaboration between teachers and students constitute essential components in individual development and relationship-building within the educational context. Forms of collaboration represent a complex interpersonal process, creating multiple opportunities for the expression of communicative and interpretative skills. These forms play a significant role in shaping relationships, both on an individual and institutional level, enabling their development in a structured, pleasant, and mutually acceptable manner.

The aim of this research is to analyze and identify the forms of collaboration between teachers and students, based on practical experiences from schools in this regard. A mixed methodological approach was applied for the study, integrating both quantitative and qualitative methods. Quantitative data were collected through questionnaires administered to students, while qualitative data were gathered through open-ended questions and structured interviews with teachers. The selected sample includes students

strukturuara me mësimdhënës. Mostra e përzgjedhur përbëhet nga nxënës të klasave të dhjeta, të njëmbëdhjeta dhe të dymbëdhjeta, si dhe nga mësimdhënësit që punojnë me ta në komunën e Prishtinës.

Analiza e të dhënave empirike dhe intervistave me palët e interesit kanë mundësuar nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimeve të bazuara për institucionet arsimore dhe aktorët relevantë. Në përfundim të studimit, duke integruar gjetjet nga analiza e rezultateve empirike dhe shqyrtimi i literaturës shkencore bashkëkohore mbi këtë temë, është ofruar një pasqyrë e detajuar mbi organizimin e aktiviteteve dhe formave efektive të bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë. Bazuar në këto gjetje, kemi propozuar një sërë rekomandimesh për institucionet arsimore dhe politikëbërësit, me qëllim të përmirësimit të praktikave bashkëpunuese në mjedisin arsimor.

Fjalët çelës: format e bashkëpunimit, komunikimi, mësimdhënësit, nxënësit, shkolla

from the 10th, 11th, and 12th grades, as well as the teachers working with them, within the municipality of Prishtina.

The analysis of empirical data and interviews with stakeholders enabled the derivation of well-founded conclusions and recommendations for educational institutions and relevant actors. At the conclusion of the study, by integrating findings from the empirical data analysis and reviewing contemporary scientific literature on the topic, a detailed overview is provided on the organization of activities and effective forms of collaboration between teachers and students in upper secondary education in Kosovo. Based on these findings, a series of recommendations have been proposed for educational institutions and policymakers with the aim of improving collaborative practices within the educational environment.

Keywords: Forms of collaboration, communication, teachers, students, school

Përceptimet e mësuesve udhëtues për praktikat e gjithëpërfshirjes në Kosovë

Itinerant teacher perceptions of inclusive practices in Kosovo

Sahare Reçica-Havolli
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: Sahare.Reçica@rks-gov.net

Abstrakt

Ky hulumtim ka për qëllim të identifikojë perceptimet e mësuesve udhëtues për praktikat e gjithëpërfshirjes në Kosovë. Meqë procesi i gjithëpërfshirjes has në sfida të shumta dhe ofrimi i mbështetjes nga mësuesit udhëtues për shkollat, të cilat përfshijnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore, është një praktikë që është duke u zbatuar në Kosovë, konsiderohet se pikërisht mësuesit udhëtues janë njohësit më të afërt të zhvillimit të procesit të gjithëpërfshirjes. Andaj, perceptimet e tyre mund të japin një reflektim të drejtë për përparësitë dhe sfidat në këtë proces, duke identifikuar nevojat për ndërhyrje institucionale.

Hulumtimi ka qasje cilësore, me metoda përshkruese, vlerësuese dhe eksploruese. Mostra e hulumtimit përbëhet nga 9 mësues udhëtues të pesë Qendrave Burimore për mësim dhe këshillim (QB) – nga 2 në 3 QB për fëmijët me dëmtime intelektuale, 1 të QB për fëmijët me dëmtime në dëgjim dhe 2 mësues udhëtues të QB për fëmijët me dëmtime në të parë. Për realizimin e hulumtimit është hartuar pyetësori për intervistë të mësuesve

Abstract

This research aims to identify the perceptions of itinerant teachers regarding inclusive practices in Kosovo. Since the inclusion process faces numerous challenges and the provision of support by itinerant teachers to schools that include students with special educational needs is a practice currently being implemented in Kosovo, it is considered that itinerant teachers are the closest experts on the development of the inclusion process. Therefore, their perceptions can provide a fair reflection of the advantages and challenges in this process by identifying the needs for institutional interventions.

The research employs a qualitative approach with descriptive, evaluative, and exploratory methods. The research sample consists of 9 itinerant teachers from five Resource Centers for Learning and Counseling (RC) – from 2 to 3 RCs for children with intellectual disabilities, 1 RC for children with hearing impairments, and 2 itinerant teachers from the RC for children with visual impairments. To conduct the research, a questionnaire was designed to interview the itinerant teachers,

udhëtues – referuar pyetjes kryesore: Cilat janë perceptimet e mësuesve udhëtues për gjithëpërfshirjen në Kosovë?

Gjetjet nga instrumenti i hulumtimit do të interpretohen sipas temave, të cilat do të dalin nga pyetjet e hulumtimit. Po ashtu, rezultatet e hulumtimit do të diskutohen duke u analizuar dhe krahasuar me politikat vendore dhe praktikat ndërkombëtare.

Nga rezultatet e hulumtimit do të dalin përfundimet për sfidat e mësuesve udhëtues, perceptimet e tyre për praktikat e gjithëpërfshirjes dhe sugjerimet për përmirësimin e gjendjes. Sipas përfundimeve, do të nxirren rekomandimet për ndërhyrje të nevojshme për zhvillimin e procesit të gjithëpërfshirjes në Kosovë.

Fjalët çelës: gjithëpërfshirje, mësues udhëtues, nevoja të veçanta, perceptimet

focusing on the main question: What are the perceptions of itinerant teachers about inclusion in Kosovo?

The findings from the research instrument will be interpreted according to the themes that arise from the research questions. Moreover, the research results will be discussed by analyzing and comparing them with local policies and international practices.

The research results will lead to conclusions regarding the challenges faced by itinerant teachers, their perceptions of inclusive practices, and their suggestions for improving the situation. Based on the conclusions, recommendations will be made for necessary interventions to develop the inclusive process in Kosovo.

Keywords: inclusion, itinerant teacher, special needs, perceptions

Përfshirja dhe promovimi i standardeve për drejtorë të shkollave në Kosovë në programet për udhëheqje arsimore

Inclusion and promotion of standards for school principals in Kosovo in educational leadership programs

Selim Mehmeti
Instituti Pedagogjik i Kosovës
E-mail: selimmehmeti.ipk@gmail.com

Rita Llumnica
Fakulteti i Edukimit
E-mail: rita.llumnica@outlook.com

Rita Çadraku
Fakulteti i Edukimit
E-mail: ritacadraku1@gmail.com

Abstrakt

Sigurimi i udhëheqësve efektivë në shkolla është i lidhur ngushtë me mënyrën si përgatiten dhe zhvillohen profesionalisht ata. Në këtë kontekst, përfshirja dhe promovimi i standardeve të praktikës profesionale për drejtorë të shkollave në programet e formimit për udhëheqje arsimore shikohet si një nevojë dhe domosdoshmëri për të siguruar cilësi, koherencë dhe profesionalizëm në përgatitjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtuesve të shkollave.

Ky studim cilësor shqyrton dhe krahason mënyrën se si janë përfshirë dhe promovuar standardet e praktikës profesionale për drejtorë të shkollave në programet e formimit për udhëheqje arsimore në Kosovë. Studimi është realizuar përmes analizës së përmbajtjes, duke analizuar kuadrin e politikave për udhëheqje arsimore dhe duke krahasuar standardet, përkatësisht treguesit e njohurive dhe

Abstract

Ensuring effective school leaders is closely linked to how they are prepared and professionally developed. In this context, the inclusion and promotion of professional practice standards for school principals in educational leadership training programs is seen as a need and necessity to ensure quality, coherence and professionalism in the preparation and continuous professional development of school principals.

This qualitative study examines and compares how professional practice standards for school principals have been included and promoted in educational leadership training programs in Kosovo. The study was conducted through content analysis, analyzing the policy framework for educational leadership and comparing the standards, namely knowledge indicators and

treguesit e performancës për drejtorë të shkollave me qëllimet, rezultatet e pritura, përmbajtjet teorike dhe veprimtaritë praktike të përvijuara në shtatë modulet e Programit të trajnimit për Udhëheqje arsimore dhe në syllabusët e programit Master i Shkencave të Edukimit me specializim Udhëheqje në Arsim.

Gjetjet tregojnë se ekziston një kornizë prej gjashtë standardeve për drejtorë të shkollave, me pritshmëri të larta për nivelin e njohurive dhe të shkathtësive të performancës. Integrimi dhe promovimi i tyre në programet përkatëse të formimit për udhëheqje arsimore shënon, përpjekje të vazhdueshme për të mbajtur lidhjen e programeve me standardet, por mbetet i pjesshëm, me disa mangësi në harmonizimin ndërmjet përmbajtjes teorike dhe kërkesave praktike të artikuluara përmes standardeve të performancës për drejtorë të shkollave. Studimi vë në pah disa shembuj të mirë në programet ekzistuese, që mund të shërbejnë si modele gjatë rishikimit të programeve, dhe njëkohësisht kontribuon në ngritjen e diskutimit më të gjerë për nevojat dhe mundësitë e ndërtimit të sistemit të karrierës dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të udhëheqësve të shkollave.

Fjalët çelës: drejtor shkolle, kapacitete profesionale, standarde të performancës, udhëheqje arsimore, zhvillim profesional i vazhdueshëm

performance indicators for school principals with the goals, expected outcomes, theoretical contents and practical activities outlined in the seven modules of the Educational Leadership Training Program and in the syllabuses of the Master of Education Sciences Program with a specialization in Educational Leadership.

The findings show that there is a framework of six standards for school principals, with high expectations for the level of knowledge and performance skills. Their integration and promotion in the relevant educational leadership training programs marks a continuous effort to maintain the connection of the programs with the standards, but remains partial, with some shortcomings in the harmonization between the theoretical content and the practical requirements articulated through the performance standards for school principals. The study highlights some good examples in existing programs that can serve as models during the review of programs and at the same time contributes to the establishment of a broader discussion on the needs and opportunities for building a career system and continuous professional development of school leaders.

Keywords: school principal, professional capacities, performance standards, educational leadership, continuous professional development

Motivimi i nxënësve për të nxënë përmes lojërave kompjuterike

Student motivation to learn through computer games

Senad Orhani & Kyvete Shatri
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë
E-mail: kyvete.shatri@uni-pr.edu

Abstrakt

Studimi eksploron ndikimin e lojërave kompjuterike në rritjen e motivimit të nxënësve për të nxënë. Përmes një shqyrtimi sistematik të literaturës së përzgjedhur, ky punim analizon mënyrat se si elementet unike të lojërave kompjuterike, si sfidat, shpërblimet dhe progresi i dukshëm, nxisin angazhimin dhe dëshirën për të mësuar.

Literatura tregon se lojërat kompjuterike ofrojnë një qasje më tërheqëse për nxënësit, duke krijuar një ndjenjë arritjeje dhe kënaqësie në procesin e të nxënit. Përmes ndërveprimeve dinamike dhe objektivave të qarta, lojërat kompjuterike ndihmojnë në ndërtimin e motivimit të brendshëm, i cili është i lidhur me një angazhim më të qëndrueshëm dhe të vetëdrejtuar në procesin edukativ. Lojërat kompjuterike janë një teknologji ndërvepruese, të cilat mund të nxisin të nxënit në mënyrë efektive dhe motivuese, veçanërisht te nxënësit e shkollës së mesme të ulët. Po ashtu, aspektet si autonomia, ndjenja e kompetencës dhe lidhja emocionale që krijohen gjatë lojës, shihen si faktorë me rëndësi në nxitjen e motivimit.

Abstract

This study explores the impact of computer games on increasing students' motivation to learn. Through a systematic review of selected literature, the paper analyzes how unique elements of computer games—such as challenges, rewards, and visible progress—stimulate engagement and the desire to learn.

The literature indicates that computer games offer a more engaging approach for students, creating a sense of achievement and satisfaction in the learning process. Through dynamic interactions and clear objectives, computer games help foster intrinsic motivation, which is associated with more sustained and self-directed engagement in educational activities. Computer games, as interactive technologies, can effectively and motivationally enhance learning, especially among lower secondary school students. Additionally, aspects such as autonomy, sense of competence, and emotional connection developed during gameplay are identified as important factors in promoting motivation.

Ky punim synon të sintetizojë gjetjet kryesore nga studimet ekzistuese për të ofruar një kuptim më të qartë mbi efektet pozitive të përdorimit të lojërave kompjuterike për motivimin e nxënësve. Përfundimet mund të ndihmojnë edukatorët dhe zhvilluesit e teknologjive edukative në hartimin e strategjive që shfrytëzojnë potencialin e lojërave për të nxitur motivimin në mjediset mësimore.

Fjalët çelës: motivimi, lojërat kompjuterike, të nxënit, angazhimi, qasja edukative

This paper aims to synthesize key findings from existing studies to provide a clearer understanding of the positive effects of using computer games to motivate students. The conclusions may assist educators and educational technology developers in designing strategies that leverage the potential of games to enhance motivation in learning environments.

Keywords: motivation, computer games, learning, engagement, educational approach

Lidhshmëria e gjuhës shqipe ndërmjet programeve parauniversitare dhe atyre universitare

The Albanian language connectivty between pre-university and university programs

Shkelqim Millaku
E-mail: shkelqim.millaku@uni-prizren.com

Abstrakt

Mësimdhënia e gjuhës shqipe, si në nivelin parauniversitar, ashtu edhe në atë universitar ka lidhshmëri të plotë, mirëpo në nivel vendi e kombi ka edhe dallueshmëri, si në plan-programet '*kurrikulat*' parauniversitare, ashtu edhe në '*programet*' universitare, të cilët, përmes tyre, po na krijojnë hapësirë lehtësuese e sfiduese për ta mësuar, ligjëruar e zotëruar gjuhën shqipe.

Si hartues i plan-programeve parauniversitare e universitare, në këtë kumtesë do të prezantoj përvojën time akademike, e cila do t'i trajtojë disa çështje.

Çështja e parë do t'i analizojë plan-programet parauniversitare të gjuhës shqipe dhe në çështjen e dytë do ta zgjerojmë fokusin në programet universitare, të cilët përgatisin mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe; të gjuhës shqipe apo të letërsisë shqipe, por si programe të tilla janë apo nuk janë në përputhshmëri për të nxjerrë mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe, për nivelin parauniversitar.

Abstract

The Albanian language teaching , as in the pre-university and in the university level, has a complete connection, but as it, in the level of the country and nation there are also distinctions, both in the pre-university 'curricula' and in the university 'programs', which are creating an enabling and challenging space for to learning, teaching, and for to mastering the Albanian language.

As the plan creator of the pre-university and university programs for Albanian grammar, in this paper, I will present my academic experience, which it will treat some several issues.

The first issue will be analyze the pre-university curricula of the Albanian language and in the second issue we'll expand the focus to university programs that prepare teachers for Albanian language and literature or for Albanian language - Albanian literature, but whether such as the programs are or are not compatible with producing teachers of the Albanian language and literature for the pre-university level.

Çështjet në fjalë duhet të kenë lidhshmëri të ngushtë ndërmjet tyre, mirëpo ka raste që duhet të kërkohet harmonizim i detyruar, në mënyrë që gjuha shqipe të mësohet, të studiohet e të ligjërohet në nivel vendi e kombi me programe të kodifikuara.

Fjalët çelës: gjuha shqipe, plan-programet, lidhshmëria

The issues in question should be closely related to each other, but there are cases where forced harmonization should be required, so that the Albanian language can be taught, studied, and lectured at the national and state level with codified programs.

Keywords: Albanian language, curriculum, connectivity.

Qasja sociale dhe emocionale në procesin mësimor si faktor për zhvillimin e kompetencave personale dhe qytetare

Social and emotional approach in the learning process as a factor for the development of personal and citizen competences

Suzana Gjergji
Inspektorati i arsimit
E-mail. suzana.gjergji@rks-gov.net

Servete Gashi
QSE "Don Bosko" në Prishtinë
E-mail. Servete.sh.gashi@gmail.com

Abstrakt

Arsimi fillor dhe i mesëm në Kosovë përballen me një sërë sfidash zhvillimore që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies. Disa nga këto sfida përfshijnë: infrastrukturë jo adekuate, mungesë e mbështetjes profesionale, përdorimi i teknologjisë etj. Në vitet e fundit, sfidë në rritje është bërë qasja sociale dhe emocionale gjatë mësimdhënies dhe të nxënit.

Ekspozimi i pakontrolluar i nxënësve në rrjetet sociale ka ndikuar negativisht në mirëqenien mendore dhe të personalitetit të nxënësve, duke u shfaqur në devijimin e sjelljes, mosndjeshmërinë ndaj tjetrit, shfaqje të stresit etj. Ndërkaq, mësimdhënësit dhe vetë institucioni, përveç njohurive akademike dhe profesionale, duhet të realizojnë funksionin edukativ që ka në raport me nxënësit dhe të kenë qasje emocionale dhe sociale nga ana e tyre në trajtimin e rasteve. Prandaj, qëllimi i këtij

Abstract

Primary and secondary education in Kosovo faces a range of developmental challenges affecting teaching quality. Some of these challenges include inadequate infrastructure, lack of professional support, and limited use of technology. In recent years, an emerging challenge has been the integration of social and emotional approaches in teaching and learning.

Uncontrolled exposure of students to social media has negatively impacted their mental well-being and personal development, manifesting in behavioral deviations, lack of empathy, stress, and other related issues. Consequently, teachers and educational institutions, beyond academic and professional knowledge, must fulfill their educational role by applying social and emotional approaches in addressing students' needs.

hulumtimi është për të parë si dhe sa institucionet edukative dhe arsimore realizojnë funksionin e tyre edukativ, në arritjen e kompetencës personale dhe qytetare.

Metodat e punës janë cilësore dhe sasiore. Gjetjet e hulumtimit janë nga disa këndvështrime të ndryshme. Përfundimet çojnë në një aspekt të ndërlidhur sfidash zhvillimore, sidomos në aspektin edukativ të nxënësve.

Fjalët çelës: edukimi, mësimdhënia, rrjetet sociale, trajtimi, personaliteti, nxënësit

The aim of this research is to examine how and to what extent educational institutions implement their educational functions to foster personal and citizen competences among students.

The study employs both qualitative and quantitative methods, providing insights from multiple perspectives. Findings highlight interrelated developmental challenges, particularly regarding the educational and socio-emotional growth of students.

Keywords: education, teaching, social media, intervention, personality, students

Praktikat edukative për integrimin e aktiviteteve fizike në punën me fëmijët 3-6 vjeç

Educational practices for integrating physical activities in working with children aged 3-6 Years

Tringa Dedi, Zehrie Plakolli, Mevlude Aliu Gashi
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Edukimi në fushën e zhvillimit fizik është shumë i rëndësishëm për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Në arsimin parashkollor institucional, edukatoret luajnë rol me rëndësi në integrimin e aktiviteteve fizike gjatë punës me fëmijët. Ky integrim ndihmon zhvillimin gjithëpërfshirës të tyre, duke përfshirë aftësitë motorike, shëndetin fizik, zhvillimin emocional, social dhe aspektet kognitive, si imagjinata dhe kreativiteti. Gjetjet e këtij studimi mund të përdoren si bazë për hartimin e politikave arsimore dhe për përmirësimin e praktikave edukative.

Qëllimi i hulumtimit është të analizojë mënyrën e integrimit të aktiviteteve fizike në institucionet parashkollore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin fizik, emocional, social dhe kognitiv të fëmijëve, si dhe në krijimin e zakoneve të shëndetshme që zgjasin gjatë jetës. Studimi përdor metodën cilësore, duke përfshirë vëzhgimin në klasë dhe intervista gjysmë të strukturuara me 20 edukatore nga 5 kopshte në qytete të ndryshme të Kosovës.

Abstract

Education in the field of physical development is very important for children aged 3-6 years. In institutional preschool education, educators play a key role in integrating physical activities while working with children. This integration supports their comprehensive development, including motor skills, physical health, emotional, social development, and cognitive aspects such as imagination and creativity. The findings of this study can serve as a basis for designing educational policies and improving educational practices.

The purpose of the research is to analyze how physical activities are integrated in preschool institutions and their impact on the physical, emotional, social, and cognitive development of children, as well as on the creation of healthy habits that last throughout life. The study uses a qualitative method, including classroom observation and semi-structured interviews with 20

Gjetjet tregojnë se aktivitetet fizike, të përshtatura për moshën e fëmijëve, ndikojnë pozitivisht në shëndetin e tyre fizik dhe emocional, përmirësojnë gjendjen shpirtërore, nxisin socializimin, bashkëpunimin dhe krijimin e shprehive të shëndetshme, duke kontribuar në një rutinë të balancuar dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve.

Rekomandohet që institucionet parashkollore të forcojnë integrimin sistematik të aktiviteteve fizike në programet e tyre, duke siguruar trajnim të vazhdueshëm për edukatoret duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit për të promovuar zakonet e shëndetshme që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e fëmijëve.

Fjalët çelës: aktivitet fizik, edukim fizik, fëmijë, shëndetësor, zhvillim

educators from 5 kindergartens in different cities of Kosovo.

The findings show that physical activities, adapted to the age of the children, positively influence their physical and emotional health, improve mood, encourage socialization, cooperation, and the formation of healthy habits, contributing to a balanced routine and comprehensive development of children.

It is recommended that preschool institutions strengthen the systematic integration of physical activities in their programs by providing ongoing training for educators and including cooperation with parents to promote healthy habits that positively affect children's development.

Keywords: physical activity, physical education, children, health, development

Shqyrtim kritik i lektyrave shkollore

Critical review of school literature readings

Uranela Demaj
Kolegji AAB
E-mail: uranela.demaj@gmail.com

Agon Ahmeti
Organizata ETEA
E-mail: agonahmeti@gmail.com

Abstrakt

Ky punim paraqet gjetjet e një studimi kërkimor të ETEA-s mbi gjuhën dhe strukturat diskursive të teksteve letrare të rekomanduara në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë. Duke u mbështetur në Analizën Kritike të Diskursit (AKD), studimi shqyrton dhjetë lista të teksteve letrare të rekomanduara në shkolla dhe një korpus të përzgjedhur prej njëmbëdhjetë veprave letrare që u caktohen shpesh nxënësve në klasat 6 deri në 9.

Analiza nxjerr në pah një mbështetje sistematike në një katalog të teksteve letrare të shkruara para viteve 1990, me mungesë të shkrimtareve gra dhe letërsisë bashkëkohore që pasqyron realitetet pasluftës apo zhvillimet socio-kulturore. Përtej mospërputhjes kohore, tekstet shfaqin modele gjuhësore të përsëritura, përjashtuese, dhe të papërshtatshme në aspektin etik, përfshirë diskurs diskriminues – veçanërisht ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian – seksualizim të të miturve,

Abstract

This paper presents the findings of a research study conducted by ETEA on the language and discursive structures of literary texts recommended in lower secondary education in Kosovo. Drawing on Critical Discourse Analysis (CDA), the study examines ten lists of recommended literary texts in schools and a selected corpus of eleven literary works frequently assigned to students in grades 6 to 9.

The analysis reveals a systematic reliance on a catalog of literary texts written before the 1990s, with a notable absence of women writers and contemporary literature that reflects post-war realities or socio-cultural developments. Beyond the temporal mismatch, the texts display recurring, exclusionary, and ethically problematic language patterns, including discriminatory discourse—particularly against Roma, Ashkali, and Egyptian communities—sexualization of minors, the

estetizim të traumës dhe dhunës, si dhe stereotipa gjinorë që kufizojnë rolet e grave.

Gjetjet tregojnë mungesën e kornizimit kritik pedagogjik, ku intervistat gjysmë të strukturuara me mësimdhënës dhe nxënës konfirmojnë se konteksti shoqëror-kulturor dhe historik i teksteve rrallëherë bëhet i qasshëm, duke i lënë nxënësit të përvetësojnë materiale komplekse pa udhëzim interpretues. Studimi argumenton se një ekspozim i tillë i pafiltruar mund të jetë problematik – veçanërisht për lexuesit e rinj që ende janë në proces të zhvillimit të gjykimit kritik dhe ndjeshmërisë qytetare. Si përgjigje, ETEA bën thirrje për zhvillimin institucional të kritereve për përzgjedhjen e teksteve letrare, të bazuara në gjuhë të përshtatshme për moshën dhe angazhim të mësimdhënësve për qasje kritike në klasë.

Fjalët çelës: përdorimi i gjuhës, Analiza Kritike e Diskursit (AKD), tekste letrare, kultura e leximit, Kosova

aestheticization of trauma and violence, as well as gender stereotypes that restrict women's roles.

The findings highlight the lack of critical pedagogical framing, as semi-structured interviews with teachers and students confirm that the socio-cultural and historical contexts of the texts are rarely addressed, leaving students to engage with complex material without interpretative guidance. The study argues that such unfiltered exposure can be problematic—especially for young readers who are still developing critical judgment and civic sensitivity. In response, ETEA calls for the institutional development of criteria for selecting literary texts, grounded in age-appropriate language and supported by teacher engagement in fostering a critical classroom approach.

Keywords: language use, Critical Discourse Analysis (CDA), literary texts, reading culture, Kosovo

Ndikimi i mësimit plotësues në arritjet akademike të nxënësve

The impact of supplementary teaching on students' academic achievements

Valdete Spahiu Çollaku
ShFMU "Ganimete Tërbeshi", Prishtinë
E-mail: valdetespahiu2@gmail.com

Abstrakt

Ky studim trajton ndikimin e mësimit plotësues në arritjet akademike të nxënësve në shkollat fillore të komunës së Prishtinës. Qëllimi kryesor është të vlerësohet nëse dhe si mësimi plotësues ndihmon në përmirësimin e rezultateve akademike dhe në tejkalimin e vështirësive gjatë procesit të nxënies. Është i rëndësishëm identifikimi i rasteve që kanë nevojë për mësim plotësues, pastaj analiza dhe shqyrtimi i mundësive, që nëpërmjet mësimit plotësues, qysh në nivelin fillor, t'u hapen shtigjet e dijes.

Metodologjia përfshin kombinimin e analizës së literaturës me mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve dhe fokus-grupeve me mësimdhënës dhe nxënës të klasës së pestë. Të dhënat sasiore janë analizuar me metoda statistikore përmes programit SPSS, ndërsa të dhënat cilësore janë trajtuar me metodën induktive. Mostra përbëhet nga 165 mësimdhënës dhe 330 nxënës, që përfaqësojnë 10% të popullsisë së arsimit fillor në komunën e Prishtinës.

Rezultatet tregojnë se mësimi plotësues ka një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve akademike të nxënësve, duke kontribuar

Abstract

This study examines the impact of supplementary teaching on the academic achievements of students in primary schools in the municipality of Prishtina. The main aim is to evaluate whether and how supplementary teaching contributes to improving academic outcomes and overcoming learning difficulties. Identifying students in need of additional support and analyzing opportunities for targeted interventions is crucial for opening pathways to knowledge from an early educational level.

The methodology combines literature review with data collection through questionnaires and focus groups involving teachers and fifth-grade students. Quantitative data were analyzed using statistical methods in SPSS, while qualitative data were processed through an inductive approach. The sample consists of 165 teachers and 330 students, representing 10% of the primary education population in Prishtina.

Results indicate that supplementary teaching has a significant positive impact on students' academic performance, contributing to increased self-

në forcimin e vetëbesimit dhe motivimit të tyre për të mësuar. Ky studim nënvizon rëndësinë e organizimit të mësimit plotësues në mënyrë fleksibile dhe të përshtatur me nevojat individuale të nxënësve për të arritur rezultate më të mira akademike dhe zhvillim të qëndrueshëm në arsimin fillor.

Fjalët çelës: mësimi plotësues, arritjet akademike, nxënësi, mësimdhënësi, arsimi fillor

confidence and motivation to learn. The study emphasizes the importance of organizing supplementary teaching flexibly and tailored to individual student needs to achieve better academic results and sustainable development in primary education.

Keywords: supplementary teaching, academic achievement, student, teacher, primary education

Bashkëpunimi ndërmjet familjes dhe edukatoreve në edukimin e hershëm: sfidat dhe mundësitë

Collaboration between families and educators in early childhood education: Challenges and opportunities

Vjollca (Llazani) Ameti
E-mail: vjollcaameti72@gmail.com

Sevdije Berisha Krasniqi
ShFMU ”Hasan Prishtina” Milloshevë
E-mail: berishasevda349@gmail.com

Abstrakt

Bashkëpunimi ndërmjet familjes dhe edukatoreve luan rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve. Vitet e para të jetës janë thelbësore për formimin e bazës emocionale dhe njohëse të fëmijës, prandaj përfshirja aktive e prindërve është jetike për këtë fazë edukimi. Në anën tjetër, edukatoret janë profesioniste që udhëheqin procesin mësimor dhe zhvillues në institucionet edukative. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet këtyre dy palëve krijon një mjedis të sigurt dhe mbështetës për fëmijët.

Ky punim synon të paraqesë rëndësinë dhe natyrën e këtij bashkëpunimi, përfitimet që sjell në zhvillimin e fëmijës, si dhe sfidat kryesore që burojnë nga kjo marrëdhënie, me të cilat përballen familjet dhe edukatoret në praktikë. Gjithashtu, paraqet perceptimet dhe përvojat e tyre rreth përfshirjes në procesin edukativ. Punimi do të

Abstract

Collaboration between families and educators plays an irreplaceable role in the development and early education of children. The first years of life are crucial for establishing the child’s emotional and cognitive foundations; therefore, active parental involvement is essential during this stage. Educators, on the other hand, are professionals who guide the learning and developmental process within educational institutions. Close cooperation between these two parties creates a safe and supportive environment for children.

This study aims to highlight the importance and nature of this collaboration, the benefits it brings to child development, and the main challenges faced by families and educators in practice. It also presents their perceptions and experiences regarding participation in the educational process. The research employs descriptive, analytical, and

realizohet me metodat përshkruese, analitike dhe krahasuese, me qëllim që të paraqesë në mënyrë sa më të qartë nivelin e bashkëpunimit ndërmjet familjes dhe edukatoreve në edukimin e hershëm.

Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur pyetësori dhe intervista me prindër dhe edukatore. Përmes kombinimit të të dhënave cilësore (intervistave) dhe sasiore (pyetësorëve) është mundësuar një kuptim më i plotë dhe real i situatës, si dhe krahasimi i përvojave dhe pikëpamjeve të ndryshme.

Punimi përfundon me rekomandime praktike për përforcimin e partneritetit ndërmjet shkollës dhe familjes, me qëllim që të mbështetet sa më mirë zhvillimi i gjithanshëm i fëmijës në edukimin e hershëm.

Fjalët çelës: bashkëpunimi, familja, edukatoret, edukimi i hershëm, sfidat, mundësitë

comparative methods to provide a clear understanding of the level of collaboration between families and educators in early childhood education.

Data collection involved questionnaires and interviews with both parents and educators. By combining qualitative data (interviews) and quantitative data (questionnaires), the study provides a more comprehensive and realistic understanding of the situation, allowing comparison of different experiences and viewpoints.

The study concludes with practical recommendations for strengthening the partnership between schools and families, aiming to better support the holistic development of children in early education.

Keywords: collaboration, family, educators, early childhood education, challenges, opportunities

Roli i platformave digjitale në zhvillimin e kompetencave të qëndrueshme te nxënësit e arsimit fillor

The role of digital platforms in developing sustainable competencies in primary school students

Vlora Bunjaku
Belgizare Kryeziu

Abstrakt

Ky studim trajton rolin e platformave digjitale në zhvillimin e kompetencave të qëndrueshme te nxënësit e arsimit fillor, duke i pajisur ata me aftësi të nevojshme për mësimin gjatë gjithë jetës. Teknologjia nxit pavarësinë intelektuale dhe zhvillimin e aftësive mendore, duke përmirësuar përvetësimin aktiv të njohurive. Qëllimi i studimit është të analizojë kontributin e platformave digjitale, si PowerPoint, Kahoot, GeoGebra, Book Creator dhe Paint, në përvetësimin e aftësive të leximit, shkrimit dhe digjitalizimit, si dhe në zhvillimin e kompetencave të tjera të qëndrueshme, si mendimi kritik, kreativiteti, bashkëpunimi, komunikimi dhe zgjidhja e problemeve. Përdoret një metodologji e kombinuar, duke përfshirë pyetësorë të strukturuar për 120 nxënës nga tri shkolla fillore, intervista të gjysmëstrukturuara me mësimdhënës, si dhe analiza të dokumentacionit mësimor si instrument cilësor. Në këtë të fundit janë shqyrtuar plane mësimore që përfshijnë përdorimin e mjeteve digjitale, produkte të krijuara nga nxënësit përmes platformave (prezantime, tregime digjitale, vizatime në Paint), reflektime nga mësimdhënësit, si dhe udhëzues funksionalë për përdorimin e mjeteve teknologjike. Gjetjet konfirmojnë rolin

Abstract

This study explores the role of digital platforms in developing sustainable competencies among primary school students, equipping them with essential skills for lifelong learning. Technology fosters intellectual independence and cognitive skill development, enhancing active knowledge acquisition. The study aims to analyze the contribution of digital platforms—such as PowerPoint, Kahoot, GeoGebra, Book Creator, and Paint—in improving reading, writing, and digitalization skills, as well as other sustainable competencies, including critical thinking, creativity, collaboration, communication, and problem-solving. A mixed-methods approach was employed, including structured questionnaires for 120 students from three primary schools, semi-structured interviews with teachers, and analysis of educational documentation as a qualitative instrument. The documentation reviewed lesson plans incorporating digital tools, student-produced projects (presentations, digital stories, Paint drawings), teacher reflections, and functional guides for technology use. Findings confirm the positive role of these platforms in the learning process: 87% of students reported that Kahoot

pozitiv të këtyre platformave në procesin mësimor: 87% e nxënësve raportuan se aktivitetet me Kahoot kanë ndikuar në rritjen e kujtesës dhe angazhimit; GeoGebra ka ndihmuar në të kuptuarit vizual të matematikës; tregimet digjitale në Book Creator kanë integruar shkrimin dhe dizajnin vizual, duke nxitur kreativitetin dhe shprehjen personale; Paint përforcoi aftësitë vizuale dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në disa fusha kurrikulare. Megjithatë, studimi identifikon një sfidë të rëndësishme: shumica e mësimdhënësve nuk kanë marrë trajnim adekuat për përdorimin e platformave digjitale dhe i kanë mësuar ato në mënyrë vullnetare dhe autodidakte, duke u mbështetur në përpjekje personale dhe burime të pavarura. Ky punim paraqet një model praktik për integrimin efektiv të teknologjisë në klasat fillore, duke kontribuar në literaturën pedagogjike me një qasje të integruar që bashkon përvoja konkrete nga mjedisi shkollor me reflektime didaktike. Gjithashtu, rezultatet ofrojnë rekomandime të vlefshme për mësimdhënësit dhe politikëbërësit për përmirësimin e metodave mësimore, përmes programeve të strukturuara të zhvillimit profesional, që mbështesin përdorimin pedagogjik dhe ndërdisiplinor të teknologjisë në arsimin fillor. Kjo qasje kontribuon në ngritjen e cilësisë së arsimit fillor, duke formuar kompetenca të qëndrueshme dhe duke përgatitur nxënësit për sfidat e shekullit XXI.

Fjalët çelës: arsimi fillor, kompetenca, mësimi gjatë gjithë jetës, platforma digjitale, teknologjia

activities enhanced memory and engagement; GeoGebra supported visual understanding in mathematics; digital stories in Book Creator integrated writing and visual design, fostering creativity and personal expression; Paint strengthened visual skills and active student participation across curricular areas. However, a significant challenge was identified: most teachers had not received adequate training in using digital platforms and relied on voluntary and self-taught efforts, supported by personal initiative and independent resources. This study presents a practical model for effective integration of technology in primary classrooms, contributing to pedagogical literature with an approach that combines concrete school experiences with didactic reflection. The results also provide valuable recommendations for teachers and policymakers to improve teaching methods through structured professional development programs that support pedagogical and interdisciplinary use of technology in primary education. This approach enhances the quality of primary education, develops sustainable competencies, and prepares students for 21st-century challenges.

Keywords: primary education, competencies, lifelong learning, digital platforms, technology

Rëndësia e mendimit kritik në fëmijërinë e hershme dhe mbështetja e tij nga edukatorja

The importance of critical thinking in early childhood and its support by the educator

Zehrie Plakolli
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Mendimi kritik është një aftësi thelbësore kognitive, që ndikon në zhvillimin e fëmijëve që nga mosha e hershme, dhe është përcaktues në aftësimin e tyre për jetën. Për këtë edhe e kemi vënë në fokus të këtij studimi.

Qëllimi i studimit është të analizojmë rëndësinë e mendimit kritik dhe praktikat e edukatoreve për të mbështetur të menduarit kritik në fëmijërinë e hershme. Po ashtu, studimi ka për qëllim të identifikojë strategjitë efektive, të cilat i zbatojnë edukatoret për të stimuluar mendimin kritik të fëmijëve parashkollorë. Pyetjet hulumtuese kanë të bëjnë me rëndësinë e mendimit kritik e kreativ te fëmijët parashkollorë (bazuar në shqyrtimin e literaturës), me rolin e edukatores dhe mjedisit në stimulimin e mendimit kritik dhe kreativitetit te fëmijët, me opinionin e edukatoreve rreth mendimit kritik te fëmijët, si dhe me praktikat e zbatuara të edukatoreve lidhur me mbështetjen e mendimit kritik.

Gjetjet nga praktikat e institucioneve parashkollore i kemi siguruar përmes pjesës empirike në terren, duke zbatuar vëzhgimin e praktikës së

Abstract

Critical thinking is a fundamental cognitive skill that influences children's development from an early age and plays a decisive role in preparing them for life. For this reason, it has been placed at the core of this study.

The aim of the study is to analyze the importance of critical thinking and the practices employed by educators to support critical thinking in early childhood. Furthermore, the study seeks to identify effective strategies applied by educators to stimulate critical thinking among preschool children. The research questions address the significance of critical and creative thinking in preschool children (based on a review of the literature), the role of the educator and the learning environment in fostering critical thinking and creativity, educators' perceptions regarding children's critical thinking, as well as the practical methods educators implement to support it.

Findings from preschool institutions were gathered through the empirical part of the study in the field, using classroom observations of educator practices with children and conducting interviews

edukatoreve me fëmijët në klasë dhe intervistimin, për të parë opinionin e tyre rreth mendimit kritik në F.H.

Për mostër kemi përzgjedhur 20 edukatore (që punojnë me fëmijët 3-6 vjeç) nga 15 institucione parashkollore të vendit (10 institucione publike, 5 private).

Pjesën teorike të rezultateve të pritura kemi synuar ta arrijmë përmes analizës së përmbajtjes së literaturës, nga ekspertë të ndryshëm të edukimit parashkollor dhe mendimit kritik, kurse pjesën empirike, të gjetjeve nga terreni, e kemi përpunuar përmes metodës cilësore. Gjetjet e studimit do të jenë një platformë reale e të dhënave nga aktualiteti praktik i punës së edukatoreve, në bazë të së cilave do të nxirren konkludimet dhe do të përpilohen rekomandimet, të cilat do të adresohen te faktorët adekuatë të politikave dhe praktikave arsimore për këtë nivel edukimi, me qëllim të përmirësimit të praktikës profesionale të edukatoreve me fëmijët parashkollorë.

Fjalët çelës: mendimi kritik, edukimi parashkollor, kreativiteti, roli i edukatores, strategjitë efektive

to capture their perspectives on critical thinking in early childhood.

The sample consisted of 20 educators (working with children aged 3–6) from 15 preschool institutions across the country (10 public and 5 private).

The theoretical component of the expected results was pursued through content analysis of the literature from various experts in preschool education and critical thinking, while the empirical findings from the field were processed using a qualitative method. The results of the study will serve as a concrete platform of data drawn from the practical reality of educators' work, upon which conclusions will be built, and recommendations will be formulated. These recommendations will be addressed to relevant educational policy and practice actors, with the aim of improving educators' professional practice with preschool children.

Keywords: critical thinking, preschool education, creativity, the role of the educator, effective strategies

Botues/Publisher

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Kosovo Pedagogical Institute

https://ipkmasht.rks-gov.net